


UNIVERZITETI I EJL

ЈНЕ УННВЕРЗИТЕТ

SEE UNIVERSITY



Fakulteti Juridik

Praven Fakultet

Law Faculty

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

PROGRAMI-E DREJTA CIVILE

TEZA:

**”Shkurorëzimi me marrëveshje në legjislacionin dhe në praktikën gjyqësore
të Republikës së Maqedonisë me theks të veçantë në Rrethin e Gjykatës së
Dibrës nga viti 2007-2017”**

Kandidati:

Anila Erebara

Mentori:

Doc.D-r Emine Zendeli

Tetovë, 2018



Divorce is a time of change. It really rocks a foundation of most people's lives. When we have our heart broken or our dreams taken away from us, it is a time of growth and change.

Debbie Ford

Familjes time...

Falemenderim

Përgatitja dhe finalizimi i këtij projekti kaq të rëndësishëm në jetën profesionale dhe akademike ka gjetur mbështetjen, përkahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të rëndësishëm në jetën time, të cilët gjej rastin t'i falenderoj përzemërsisht.

Falënderim për udhëheqësen shkencore, Prof. Dr.Emine Zendeli për ndihmën që më ka dhënë gjatë strukturimit dhe shkrimit të temës.

Mirënjohje dhe falënderim për mbështetjen profesionale, akademike, psikologjike dhe shpirtërore në hartimin dhe përfundimin e këtij punimi.

Përmbajtja e punimit

Falemenderim	4
HYRJE	8
1. LËNDA E HULUMTIMIT	8
2. QËLLIMET E HULUMTIMIT	9
3. HIPOTEZAT.....	9
4. RËNDËSIA E PUNIMIT.....	10
KAPITULLI I	11
1. MARTESA, E DREJTA MARTESORE SI E DREJTË POZITIVE.....	11
1.1 MARTESA NË EVROPË.....	16
1.2 PARIMET THEMELORE TË SË DREJTËS MARTESORE.....	17
1.3 QËLLIMI I MARTESËS	19
1.4 KUSHTET PËR LIDHJEN E MARTESËS, PENGESAT DHE NDALESAT	19
1.7 ZGJIDHJA E MARTESËS, NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR MOSMARRËVESHJE DHE ALTERNATIVAVE TË ZGJIDHJEVE TË TYRE	26
KAPITULLI I DYTË.....	28
2. SHKURORËZIMI SI INSTITUT I SË DREJTËS FAMILJARE	28
a) Ekzistimi i martesës së vlefshme	29
b) Shkurorëzimi për të gjallë të bashkëshortëve.....	29
c) Shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara me ligj.....	29
d) Shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me procedurë gjyqësore	30
2.1 HISTORIKU I SHKURORËZIMIT	31
❖ Sistemet e shkurorëzimit	32
2.2 SHKAQET E PËRGJITHSHME TË SHKURORËZIMIT.....	35
KAPITULLI I TRETË	38
3. SHKURORËZIMI SIPAS LEGJISLACIONIT PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	38
3.1 LIGJI PËR FAMILJE SI LIGJ THEMELOR PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKO-FAMILJARE	38
3.2 RREGULLIMI I SHKURORËZIMIT SIPAS LIGJIT PËR FAMILJE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË	38
3.3 SHKURORËZIMI ME PADI	41
3.4 SHKURORËZIMI ME MARRËVESHJE.....	42

3.4.1 PADIA ME PROPOZIM PËR SHKURORËZIMIN ME MARRËVESHJE	43
KAPITULLI I KATËRT.....	45
4. PROCEDURA E SHKURORËZIMIT	45
a) Parimi i barabartësisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit	46
b) Parimi i mbrojtjes së veçantë	46
c) Parimi i përjashtimit të publikut.....	47
d) Parimi i dispozicitetit	47
e) Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit.....	47
4.1 FILLIMI I PROCEDURËS PËR SHKURORËZIM	47
4.2 FAZAT E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË SHKURORËZIMIT	50
A) PROCEDURA E PAJTIMIT TË BASHKËSHORTËVE	50
B) ÇAKTIMI I MASAVE TË PËRKOHSHME	50
C) SEANCA KRYESORE	51
D) MARRJA E VENDIMIT	52
4.3 PROCEDURA SIPAS MJETEVE JURIDIKE	52
KAPITULLI I PESTË.....	54
5. ASPEKTE KRAHASUESE.....	54
5.1 SHKURORËZIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	54
5.2 KOMPARACION MIDIS LIGJIT PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE LIGJI PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	55
5.3 SHKURORËZIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	56
5.4 KOMPERACION MIDIS KODIT TË FAMILJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE LIGJIT PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	59
5.5 NËNKAPITULL I VEÇANTË.....	62
5.5.1 Çështja e kujdestarisë së fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë dhe legjislacioneve Europiane.....	62
KAPITULLI I GJASHTË	69
6. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	69
6.1 PRAKTIKA GJYGJËSORE NË GJYKATËN THEMELORE TË DIBRËS NË LIDHJE ME RASTET E SHKURORËZIMIT ME MARRËVESHJE	69
<i>Tab 1.Numri i lëndëve për shkurorëzim</i>	69
<i>Tab.2 Numri i padive për shkurorëzim</i>	70
<i>Tab.3 Numri i padive për shkurorëzim, inicuar nga bashkëshortët.....</i>	70

<i>Tab.4 Paditë për shkurorëzim (viti, 2009).</i>	71
<i>Tab.5 Paditë për shkurorëzim (viti, 2010).</i>	71
<i>Tab.6 Paditë për shkurorëzim (viti, 2011).</i>	71
<i>Tab.7 Paditë për shkurorëzim (viti, 2012).</i>	72
<i>Tab.8 Paditë për shkurorëzim (viti, 2013).</i>	72
<i>Tab.9 Paditë për shkurorëzim (viti, 2014).</i>	72
<i>Tab.10 Paditë për shkurorëzim (viti, 2015).</i>	72
<i>Tab.11 Paditë për shkurorëzim (viti, 2016).</i>	73
<i>Tab.12 Paditë për shkurorëzim (viti, 2017).</i>	73
<i>Tab.13 Numri i rasteve të shkurorëzimit gjatë peridhës kohore (2007-2017)</i>	73
6.1.1 STATISTIKA RRETH SHKURORËZIMIT PËR DISA VITE NË RM.....	76
6.2 METODA E ANALIZËS SË TË DHËNAVE SASIORE	77
6.3 ANKETA DHE PËRMBAJTJA E SAJ	77
6.4 INTERPRETIMI DHE PARAQITJA E REZULTATEVE NGA PYETËSORI I REALIZUAR. ...	78
<i>Grafiku 1.Numri i të anketuarëve</i>	78
<i>Grafiku 2.Mosha e të anketuarëve</i>	78
<i>Grafiku 3. Statusi i punësimit.....</i>	79
<i>Grafiku 4.Shkuroëzimi me marrëveshje</i>	79
<i>Grafiku 5.Llojet e shkurorëzimit</i>	81
<i>Grafiku 6. Kush paraqet padi për shkurorëzim burri apo gruaa.....</i>	82
<i>Grafiku 7.Shkaqet për zgjidhjen e martesës.....</i>	82
<i>Grafiku 8. Dhuna dhe shkurorëzimi.....</i>	83
<i>Grafiku 9. Paraja apo shkurorëzimi</i>	84
<i>Grafiku 10. Statusi i bashkëshortëve dhe çështja e fëmijëve.....</i>	84
RAST STUDIMI 1	86
RAST STUDIMI 2.....	88
❖ PËRFUNDIME	89
❖ REKOMANDIME	95
❖ LITERATURA E SHFYTËZUAR	96
❖ TEKSTE, MONOGRAFI, ARTIKUJ	96
❖ AKTE LIGJORE, KODE.....	98

HYRJE

1. LËNDA E HULUMTIMIT

Lëndë e këtij hulumtimi do të jetë analiza e normave juridike që rregullojnë shkurorëzimin, si një institut shumë i rëndësishëm i së drejtës familjare që garanton zgjidhjen ligjore të një martese të vlefshme, sipas të drejtës familjare të Republikës së Maqedonisë. Hulumtimi im do të përfshijë analizën e detajuar të kornizës ligjore që rregullon institutin e shkurorëzimit rregulluar me dispozitat e Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë.

Shkurorëzimi njihet si e drejtë shoqërore dhe juridike, e cila u garantohet të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në mënyrë të barabartë dhe nën kushte të barabarta. Në këtë studim do të përpiqem që të shpjegoj rëndësinë e institutit të shkurorëzimit, duke analizuar nocionin e të njejtës, historikun e paraqitjes dhe ndryshimet që ka pësuar në faza të ndryshme të zhvillimit shoqëror, poashtu do të elaborohen bazat e shkurorëzimit dhe llojet e tij, duke u përpunuar në mënyrë të veçantë mënyrat e shkurorëzimit si dhe procedura e shkurorëzimit në bazë të Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë.

Në interes të studimit komparativ të këtij instituti do të bëhet krahasimi i sistemit ligjor të Republikës së Maqedonisë me sistemet ligjore të shteteve në rajon veçanërisht me Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë për sa i përket institutit të shkurorëzimit. Më në fund, punimin do ta përfundoj me pjesën empirike respektivisht, ku në mënyrë statistikore do të paraqiten të dhënat e shkurorëzimit me marrëveshje si lloj i veçantë i shkurorëzimit në bazë të të dhënave të Gjykatës themelore të Dibrës.

2. QËLLIMET E HULUMTIMIT

Si qëllim kryesor i të bërit të një hulumtimi të tillë është studimi dhe analizimi i normave juridike, në këtë rast normave ligjore të institutit të shkurorëzimit. Me qëllim të kuptimit dhe njohjes më të mirë të normave ligjore të cilat rregullojnë institutin e shkurorëzimit, është e nevojshme që të definohet roli dhe rëndësia e këtij institutit të së drejtës familjare, mënyrat e shkurorëzimit dhe bazat e shkurorëzimit, si dhe procedura e shkurorëzimit dhe roli i gjykatës dhe palëve në këtë procedurë.

Qëllim tjetër i këtij hulumtimi është që të studioj një nga llojet më të reja të shkurorëzimit që njihet jo vetëm në të drejtën e RM-së, por është pjesë e legjislacionit të çdo shteti që karakterizohet me një nivel modern të sistemit juridik. Në këtë pjesë do të analizohet shkurorëzimi me marrëveshje, rregullimi ligjor i të njëjtit, rolin dhe rëndësia e bashkëshortëve në këtë lloj të shkurorëzimit, si dhe do të analizohen përparësitë që ky lloj i shkurorëzimit i ka në raport me shkurorëzimin me padi.

Realizimi i qëllimit të këtij punimi do të mundësohet përmes shfrytëzimit të metodave të ndryshme si ato: normative, dogmatike, sociologjike, komparative, historike dhe metodave të tjera.

3. HIPOTEZAT

- ✓ *Cilat janë rethanat që ndikuan në paraqitjen e shkurorëzimit me marrëveshje si mënyrë e re e shkurorëzimit?*
- ✓ *Cili lloj shkurorëzimi preferohet më shumë dhe është më i shpeshtë në praktikën gjyqësore?*
- ✓ *Është real apo fiktiv, shkurorëzimi me marrëveshje në Republikën e Maqedonisë?*

4. RËNDËSIA E PUNIMIT

Rëndësia e studimit të Institutit të shkurorëzimit do të jetë rezultat i një pune kërkimore dhe praktike për të identifikuar çështjen e shkurorëzimit me marrëveshje, duke e krahasuar edhe me disa shtete të tjera, duke i njohur shkaqet që vijnë deri tek ky lloj i shkurorëzimit si dhe duke i vënë në dukje përparësitë e këtij lloji të shkurorëzimit në raport me shkurorëzimin me padi.

Shkurorëzimi sot paraqet një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës familjare në vendin tonë por edhe më gjërë. Është një nga të drejtat themelore të së drejtës familjare, por që në disa shtete të botës ende kufizohet në mënyra të ndryshme, duke parashikuar baza të veçanta për shkurorëzim, arsye të forta, por edhe duke ia kufizuar këtë të drejtë femrave (siç është shembulli në disa shtete të Mbretërisë Arabe). Kjo e drejtë themelore nuk është një e drejtë e lindur, por është një e drejtë që fitohet, dhe bazë për fitimin e kësaj të drejte është lidhja e martesës. Sot e drejta e shkurorëzimit garantohet jo vetëm me aktet e brendshme të shtetit duke filluar nga Kushtetuta, Ligji, por garantohet edhe me shumë konventa të ndryshme ndërkombëtare të miratuara dhe ratifikuara edhe nga RM.

KAPITULLI I

1. MARTESA, E DREJTA MARTESORE SI E DREJTË POZITIVE

E drejta martesore është e drejtë pozitive. Pjesa më e madhe e normave juridike, me të cilat rregullohet e drejta martesore janë të natyrës operative, si lidhja dhe zgjidhja e martesës, ndërsa vetëm një pjesë e vogël janë të natyrës dispozitive, si caktimi i mbiemrit me rastin e lidhjes së martesës, vendbanimi. E drejta martesore është edhe pjesë përbërëse e shkencës familjare juridike.¹

E drejta martesore është një përmbledhje normash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet martesore. Normat juridike me të cilat rregullohet martesja dhe marrëdhëniet martesore janë kryesisht të natyrës urdhëruese. Me normat të natyrës urdhëruese rregullohet forma e lidhjes së martesës, zgjidhja e martesës, marrëdhëniet pasurore juridike si dhe edhe marrëdhënie të tjera të rëndësishme nga sfera e jetës bashkëshortore. Përveç me norma urdhëruese për shkak të marrëdhënieve mes bashkëshortëve ekzistojnë edhe shumë marrëdhënie martesore të tjera të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv, me marrëveshje të bashkëshortëve (marrëveshje për mbiemrin, për vendbanimin e përbashkët, kryerjen e punëve të amvisërisë etj). E drejta martesore në të njëjtën kohë është edhe pjesë përbërëse e pjesës familjare juridike. Ajo merret me studimin e marrëdhënieve martesore dhe martesës.²

Martesa në përgjithsi njihet si njëri nga institucionet më të lashta dhe më të rëndësishme juridike dhe shoqërore. Për natyrën juridike të martesës ekzistojnë dy koncepte kryesore: martesja është kontratë civile, dhe martesja është institucion juridik. I pari që e cilëson martesën si kontratë i ka rrënjët e veta në të drejtën romake dhe ka qenë sanksionuar shprehimisht në legjislacionin kishtar (*codex iuris kanonici, canon*). Natyra urdhëruese e normave juridike të cilat zbatohen në rastet e lidhjes së martesës dhe zgjidhjes së martesës të cilat bashkëshortët nuk mund ti ndryshojnë me shprehjen e lirë të vullnetit, kontratës së martesës i japin karakter specifik kundrejt kontratës së shitblerjes apo kontratave tjera civile. I dyti e cilëson martesën si institucion juridik, sipas këtij koncepti pohojnë se martesja krijon statusin juridik bashkëshortor për burrin dhe gruan dhe kështu formohet familja; ndërsa martesja që ka përmbajtje dhe synim kontratën, ku si subjekt i marrëdhënieve martesore mundet të jetë vetëm një burrë dhe një grua ndërsa te kontrata civile mundet të ketë dy e më shumë palë kontraktuese; për lidhjen e martesës

¹Podvorica Hamdi, E drejta Familjare, Prishtinë, 2005, fq.67

² Po aty, fq.59

egzistojnë pengesa martesore absolute si: gjinia e gjakut në vijë të drejtë pa kufi dhe në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, kurse për lidhjen e kontratave civile nuk janë vënë pengesa të tilla, marrëdhëniet martesore kanë karakter personal dhe si rrjedhojë natyra dhe përmbajtja e tyre është krejtësisht ndryshe nga ato që krijohen për debitorin dhe kreditorin kur është fjala për cilëndo kontratë, ku dispozitat ligjore për lidhjen dhe zgjidhjen e martesës janë të natyrës urdhëruese. Kështu që shumë fakte shkojnë në favor se martesa është një institucion juridik. Lidhja e martesës para organit kompetent shtetëror me deklarimin e vullnetit të lirë dhe pëlqim të ndërsjelltë të bashkëshortëve të ardhshëm përjashton çdo mundësi për të cilësuar martesën si kontratë civile aq më tepër që shteti e vë nën kujdesje shoqërore dhe mbrojtje shtetërore si një institucion i rëndësishëm juridik dhe shoqëror. Përfaqësuesit e konceptit se martesa është një kontratë juridike civile, martesën e cilësojnë si jetesë të përbashkët të një burri dhe një gruaje me qëllim që ti ndihmojnë njëri-tjetrit dhe ti rrisin femijët e vet.³

Sipas nenit 6 të Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë:

Martesa është e rregulluar me Ligj dhe paraqet bashkësinë e jetesës midis një burri dhe gruaje ku ushtrohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet midis bashkëshortëve bazohen në vendimin e lirë të burrit dhe gruas për tu martuar duke marrë parasysh ndershmërinë, respektin reciprok dhe ndihmën reciproke.

Sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

- 1. Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje.*
- 2. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.*
- 3. Lidhja dhe zgjidhja e martesës rregullohen me ligj.⁴*

³Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq.68

⁴ Shih Kushtetutën e R.Sh Pjesa II, Kreu I, nenet 15-20

Sipas nenit 14 të Ligjit për Familje të Republikës së Kosovës:

1. *Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.*
2. *Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.⁵*

Martesa si institucion juridik është koncept sipas të cilit ajo krijon statusin juridik bashkëshortor për burrin dhe gruan dhe kështu formohet familja, pra përfaqësuesi i konceptit të martesës është kontrata civile, dhe këtë e cilësojmë si jetesë të përbashkët të një burri dhe të një gruaje që ti ndihmojnë njëri - tjetrit dhe ti rrisin fëmijët e tyre, ndërsa përfaqësuesit e konceptit se martesa është një institucion juridik, martesën e cilësojnë si jetesë të përbashkët të një burri dhe një gruaje të sistematizuar sipas ligjit dhe që nuk mund të zgjidhet vetë. Me rastin e martesës kirjohen edhe të drejta dhe detyrime midis personave në martesë. Këto marrëdhënie janë rregulluar me ligj, e posaçërisht marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve në martesë,⁶ “bashkëshortët në martesë janë të barabartë, në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pronësore”, mbi bazën e kësaj marrëdhënie familjare janë bazuar në parimin e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas për më tepër, të respektit reciprok dhe ndihmës të ndërsjelltë midis anëtarëve të familjes.⁷

Institucioni i martesës haset në të gjitha shoqëritë njerëzore të botës së hershme dhe asaj moderne, e cila përbën një nga shtyllat mbi të cilat këto shoqëri kanë ngritur tërë ngrehinën e tyre dhe ka qenë objekti i studimit dhe i përkufizimit nga shumë shkolla fetare, filozofike, sociologjike, psikologjike, kulturore etj. Në shumë kultura është parë si një kusht i domosdoshëm për përjetësimin e gjinisë njerëzore, si një vatër e domosdoshme për rritjen dhe zhvillimin e njeriut si individ dhe person dhe në këtë kuadër edhe si bërthama e shumë shoqërive në anë të ndryshme të globit. Në mjaft fe që mbizotërojnë në planetin tonë përbën një nga çështjet më kryesore dhe të shenjta, shpeshherë tabu dhe është mbrojtur nga ana e tyre me tërë arsenalin e argumenteve teologjike dhe filozofike, në mënyrë që të ruajë tërë rëndësinë dhe shenjtërinë e saj, duke u prezervuar edhe nga legjislacionet përkatëse në ato vende, ku këto fe kanë predominuar

⁵ Shih Ligjin për Familje të Republikës së Kosovës, Ligji. Nr.2004/32, Pjesa e II, Kreu i II, nenet 15-16

⁶ Shih Ligji për familjen i RM-së, GZ e RM-së nr.80/92, tekst i konsoliduar – 2008, Kreu I, Neni 5-6

⁷Podvorica Hamdi, vepër e cituar, fq.68

gjatë përhapjes së tyre. Mund të thuhet se marrëdhëniet që lindin nga martesë janë të llojllojshme, si të natyrës personale juridike, ashtu edhe pasurore juridike. Marrëdhëniet personale juridike janë të rregulluara me norma juridike pozitive, si psh: kushtet për lidhjen e martesës, shkaqet e pavlefshmërisë së martesës, të drejtat dhe detyrat e çiftit bashkëshortor, shkaqet e pushimit ose zgjidhjes së martesës, pasojat e shkaktuara nga shuarja etj. Martesa, në shumë përkufizime që mund të hasen në fjalorë të ndryshëm filozofik ose sociologjik modernë përkufizohet si një institucion në të cilin marrëdhëniet ndërpersonale midis burrit dhe gruas janë të njohura nga shteti, nga autoriteti fetar, ose nga të dy së bashku. Në disa shkolla është parë madje edhe si një kontratë. Në shkencën juridike martesë civile mbrohet nga shteti, në përputhje me Kodin e Familjes, që është pjesë e rëndësishme e legjislacionit të një vendi të caktuar. Akti i martesës që njihet nga shteti ose nga feja, i atyre personave që lidhin martesë, ndryshon tërë statusin personal dhe shoqëror të tyre.⁸

Martesa ekziston si formë dhe mënyrë jetese qysh në fillimet e historisë së njerëzimit. Është pikërisht libri i parë i Biblës, ai i Gjenezës që na e tregon këtë fakt, atëherë kur Perëndia e krijoi njeriun mashkull dhe femër dhe kur e urdhëron të shumëhet mbi dhë (Gjen. 1:26-28). Qysh në këtë pasazh, Perëndia i shfaq njeriut se gjendja natyrale në të cilën njeriu është i thirrur të marrë pjesë dhe të zhvillohet më tej është ajo e martesës, pra e lidhjes midis burrit dhe gruas në një lidhje intime dhe të përjetshme. Pikërisht kjo lidhje përbën një nga institucionet që Perëndia ia zbuloi njeriut dhe si i tillë është i themeluar hyjnisht. Edhe nëpër fetë e mëdha monoteiste, por edhe në ato të Azisë dhe Afrikës, kjo lidhje ekziston si derivat i këtij fakti dhe është theksuar dhe mbështetur si një nga gjërat më të rëndësishme që bëjnë pjesë në ceremonitë e shenjta dhe ligjet e këtyre feve, pavarësisht variacioneve dhe qëllimeve të ndryshme që e karakterizojnë.⁹

Në Judaizëm¹⁰ martesë është një lidhje kontraktuale midis çiftit, gjë që urdhërohet nga Perëndia dhe në këtë rol hyjnor është shumë i theksuar. Riprodhimi nuk konsiderohet si qëllimi i vetëm i martesës. Sipas Kabbalah, shkollës judaike të misticizmit, njeriu kur martohet shtyhet nga fakti se i vetëm është një shpirt i mangët, i paplotësuar dhe që për të qenë i përsosur ka nevojë për një shpirt tjetër që të arrihet kjo përsosmëri. Në ligjin judaik Halakha parashikohet fillimisht fejesa shiddukhin, e cila përkufizohet si premtim i ndërsjellë midis burrit dhe gruas për të bërë kontratën e një martese në një kohë të ardhshme dhe cakton mënyrat dhe kohën kur do të

⁸ Mandro A., E Drejta Romake, Tiranë, fq. 95-120.

⁹ Po aty.

¹⁰ Mack J., Preserve them o God, bot. Con. Press, fq. 15-19

kryhet. Fejesa nuk ndryshon statusin personal të dy palëve, ose nuk i jep të drejtën njërës palë të parashtrojë kërkesa specifike. Në ligjin judaik, martesë konsiston në dy akte të veçuara, të quajtura kiddushin, që është ceremonia e fejesës dhe nissu'in, ceremonia e martesës. Kiddushin sjell ndryshimin e statusit personal të çiftit, kurse nissu'in sjell pasojat ligjore të ndryshimit të këtij statusi.

Tri janë mënyrat për ndryshimin e statusit të çiftit:

- *Me para (kesef) ose me një objekt që ka vlerë, si një unazë ose një monedhë, me qëllim kontraktimin e martesës dhe kjo bëhet në praninë e dy dëshmitarëve.*
- *Me anë të një kontrate (shtar) në praninë e dy dëshmitarëve, ku shkruhet deklarata e kiddushin.*
- *Me anë të kryerjes së një marrëdhënieje seksuale duke pasur si qëllim krijimin e një lidhjeje martesore, por kjo mënyrë nuk këshillohet nga shkrimet e rabinëve dhe përdoret vetëm për martesat e leviratit (kur dikush martohet me vejushën e vëllait të tij).*

Në Hinduizëm,¹¹ një martesë hindu, bashkon dy individë përjetë, që ata të kenë mundësi të vazhdojnë harma-n (detyrën e tyre), artha (zotërimet), kama-n (dëshirat fizike) dhe noksa-n (çlirimin përfundimtar shpirtëror) së bashku. Gjithashtu ajo i bashkon dy familje bashkë. Zakonisht martesë është diçka që rregullohet nga prindërit në bazë të disa rrugëve që ata i për zgjedhin sipas mundësisë ose besimit të tyre, zakonisht me ndihmën e një prifti i cili luan rol kyç në këtë martesë. Gjithashtu përdoren edhe harta astrologjie në gjetjen e kandidatëve të përshtatshëm ose këshillohen edhe me një brahman të quajtur “panthulu” i cili ka parasysh kandidatë të përshtatshëm ndër ata njerëz që duan të martohen. Kurse disa komunitete kryesisht ato të brahmanëve në Mithila, përdorën regjistra të dhënash gjenealogjike që mbahen nga specialistë. Gjithashtu edhe martesë e quajtur vedike, ka qenë një nga tipet e martesës hindu. Kurse martesë me dashuri ndeshet shpesh në literaturën hindu dhe kanë ekzistuar disa emërtime të saj si gandarha vivaha etj.

Në Islam, martesë (“zavaj”), është një lidhje e ligjshme dhe një kontratë sociale midis burrit dhe gruas, siç diktohet nga sheriat. Ka dy lloj martesash që përmenden në Kuran, nikah dhe nikah mut’ah. Nikah, që e përkthyer do të thotë kontratë, është forma e parë dhe që haset më shpesh për myslimanët, e cila përshkruhet edhe në Kuran.

¹¹ Elchanini v A., Diary of a Russian Priest, bot. Con. Press, fq. 46.

Disa nga qëllimet e kësaj martese janë:

- a) *Qëllimi i saj është që burri dhe gruaja të kenë një lidhje të qëndrueshme, por të dy kanë të drejtën të kërkojnë divorcin.*
- b) *Çifti trashëgon njëri nga tjetri.*
- c) *Nënshkruhet një kontratë midis dy palëve. Burri duhet të paguajë për pajën e gruas.*

Në Islam poligjinia është e lejuar me kusht sipas disa rregullave të përcaktuara qartë. Në teologjinë islamike, të dyja gjinitë janë të barabarta në vlerë dhe ndryshimet midis tyre njihen për shkak të të drejtave, obligimeve dhe roleve të ndryshme. Zakonisht gruaja myslimane është parë si një amvise dhe rritëse e fëmijëve. Qenia nënë konsiderohet një nga rolet më të rëndësishme në shoqëri.

1.1 MARTESA NË EVROPË

Në **Greqinë e Vjetër**, nuk ka ekzistuar një ceremoni specifike për martesën dhe ishte vetëm një marrëveshje e ndërsjellë midis burrit dhe gruas. Burrat martoheshin kur ishin në moshën 20 ose 30 vjeç dhe donin që gratë e tyre të ishin adoleshente të hershme. Gratë e martuara kishin të drejta të pakta në Greqinë e Lashtë dhe kujdeseshin kryesisht për fëmijët dhe shtëpinë.

Në **Romë**, në fillim martesa nuk parashikonte aprovimin e veçantë të fesë ose të shtetit dhe njësoj si në Greqinë e Lashtë, bazohej në një marrëveshje të ndërsjellë midis burrit dhe gruas. Të drejtën për të lidhur martesë e kishin vetëm personat që kishin ius conubi. Këtë të drejtë e kishin qytetarët romakë, latinët e vjetër dhe me kufizime plebejtë, libertinët dhe grupet e lidhura me profesione të ndryshme, por në periudhën postklasike kjo gjendje ndryshoi për shkak të përhapjes së krishterimit.¹²

Gjithashtu përveç këtij kushti, kishte dhe të tjerë si affectio maritalis (qëllimi për të krijuar bashkësinë martesore) dhe forma e parashikuar me ligj për lidhjen e saj. Kuptimi klasik i saj ishte i shprehur nga Modestinos (250 para Krishtit): “Martesa është bashkimi i gruas dhe i burrit, një lidhje e përjetshme dhe komunikim i së drejtës hyjnore dhe njerëzore”. Kjo lidhje daton qysh në kohët më të hershme kur burri dhe gruaja formonin një bashkësi të mirash dhe kultesh. Martesa përmbante në vetvete elementin subjektiv ose qëllimor dhe atë objektiv dhe material, që konkretizohej me bashkëjetesën e burrit dhe të gruas në një bashkim permanent.

¹² Dr. Ivo Puhani, E drejta romake, Enti i teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1980, fq.169

Kurse elementi subjektiv lidhet me vullnetin e dy palëve që japin konsensusin e tyre për të bërë lidhjen e martesës. Në të drejtën post klasike të Justinianit, e cila u zhvillua nën dritën e Krishterimit, ai solli ndryshime të mëdha shoqërore në çdo aspekt të jetës, përfshi edhe atë të martesës si p.sh. pazgjidhshmëria e saj me përjashtim të atyre rasteve të cilat parashikohen edhe në Kanunet e Shenjta të Kishës. Është me rëndësi të theksojmë se Justiniani i kushtoi shumë rëndësi elementit të konsensusit me anë të një marrëveshjeje fillestare. Në Romë ka ekzistuar edhe fejesa ose sponsalia, ku jepeshin dhe merreshin premtimet për lidhjen e martesës. Në shoqërinë romake kanë ekzistuar forma të ndryshme martesash:

Forma e parë ishte *coemptio* ose blerja reale e gruas, ku ati i nuses në prani të 5 dëshmitarëve, ia dorëzonte nusen pater-familias të dhëndrit, duke marrë një monedhë si simbol të kësaj lidhjeje. *Confereatio* ishte forma e dytë, ajo më solemne që përdorej nga shtresat më të larta të shoqërisë, që kryhej në prani të 10 dëshmitarëve dhe të fejuarit. Dhëndri i jepte nuses kur ajo mbërrinte në derën e shtëpisë, bukë, zjarr dhe ujë, kurse ajo duhej të thoshte “kudo që të jesh ti, do të jem edhe unë”. *Usus* që është forma më e përhapur në shtresat e varfëra të popullsisë dhe që konsistonte në një transferim të thjeshtë të nuses në shtëpinë e burrit. Karakteristikë e kësaj martese ishte se martesa ishte pa manus në ndryshim nga martesat e tjera, ku manusi, pushteti i burrit ose i pater-familjas ushtrohej mbi gruan që bëhej pjesë e familjes së burrit, duke i ndërprerë lidhjet me familjen e saj. Në periudhën e Justinianit u sanksionua që për lidhjen juridike të martesës, duhej kërkuar edhe kryerja e shërbesës kishtare të martesës dhe u nxorën edhe ligje që e favorizonin dukshëm martesën si një sakrament i caktuar hyjnerisht.¹³

1.2 PARIMET THEMELORE TË SË DREJTËS MARTESORE

Kushtetuta si akt ligjor juridik më i lartë i një vendi përmban parimet themelore edhe të së drejtës martesore. Këto parime mandej vihen në themelet e shkencës martesore juridike. Ato garantohen dhe përpunohen më tej si në Ligjin për Familje ashtu edhe me dispozita të tjera përkatëse ligjore. Parimet themelore të së drejtës martesore janë: parimi i barazisë, laicitetit, parimi i institucionalitetit, parimi i monogamisë dhe parimi i jetës së vazhdueshme.¹⁴

Parimi i barazisë - Në shekuj pozita e gruas ka qenë nënshtruese dhe e pabarabartë me burrin. Burri kishte pushtetin e plotë mbi gruan dhe mbi pasurinë e saj, ndërsa gruaja ndodhej në

¹³ Dr. Ivo Puhani, E drejta romake, Enti i teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1980, fq.170

¹⁴Podvorica Hamdi, vepër e cituar ,fq.60

pozitë inferiore dhe diskriminuese. Kjo vlente për të gjitha shoqëritë e lashta të njerëzimit, siç ishte ajo indiane, latine dhe romake.¹⁵

Parimi i laicitetit - Në rregullativën ligjore gjen shprehje shumë shpesh definicioni se martesë është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj. Nga përmbajtja e një formulimi të tillë rrjedh interesimi i shoqërisë së gjerë që ky institucion shoqëror të jetë i rregulluar me dispozita ligjore dhe i mbrojtur nga shoqëria dhe shteti.¹⁶

Parimi i institucionit - Martesa është institucion shoqëror dhe gëzon mbrojtje shoqërore. Martesa dhe marrëdhëniet martesore juridike janë të rregulluara me dispozita ligjore. Martesa tek ne është një institucion laik. Mbrojtje juridike gjen vetëm martesë civile, e cila është e rregulluar juridikisht dhe lidhet përpara organit kompetent shtetëror.¹⁷

Parimi i monogamisë - Ky është padyshim njëri nga parimet themelore të së drejtës martesore. Me monogami kuptojmë martesën në të njëjtën kohë të një burri me një grua. Parimi i monogamisë gjen shprehje në dispozitën e nenit 14 të LFK-së, por edhe në dispozitat ligjore të vendeve të tjera, me të cilat rregullohet martesë dhe marrëdhëniet martesore (neni 7 i KF së Shqipërisë dhe neni 15 i LF të Republikës së Maqedonisë). Martesa monogami është trajtë dominuese e martesës në të drejtën bashkëkohore.¹⁸

Parimi i vazhdimësisë së jetesës martesore - Martesa është po ashtu bashkësi e vazhdueshme e jetesës së burrit me gruan. Kjo do të thotë se në pikëpamje kohore martesë nuk mund të kufizohet, veçse zgjat aq sa zgjat edhe jeta e bashkëshortëve.¹⁹

¹⁵ Dr. Ivo Puhani, vepër e cituar, fq.184

¹⁶ Podvorica Hamdi, vepër e cituar, fq.63

¹⁷ Dr. Mira Aliniç, Ana Bakariç, Porodico Pravo, Zagreb, 1980, fq.18

¹⁸ Po aty, fq.19

¹⁹ Po aty.

1.3 QËLLIMI I MARTESËS

Qëllimet martesore rrjedhin nga vetë përmbajtja e martesës si bashkësi jetësore e një burri dhe gruaje dhe si bazë e ligjshme e krijimit të një familje. Kryesisht mund të thuhet se martesa ka tre qëllime më kryesore.²⁰

a). Qëllimi natyror, b). Qëllimi moral dhe c). Qëllimi shoqëror.

Qëllimi natyror – Thuajse qëllimi më kryesor i martesës ishte dhe mbetet edhe më tutje lindja dhe mirërritja e fëmijëve, që nënkupton kryerjen e marrëdhënieve seksuale të burrit me gruan.

Qëllimi moral – Në martesë bashkëshortët kanë detyrë ta ndihmojnë njëri-tjetrin në nevojë, ta mirëkuptojnë e ta mbrojnë, të kujdesen dhe ta shërojnë në rast të sëmundjes, ti japin përkrahje morale dhe materiale në çaste të vështira.

Qëllimi shoqëror – Martesa nuk është çështje private, veçse institucion shoqëror, ajo është bazë e familjes, që ka detyrë të kryejë funksione të shumta shoqërore, para së gjithash në vetëdijësimin dhe ngritjen e shëndoshë të brezave të rinj.

1.4 KUSHTET PËR LIDHJEN E MARTESËS, PENGESAT DHE NDALESAT

Një martesë e vlefshme mund të lidhet vetëm në kushtet e parashikuara me dispozitat ligjore. Martesa mund të lidhet vetëm në mënyrë të lirë e me pelqimin e plotë të personave që duan të lidhin martesë. Familja është celulë shoqërore dhe shtetërore.²¹

Regjimi i kushteve dhe ndalesave për martesë ka rëndësi të veçantë, sepse:

- *Përcaktohet (pa) vlefshmëria e martesës. Kjo ndodh sepse lidhja e saj është e bërë mbi bazën e një akti.*
- *Përcaktohen personat e ligjimituar për të kundërshtuar lidhjen e martesës. Vetëm nëse kushtet nuk janë ose ndalesat janë për aq kohë sa që martesa ende nuk është e lidhur, ajo mund të kundërshtohet e kështu të parandalohet pavlefshmëria e saj në të ardhmen.*
- *Përcaktohen motivet e kundërshtimit ose të pavlefshmërisë absolute, këto lidhen vetëm me kushtet dhe ndalesat për martesë të cilat janë përcaktuar rigorozisht nga Kodi i Familjes së Shqipërisë.*

²⁰Podvorica Hamdi, vepër e cituar, fq.70

²¹ Po aty fq.71-72

Kushtet thelbësore quhen ata elemente thelbësore të përgjithshëm dhe individuale që duhet të plotësojnë dhe që nuk duhet të mbartin bashkëshortët e ardhshëm në mënyrë që të kenë zotësi për të lidhur martesë. Askush nuk mund të lidhë një martesë juridikisht të vlefshme nëse nuk plotëson këto elemente siç janë kushtet.²²

Kushtet për lidhjen e martesës ose kushtet thelbësore, siç quhen ndryshe, janë:

1. *Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm,*
2. *Sekset e kundërta,*
3. *Lidhja e martesës përpara organit kompetent.*

1. Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm – Kusht për lidhjen e martesës së vlefshme është që bashkëshortët e ardhshëm të deklarojnë pëlqimin se martesën e lidhin me vullnetin e lirë dhe se nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa martesore.²³

2. Sekset e kundërta – Sekset e kundërta përbëjnë komponentin biologjik, kulturor dhe civilizues të një martese. Shikuar historikisht, martesa ka qenë një privilegj i gruas dhe burrit, pra i dy personave të sekseve të kundërta.

3. Lidhja e martesës përpara organit kompetent – Deklarimi i vullnetit të lirë për lidhjen e martesës së personave me sekse të kundërta përmban në vetvete dy komponente të rëndësishme:

- a) Vullneti të jetë i shprehur përpara organit kompetent për lidhjen e martesës dhe
- b) Në mënyrën e parashikuar në ligj.

Çfarë duhet të jetë vullneti i shprehur – Para së gjithash, vullneti i shprehur për të qenë një martesë e vlefshme duhet të ketë cilësitë e caktuara:

- a) Të jetë real e jo simulativ,
- b) Të jetë serioz e jo i shprehur sa për shaka,
- c) Dy deklaratat duhet të jepen në të njëjtën kohë, suksesivisht në çastin e lidhjes së martesës. Secili bashkëshort vullnetin e vet duhet ta shpreh personalisht dhe veç e veç, e kjo nënkupton prezencën e bashkëshortëve.²⁴

Lidhja e martesës përpara organit kompetent – Deklarimi i vullnetit të lirë për lidhjen e martesës së personave me gjini të kundërta përmban në vetvete dy komponente të rëndësishme:

²² Balili Arta-Mandro, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana “E drejta familjare” fq.92

²³ Valentine Zace, vepër e cituar, fq.60

²⁴ Po at, fq.61

- a) Vullneti të jetë i shprehur përpara organit kompetent për lidhjen e martesës dhe
- b) Në mënyrën e parashikuar me ligj.

Pengesat martesore janë fakte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht me ligj, ekzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vlefshme. Ato ndryshe quhen kushte negative dhe nuk mund të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës, sepse paraqesin pengesë për lidhjen e saj dhe shkaktojnë anulimin e martesës.

Pengesat martesore mund ti klasifikojmë në dy grupe:

- 1). *Mungesa e vullnetit,*
- 2). *Martesa ekzistuese,*
- 3). *Sëmundja psiqike dhe pazotësia për të vepruar,*
- 4). *Gjinia dhe*
- 5). *Mituria.*

Mungesa e vullnetit - Vullneti i deklaruar lirisht është prezumim i vetëm për lidhjen e një martese të vlefshme. Pra, ai e fiton rëndësinë e vet juridike kur të jetë i shprehur, kur të tjerët do të jenë në mundësi për ta kuptuar atë.²⁵ Dhuna nënkupton shtrëngimin apo kanosjen e njërit bashkëshort apo dy bashkëshorteve për të lidhur martesë kundër vullnetit të tyre. Dhuna mund të jetë psikologjike dhe fizike. Dhuna është psikologjike kur ekziston kërcënimi ndaj bashkëshortit tjetër për të lidhur martesë kundërshtim me vullnetin e tij, sepse në qoftë se nuk e deklaroi vullnetin për lidhjen e martesës do të shkaktohet ndonjë e keqe e madhe ose ndaj tij do të ushtohet dhunë fizike. Kanosja duhet të jetë serioze e mundshme dhe e kundërligjshme. Dhuna fizike dallon nga dhuna psikologjike sepse ajo fillon të ekzekutohet. P.sh. mbajtja e dorës me forcë me rastin e firmosjes së deklaratës së vullnetit për lidhjen e martesës. Lajthimi ekziston kur njëri bashkëshort ka pasur mendim të gabueshëm mbi rrethanat, faktet dhe mbi cilësitë thelbësore të bashkëshortit tjetër për lidhjen e martesës.

Martesa ekzistuese - Ligji shprehimisht parasheh pavlefshmerinë e martesës së re derisa martesa e parë e njërit bashkëshort nuk zgjidhet ose nuk pushon në mënyrën e parashikuar me ligj. Kjo nuk do të thotë se nuk mund të lidhet një martesë tjetër para se të zgjidhet e mëparshmja.²⁶

²⁵ Podvorica Hamdi, vepër e cituar, fq.84

²⁶ Po aty, fq.84

Sëmundja psiqike dhe pazotësia për të vepruar - Nuk mund të lidhë martesë personi me sëmundje psiqike ose me zhvillim mendor të metë dhe personi me pazotësi veprimi. Sëmundja dhe pazotësia e veprimit duhet të ekzistojë në momentin e lidhjes së martesës. Nëse paraqiten pas lidhjes së martesës ajo bëhet shkak për zgjidhje të martesës. Arsytet që kjo të jenë pengesë martesore qëndrojnë në faktin se personi pa zotësi veprimi nuk mund të bën deklarinimin e vullnetit në mënyrë valide dhe se sëmundja psiqike mbartet nga prindërit në pasardhësit.

Gjinia e gjakut - është pengesë martesore në shkallë dhe vija të parapara me dispozita ligjore. Kështu në vijë të drejtë pakufi kurse në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt. Gjinia e gjakut paraqitet si pengesë absolute martesore për shkaqe oportuniteti, si morali, shkaqe psikologjike dhe arsye eugenike apo biologjike.²⁷

Mituria - është një pengesë absolute martesore, sepse vetëm personi madhor mund të lidhë martesë të vlefshme juridikisht. Me termin i mitur në të drejtë martesore nënkuptojmë moshën e caktuar e cila sipas ligjit nuk konsiderohet e mjaftueshme që dy persona me gjini të kundërta të mund të lidhin martesë.²⁸

Ndalesat për martesë janë:

Mungesa e *status liberum* - që do të thotë se në çastin e lidhjes së martesës së re njeri ose të dy bashkëshortet janë në një raport martesor ekzistues dhe nuk janë në kushtet e gjendjes së lirë. Statusi liberum nuk ekziston nëse ende nuk ka mbaruar martesë e mëparshme. Sipas legjislacionit shqipëtar, respektohet parimi i martesës monogame. Kjo lloj ndalese është e detyrueshme dhe ndikon në martesë, duke i shkaktuar pavlefshmërinë absolute nëse nuk respektohet. Nuk shkaktohet ndalesa nëse martesë e mëparshme për shkak të vdekjes së bashkëshortit ose shpalljes së vdekur, kjo nuk pengon lidhjen ose shpalljen e pavlefshmërisë së martesës së re dhe nuk e vë në rrezik parimin e monogamisë.²⁹

Lidhjet e gjakut - përbëjnë ndalesë për martesë lidhjet e gjakut në vijë të drejtpërdrejtë pa kufizime dhe në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt përderisa si rregull janë të ndaluara martesat midis fëmijëve të vëllezërve dhe motrave.³⁰

²⁷Podvorica Hamdi, vepër e cituar, fq.84

²⁸Po aty, fq. 85

²⁹Po aty fq.103

³⁰Po aty fq.104

Lidhjet e krushqisë - përbëjnë ndalesë për martesë lidhjet afinitive siç janë ata në mes vjerit dhe nuses; njerikut dhe thjeshtres. Kjo martesë është e ndaluar edhe në rast se martesë që e ka krijuar ose e ka prodhuar këtë lidhje është shpallur e pavlefshme ka pushuar ose është zgjidhur që dmth ose është shpallur e pavlefshme ose ka pushuar.³¹

Sëmundja psikike ose zhvillimi i metë mendor përbën ndalesë për martesë, ekzistenca tek njëri nga bashkëshortët e ardhshëm të gjendjes së të sëmurit rëndë psikikisht ose me zhvillim të metë mendor të tillë që bën të pamundur të kuptuarit e qëllimit të martesës.³²Familja është qeliza bazë e shoqërisë dhe ajo ka nevojë për subjekte të matura dhe të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që burojnë nga martesë.

³¹ Po aty fq.112

³² Po aty fq.113

1.5 KUSHTET FORMALE PËR LIDHJEN E MARTESËS

“KUPTIMI FORMAL”

Pas lindjes dhe vdekjes lidhja e martesës është një nga momentet më të rëndësishme në jetën e njeriut. Forma e lidhjes së martesës është civile. Për herë të parë forma civile e detyrueshme për lidhjen e martesës në Shqipëri parashihet me Kodin civil të vitit 1929. Martesa celebrhet përpara nënpunësit të gjendjes civile të bashkësisë ose të komunës. Ajo më vonë është parashikuar edhe në kodet e mëvonshme të familjes. Martesa lidhet përpara nënpunësit të gjendjes civile sepse martesa që nuk është e lidhur publikisht dhe para nënpunësit të gjendjes civile është martesë e pavlefshme. Forma e lidhjes së martesës tregon edhe një herë se e drejta jonë hyn në kuadrin e të drejtave formaliste në çështje që lidhen me familjen dhe martesën. Këtë karakteristikë e kanë trashëguar nga e drejta romake të gjitha legjislacionet që i përkasin sistemit kodifikues. Kjo nuk pengon bashkëshortët e ardhshëm që të oranzojnë ceremonia nga më të ndryshmet si në kishë apo xhami, por kjo në qoftë se nuk është celebruar sipas kritereve ligjore nuk është e njohur juridikisht dhe nuk mbrohet nga legjislacioni familjar.³³

Forma solemne dhe lidhja e martesës lokale e posaçme zyrtare, forma civile dhe prezenca e personelit të caktuar me rastin e lidhjes së martesës, lokali i posacëm dhe atmosfera solemne e cila krijohet tregojnë për rëndësinë e madhe që ka akti i lidhjes së martesës për bashkëshortët nga njëra anë, kurse nga ana tjetër për interesimin dhe mbrojtjen e vecantë shtetërore dhe shoqërore që gëzon institucioni i martesës, dhe së fundi publiciteti dhe solemniteti i lidhjes së martesës mundësojnë të provuarit më të lehtë të ekzistimit të martesës në rastet e nevojshme (forma ad probationem).³⁴

Si elemente kryesore të formës së lidhjes së martesës cilësohen:

- a) *Kompetenca për lidhjen e martesës dhe*
- b) *Mënyra për lidhjen e martesës.*

Kompetenca për lidhjen e martesës - dallojmë kompetencën lëndore, tokësore dhe funksionale. Me kompetencë lëndore nënkuptojmë rrethin e punëve të organit të autorizuar për lidhjen e martesës dhe kjo çështje është rregulluar me norma të karakterit urdhërues.³⁵

Kompetenca tokësore me të cilën kuptojmë territorin mbrenda të cilit e ushtron funksionin e vet organi për lidhjen e martesës, në juridiksionin e të cilit njëri nga bashkëshortët e

³³ Balili Arta-Mandro, Mecaj Vjollca, Zaka Tefta, Fullani Arjana “E drejta familjare” fq.119

³⁴ Podvorica Hamdi “E drejta familjare”, Prishtinë, 2005, fq.91

³⁵ Po aty fq.93

ka vendbanimin ose vendqendrimin. Me kompetencën funksionale nënkuptojmë funksionet e personelit zyrtar pjesëmarrës në procesin për lidhjen e martesës në bazë të autorizimeve që rezultojnë nga normat ligjore.

Mënyra e lidhjes së martesës - mënyra e lidhjes së martesës paraqet tërësinë e rregullave të cilat duhet respektuar me rastin e lidhjes së martesës. Mënyra e lidhjes së martesës është rregulluar detajisht me norma ligjore. Mosrespektimi i tyre shkakton nulitetin e martesës.³⁶

1.6 ANULIMI I MARTESËS

Quhet e pavlefshme një martesë e lidhur pa u plotësuar kushtet e kërkuara në ligj për plotëfuqishmërinë e saj. Përveç sanksionit të natyrës juridiko familjare - anulimit të martesës, ligji ka paraparë edhe sanksionin penalo-juridik. Anulimi i martesës shkakton efekte vetëm në të ardhmen, asesi prej momentit të lidhjes së punës së pavlefshme juridike, tipar ky i cili dallon anulimin e martesës nga teoria e pavlefshmërisë së punëve juridike. Shkaqet kryesore të mbarimit të martesës janë: vdekja e njërit bashkëshort dhe zgjidhja e martesës.

a) Vdekja e njërit bashkëshort - vdekja është mënyra më natyrale e mbarimit të martesës. Martesa si bashkësi e vazhdueshme e jetesës së një burri dhe një gruaje, mbaron inter vivos dmth me vdekjen e njërit bashkëshort. Me vdekjen e njërit bashkëshort përfundimisht mbaron jetesa e përbashkët, si dhe të drejtat dhe detyrat e tyre. Ajo provohet me aktvdekje të lëshuar nga nënpunësi i gjendjes civile. Prej momentit të vdekjes së njërit bashkëshort, bashkëshorti i gjallë fiton të drejta dhe detyrime të reja, fiton të drejtën e trashëgimisë të pjesëtimit të pasurisë së përbashkët, fiton të drejtën e lidhjes së martesës së re etj. Pra mund të themi se e drejta e bashkëshortit pas jetues për tu rimartuar shfaqet si një e drejtë themelore e personalitetit, po aq e rëndësishme sa e drejta e çdo personi për tu martuar për herë të parë.

b) Shpallja e njërit bashkëshort të zhdukur - quhet i zhdukur një person të cilit nuk i dihet as vendbanimi, as vendqëndrimi ndërsa në bazë të rrethanave të rastit besohet se ka vdekur. Në qoftë se njëri prej bashkëshortëve është i zhdukur as qëllimi as përmbajtja e martesës smund të përmbushen. Shpallja e personit të zhdukur për të vdekur mënjanon të gjitha paqartësitë rreth vdekjes së tij. Prej momentit të tillë martesa mbaron së ekzistuari, ndërsa bashkëshorti i gjallë ka të drejtë të lidhë martesë të re³⁷.

³⁶ Podvorica Hamdi, vepër e cituar, fq.92

³⁷ Po aty, fq.93

E drejta historikisht, ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me zgjidjen e martesës. Qëndrimi i parë konsiston thjesht në ndalimin e plotë të zgjidhjes së martesës. Grupi shoqëror (shoqëria), dukembajtur parasysh dobinë dhe funksionin shoqëror të qeizës familjare, mund të ndalojë shpërbërjen e saj. Një gjë e tillë justifikohet nga shoqëria, qoftë për shkak të rendit publik, qoftë për shkak të problemit të mirëqenies së fëmijëve që mund të kenë ardhur në jetë nga martesë që kërkohet të zgjidhet. Një konceptim i tillë përfshin natyrshëm faktin që sistemi juridik privilegjon mendimin shoqëror, si më të lartë në shkallë hierarkike, se sa mendimin individual, i cili lidhet me lirinë dhe kënaqësinë individuale. Në këtë mënyrë, mendimi individual (zgjedhja individuale) sakrifikohet për hir të mendimit kolektiv (zgjedhjes kolektive). Ky qëndrim ka qenë i pranishëm në pjesën më të madhe të të drejtave primitive. Ai vihet re, gjithashtu, edhe në të drejtat e zhvilluara, por që i janë nënshtruar një ndikimi të rëndësishëm fetar. Ndërsa qëndrimi i dytë lejon çdo bashkëshort për ti ³⁸dhënë fund lidhjes së martesës në çdo moment, vetëm me një vendim në bazë të njëanshëm. Mundësia e zgjedhjes së njëanshme të martesës lejojnë zgjedhjen e martesës vetëm në bazë të vullnetit të burrit. Janë të shumtat sistemet ligjore që i kanë dhënë secilit prej bashkëshorteve mundësinë për ti dhënë fund martesës në çdo moment vetëm me anë të një deklarate të thjeshtë ku të shprehin vullnetin e tyre.

1.7 ZGJIDHJA E MARTESËS, NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR MOSMARRËVESHJE DHE ALTERNATIVE TË ZGJIDHJEVE TË TYRE

Shpesh herë flasim për konflikte e mosmarrëveshje dhe jo rallë jemi pjesë e tyre drejtëpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë. Po çfarë është konflikti? Konflikti mund të përkufizohet si një situatë në të cilën elemente që duken të papajtueshme, ushtrojnë forcë në drejtime të kundërta ose divergjente. Këto forca divergjente krijojnë tension por jo domosdoshmëri armiqësi ose luftë. Fjala ‘konflikt’ jo në të gjitha rastet do të thotë betejë. Ashtu sikurse nuk do të thotë ecje mbrapsht. Konflikti mund të jetë i heshtur dhe i pashprehur ose i shfaqur me shumë zhurmë. Konflikti do të thotë që palët janë në opozitë me njëra - tjetrën.

³⁸ Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Drita, M. Fazliu, Shkurorëzimi i martesës ndër vite, Faculty of Law, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.71

Konflikti ekziston, ai është pjesë e jetës. Ai nuk është as i ‘mirë’ as i ‘keq’, ai është rrjedhojë e një konflikti të pazgjedhur ose të menaxhuar dobët, ose keq, lind mosmarrëveshja.³⁹

Çdo konflikt që menaxhohet keq ose dobët ka koston e vet materiale ose dhe morale. Të tilla janë: cënimi i marrëdhënieve, humbja e dinjitetit dhe respektit, reduktimi i efektivitetit, lindja e stresit, harxhimi i kohërave, i parave, lindja e pasigurisë dhe frikës të së njëjtës situatë etj. Reagimet dhe qëndrimet ndaj konfliktit janë më të ndryshme. Edhe rrugët që ndiqen për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve janë nga më të ndryshme. Gjithësesi, ato mund të klasifikohen në zgjidhje në rrugë ligjore dhe joligjore. Në këto të fundit hyn hakë marrja dhe vetëgjyqësia etj. Këto të fundit janë gjithashtu ligjore. Ndër to do të përmendim pajtimin, negociimin, lehtësimin, ndërmjetësimin dhe arbitrimin. Sipas kësaj që cekëm më lartë, në fjalorin dhe realitetin juridik vëmë re që kanë hyrë institute dhe praktika të cilat na duken edhe tradicionale edhe të reja. Nga kjo d.m.th se nuk janë krejt të panjohura, por përmasa aktuale dhe shekncat në të cilën kanë hyrë e po zënë vend i bëjnë të duken të reja. Kur flasim për zgjidhjen alternative të konflikteve u referohemi rasteve të zgjidhjes ligjore të tyre por jashtëgjyqësore ose nëse janë gjyqësore është fjala për standart zgjidhjeje që e bën gjyqtarin një aktor të një roli më të veçantë nga ai i rolit tradicional. Sot parapëlqehen shumë që këto alternativa të zgjidhjeve adekuate të mosmarrëveshjeve dhe integrimi i këtyre alternativave mund të realizohet në gjykatë që do të thotë se mund të uhstrohen edhe prej gjyqtarëve (ajo që quhet *in court mediation*). Pra, ndërmjetësimi si alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve na paraqitet si në formën e tij tradicionale ashtu edhe në formën e tij aktuale dhe moderne. Të dyja këto si mënyra jashtëgjyqësore të zgjidhjes së çështjeve konfliktuale. Ndërmjetësimi shfaqet në formën e një ndërmjetësimi në gjykatë që realizohet prej gjyqtarëve.⁴⁰

³⁹ Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Drita, M. Fazliu, Shkurorëzimi i martesës ndër vite, Faculty of Law, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.79

⁴⁰ Po aty, fq.80

KAPITULLI I DYTË

2. SHKURORËZIMI SI INSTITUT I SË DREJTËS FAMILJARE

Shkurorëzimi është zgjidhja e një martese të vlefshme.⁴¹ Në bazë të kësaj mund të themi se shkurorëzimi dallon dukshëm nga anulimi i martesës, sepse anulimi i një martese është zgjidhja e një martese të pavlefshme kurse shkurorëzimi është zgjidhja e një martese të vlefshme. Shkurorëzimi nënkupton zgjidhjen e një martese të plotëfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve në procedurat gjyqësore për shkaqe të parashikuara me ligj.⁴²

Anulimi i martesës ekziston kur nuk janë plotësuar kushtet e parashikuara me ligj për vlefshmërinë e martesës. Ndërsa kur martesa është e vlefshme ajo mund të zgjidhet me shkurorëzim. Shkurorëzimi është një institut shumë i rëndësishëm i së Drejtës Familjare. Shkurorëzimi përkufizohet si zgjidhje e martesës së vlefshme gjatë jetës së bashkëshortëve për shkaqe të parashikuara me ligj dhe me procedurë gjyqësore. Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm me padi private, të ngritur nga bashkëshorti ose bashkëshortët e përbashkët. Ndërsa procedrua e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim, zhvillohet pranë gjykatës.

Nga përkufizimi i shkurorëzimit mund të nxjerrim disa veçori të shkurorëzimit:

- a) *Ekzistimi i martesës së vlefshme*
- b) *Shkurorëzimi bëhet vetëm sa të jenë gjallë bashkëshortët*
- c) *Shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara me ligj*
- d) *Shkurorëzimi bëhet me procedurë.*⁴³

Shkurorëzimi është një dukuri monografike apo sociofamiljare, është aq i vjetër sa vetë jeta e njeriut, duke qenë bashkudhëtar me martesën. Kur organizimi i shoqërisë njerëzore filloi të kodifikohet nga ana juridike njëherësh filloi të kodifikojë edhe martesa së bashku me shkurorëzimin. Është e natyrshme se kjo dukuri ka mbijetuar dhe mban vulën e kohës së kushtëzuar nga karakteri i rendit ekonomiko-shoqëror. Sikur në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet tjera si në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri, fenomeni i shkurorëzimit është i pranishëm.

⁴¹ Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqipëtarë”, Tiranë, 1999, fq.124

⁴² Ruxhdi Berisha, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004, fq.503

⁴³ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq.158

a) Ekzistimi i martesës së vlefshme⁴⁴

Ekzistimi i martesës së vlefshme është një karakteristikë e shkurorëzimit sepse mund të bëhet vetëm shkurorëzimi i martesës së vlefshme. Nëse martesa është e pavlefshme ajo mund të anulohet dhe nuk ka shkurorëzim. Nëse egzistojnë në të njëjtën kohë edhe shkaqet e anulimit edhe shkaqet e shkurorëzimit atëherë së pari sqarohen shkaqet e anulimit dhe zhvillohet procedura e anulimit të martesës. Kjo është e vetëkuptueshme se askush nuk mund të lidhë martesën në kundërshtim me ligjin. Prandaj edhe shkaqet e anulimit kanë përparësi ligjore në raport me shkaqet e shkurorëzimit.

b) Shkurorëzimi për të gjallë të bashkëshortëve

Shkurorëzimi për të gjallë të bashkëshortëve është veçori tjetër e shkurorëzimit nga se shkurorëzimi mund të bëhet vetëm sa janë gjallë bashkëshortët. Nëse njëri bashkëshort vdes atëherë martesa pushon me vdekje në mënyrë natyrore. Prandaj në rastin e tillë nuk ka nevojë për shkurorëzim. Në qoftë se ka filluar procedura e shkurorëzimit por ndërkohë veç njëri bashkëshort jeton gjatë zhvillimit të kësaj procedure, trashigimtarët mund të vazhdojnë procedurën e shkurorëzimit. Me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve pushon martesa.⁴⁵

Pasi që martesa është një bashkësi midis dy personave, në mes burrit dhe gruas, mund të themi se ajo nuk mund të ekzistojë nëse njëri prej bashkëshortëve nuk jeton më. Nga ky stad, martesa përfundon nëse njëri prej bashkëshortëve shpallet i vdekur, martesa e tyre mbaron pikërisht në ditën e vdekjes së tyre. Me vdekjen e njërit partner, marrëdhëniet juridike pronësore të cilat kanë egzistuar gjatë kohës së martesës së tyre do të ndahen në bazë të Ligjit për Trashigimi.⁴⁶ Pas vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, bashkëshorti i gjallë mund të llogarit në martesë pa marrë parasysh kohën e kaluar nga vdekja e bashkëshortit.

c) Shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara me ligj

Si rregull martesa lidhet me vullnetin e lirë të bashkëshortëve. Mirëpo bashkëshortët edhe pse lidhin martesën me vullnetin e lirë nuk do të thotë se ata mund të kërkojnë shkurorëzim pa ndonjë shkak të justifikueshëm. Ligjvënësi me qëllim të mbrotjes së martesës dhe familjes i ka paraparë kushtet për të cilat mund të kërkohej shkurorëzimi.⁴⁷

⁴⁴Po aty, fq.158

⁴⁵ Po aty, fq.159

⁴⁶ Љиљана Спировиќ –Трпеновска Семејно право НИП „Студентски збор“ –Скопје 2004 година

⁴⁷ Љиљана Спировиќ –Трпеновска верë e cituar, fq.159

Sipas LFK, neni 69, bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzimin kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme. Bashkëshortët e lidhin martesën me qëllim të jetës së përbashkët dhe me qëllim që martesë të vazhdojë deri sa të jenë gjallë bashkëshortët. Më gjithatë duhet të përmendur se kur një gjë e tillë në praktikë nuk ndodh kjo bëhet e padurueshme. Mirëpo ligjvënësi e parasheh mundësinë e shkurorëzimit me marrëveshjen e bashkëshortëve. Një martesë mund të zgjidhet vetëm nëse marrëdhëniet martesore janë të çrregulluara seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, apo për shkaqe tjera të parapara në ligj. Pa ekzistimin e shkaqeve të parashikuara në ligj martesë nuk mund të shkurorëzohet, pavarësisht nga vullneti i bashkëshortëve.

d) Shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me procedurë gjyqësore

Shkurorëzimi realizohet në një procedurë të caktuar juridike të paraparë me dispozitat ligjore. Shkurorëzimi do të jetë i plotfuqishëm vetëm në qoftë se realizohet para organit kompetent gjyqësor. Procedura e shkurorëzimit është procedurë e veçantë që është rregulluar me Ligjin e familjes së RM, ku në mënyrë subsidiare gjithashtu zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, jashtkontestimore dhe të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Kjo është karakteristikë tjetër e shkurorëzimit e cila nënkupton faktin se shkurorëzimi mund të bëhet vetëm para gjykatës dhe me procedurën e parashikuar me ligj. Sipas LFK, neni 68 paragr, martesë mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm me bazë të vendimit të gjykatës. Shkurorëzimi në të gjitha legjislacionet pozitive në botë bëhet me procedurë gjyqësore. Në nenin 1564 të KCGJ, thuhet se martesë mund të zgjidhet me shkurorëzim “divorc“, vetëm me vendimin të gjykatës dhe sipas kërkesave së njërit apo të dy bashkëshortëve.⁴⁸ Ndërsa martesë konsiderohet e zgjidhur, kur vendimi i gjykatës bëhet i plotfuqishëm.

Në kontestet martesore krahas gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, kompetencë territoriale ka edhe gjykata në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët (Ligji për procedurën kontestimore neni 46, në tekstin e më tutjeshëm LPK dhe neni 228 i LF).

Kjo dispozitë, kur është fjala për kontestet martesore është sjellë me qëllim të ekonomizmit të procedurës, që kontesti të zhvillohet atje ku edhe janë paraqitur shkaqet e atij kontesti, ku, sipas rregullës, edhe gjinden faktet që duhet ti paraqesë gjykata. Në rastin konkret, pra, bëhet fjalë për kompetencë territoriale të zgjedhur, pasi që nga paditësi varet se a do ta

⁴⁸Po aty. fq 159

paraqesë padinë në gjykatën me kompetencë të përgjithshme territoriale ose në gjykatën në territorin e të cilit e ka pasur vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin e fundit (LPK neni 39 alineja 1 dhe 2).

2.1 HISTORIKU I SHKURORËZIMIT

Mund të thuhet se zgjidhja e martesës është institucion i lashtë i së drejtës martesore. Ka lindur vetëm pak çaste pas lidhjes së martesës. Dhe, gjatë historisë njerëzore e deri më sot ka qenë aleati më besnik i martesës. E njohën dhe e rregulluan si: e drejta romake, ajo greke, biznatini etj. Ashtu edhe e drejta zakonore shqiptare.⁴⁹

Do theksuar se qëndrimi ndaj zgjidhjes së martesës varej kryesisht nga koncepti shoqëror që kishte klasa sunduese ndaj martesës dhe familjes në periudha kohore. Kjo ka bërë që të dallohen qëndrimet e vendeve të ndryshme ndaj institutit të zgjidhjes së martesës. Në të drejtën klasike greke, ligjet antike njohën dhe rregulluan dy forma të zgjidhjes së martesës: zgjidhjen e martesës me marrëveshje të dy bashkëshortëve dhe zgjidhjen e martesës me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve. Në kohën e Pernadorisë në të drejtën klasike romake që ndërtuar sistemi i zgjidhjes së martesës me marrëveshje dhe i ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënieve martesore.⁵⁰ Shkurorëzimi është një institucion i lashtë dhe i cili ka përcjellë martesën. Kjo nënkupton se nga lidhja e martesës është zhvilluar edhe shkurorëzimi si institucion shoqëror dhe juridik. Sipas Vollterit shkurorëzimi ka lindur disa javë pas martesës.⁵¹

Kështu shkurorëzimi është dukuri shumë e lashtë e cila njihej dhe rregullohej nga e drejta zakonore e popujve të ndryshëm duke përfshirë edhe atë të shqipëtarëve. Në Shqipëri veçanërisht gjatë sundimit Osman, zgjidhja e martesës ishte dukuri mjaft e rallë për shkak të rrethanave dhe kushteve ekonomiko shoqërore në të cilat ndodhej shoqëria shqiptare dhe për shkak të mundësive dhe karakterit patriarkal të marrëdhënieve martesore. Zgjidhja e martesës mund të dërgon në armiqësi ndërmjet familjes së burrit e të gruas dhe në zbatimin e gjakmarrjes ndërmjet tyre si në rastet e parashikuara në kanun, ashtu edhe në ato të paparashikuara.⁵²

Nëse shikojmë në mënyrë historike, zhvillimi i këtij institucioni në legjislacionet e vendeve të ndryshme mund të konkludohet se jo të gjitha shtetet njohën dhe rregulluan me norma ligjore zgjidhjen e martesës.

⁴⁹Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq.116

⁵⁰ Marina Janiç – Komar, Radoje Koraç, Zoran Ponjavić, Porodično Pravo, Beograd, 2009, fq.144

⁵¹ Gani Uruçi, E drejta familjare – ligjerata të autorizuar, Prishtinë, 1994, fq.84

⁵² Po aty, fq.185

Ajo që karakterizon legjislacionet është fakti se bashkëshortët kanë të drejta të barabarta edhe gjatë shkurorëzimit. Qëllimi i kësaj është mënjanimi i të gjitha formave të diskriminimit të gruas i cili ka qenë i vrazhdë në periudha të caktuara të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Në antikë nëse gruaja nuk lindte fëmijë, sidomos djalë, burri e detyronte edhe kundër vullnetit të saj të zgjidhë martesën. Në Shqipëri, shkaqet e shkurorëzimit, kanë qenë të llojllojshme: sociologjike, ekonomike, juridike, psikologjike, historike. Ndërkaq ndër shkaqet kryesore, të ligjshme që i ka njohur e drejta jonë zakonore janë: shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vjedhje, steriliteti e kështu me radhë.⁵³

❖ Sistemet e shkurorëzimit

Në literaturën juridike njihen pesë sisteme të shkurorëzimit si:

- a) *Sistemi juridik që ndalon shkurorëzimin,*
- b) *Sistemi juridik që lejon shkurorëzim martesës,*
- c) *Sistemi i shkurorëzimit të martesës si mjet shërimi,*
- d) *Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës,*
- e) *Sistemi i shkurorëzimi si sanksion.*⁵⁴

Sistemi juridik i ndalimit të shkurorëzimit: Ky është lloj i së drejtës kanonike katolike. Kisha katolike e trajton martesën si shprehje e vullnetit hyjnor dhe nuk ka lejuar zgjidhjen e saj.⁵⁵ Në vend të zgjidhjes së martesës, lejonte institucionin e ndarjes nga shtrati dhe tryeza. Sipas kësaj nëse martesë tronditej thellësisht dhe jetesa e përbashkët bëhej e padurueshme, lejohej ndërpreja faktike e jetesës së përbashkët të bashkëshortëve. Mirëpo, martesë nuk zgjidhej dhe ajo *de jure* vazhdonte të mbetej ende në fuqi. Në vendet si Spanja, Argjentina, Kolumbia, Irlanda të cilat ndodheshin nën ndikimin e së drejtës kanonike katolike, kemi moslejim të shkurorëzimit. Në atë kohë dhe në këto vende ishte zhvilluar institucioni i ndarjes nga shtrati dhe tryeza. Deri vonë shkurorëzimi nuk ishte i mundur. Duke shikuar në aspektin e të drejtave të njeriut ishte një shkelje e së drejtës për të lidhur martesë në bazë të vullnetit të lirë.

⁵³ Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Faculty of Laë, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.196

⁵⁴ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq.118

⁵⁵ Marina Janiç – Komar, Radoje Koraç, Zoran Ponjavić, Porodično Pravo, Beograd, 2009, fq.145

Sistemi që lejon shkurorëzimi: në kuadër të sistemeve juridike që lejojnë shkurorëzimin dallohen disa sisteme të shkurorëzimit:

- a) *Sistemet që me lehtësi e lejojnë shkurorëzimin;*
- b) *Sistemet që e lejojnë shkurorëzimin si sanksion;*
- c) *Sistemet që lejojnë shkurorëzimin për shkak të çregullimit serioz të marrëdhënieve bashkëshortore dhe*
- d) *Sistemi i kombinuar.*

Dallojmë disa sisteme, si p.sh shtetet që kanë liri absolute të shkurorëzimit shtetet që kanë për bazë të drejtën e Sheriatit (shtetet muslimane), sistemi tjetër i cili lidhet me të drejtën franceze, ku shkurorëzimi lejohet si sanksion (si pasojë e fajësisë), etj. Me dispozitat e LMMFK është miratuar sistemi i shkurorëzimit, ku merren për bazë shkaqet e përgjithshme objektive, psh., çrregullimi serioz dhe i vazhdueshëm i marrëdhënieve martesore, por edhe shkaqe të veçanta, psh., zhdukja, sëmundja psikike dhe paafësia për të gjykuar, ndërprerja e jetës faktike, etj. Sistemet që lejojnë shkurorëzimin bazohen në një liri absolute të shkurorëzimit. Si antipod i sistemit të mëparshëm paraqitet sistemi i cili mjaft lehtë e lejon shkurorëzimin, do të thotë mbretëron një liri pothuaj absolute e shkurorëzimit. Sikurse që sistemi juridik i ndalimit të shkurorëzimit ishte karakteristik për shtetet ku zbatohet e drejta kanonike, liria e shkurorëzimit është karakteristike për shtetet në të cilat zbatohet e drejta e sheriatit. Ky sistem nis nga vullneti i bashkëshortëve që paraqitet si faktor i vetëm relevant, si për lidhjen e martesës ashtu edhe për zgjidhjen e saj.⁵⁶

Në grupin e sistemeve që e lejojnë shkurorëzimin bëjnë pjesë shtetet muslimane, në të cilat zbatohet e drejta e sheriatit siç janë p.sh. Siria, Iraku, Irani, Kuvajti etj. Kjo e drejtë radhitet në anën e legjislacioneve të cilat e lejojnë shkurorëzimin, mirëpo patjetër duhet të ketë shkak dhe arsye të fuqishme për një veprim të tillë dhe do të lejohet shkurorëzimi vetëm në qoftë se nuk ekziston asnjë mundësi për ruajtjen e martesës.⁵⁷

Pra, mund të themi se islami ka një qëndrim mesatar në mes ndalimit kategorik dhe liberalizimit të shkurorëzimit, çka do të thotë se edhe pse ky sistem e lejon shkurorëzimin, një liberalizim i plotë nuk ekziston. Edhe në këtë sistem paraqiten disa ndryshime si rezultat i reformave në legjislacionet familjare të shteteve islame ku si e drejtë pozitive është e drejta e

⁵⁶ Ljiljana Spirović Trpenovska, Vepra e cituar, f.128

⁵⁷ Hammudah Abd Al-Ati, *Islam in Focus*, Fourth edition, Cairo, 2003, f.353

shariatit. Që nga mesi i shekullit 20, shumica e shteteve myslimane kanë tentuar që ta bëjnë kodifikimin e dispozitave të së drejtës familjare islame dhe të njëjtat të hynë në zbatim në gjykatat civile ose Sharia (gjykata fetare). Shumica e Qeverive të shteteve islame kanë përcaktuar parakushte të caktuara për shkurorëzim si dhe obligimin për paraqitjen e shkurorëzimit organeve kompetente, me qëllim të evidentimit, për dallim nga e kaluara kur obligimi i këtillë nuk parashihej sipas së drejtës së shariatit.⁵⁸

Pra, mund të themi se islami ka një qëndrim mesatar në mes ndalimit kategorik dhe liberalizimit të shkurorëzimit, çka do të thotë se edhe pse ky sistem e lejon shkurorëzimin, një liberalizim i plotë nuk ekziston. Në mes këtyre dy sistemeve ekstreme për shkurorëzimin e martesës, gjenden shumica e legjislacioneve bashkëkohore, ku mund të thuhet se, dominon botëkuptimi se shkurorëzimi paraqitet si alternativë për të dal nga situata e cila është bërë e padurueshme për bashkëshortët, deri në atë masë sa që shkurorëzimi është “ilaç” i vetëm përmes së cilit bashkëshortët mund të lirohen nga kjo marrëdhënie e çrregulluar. Burimi i parë juridik i shkurorëzimit në Republikën e Maqedonisë është Ligji për Familje i vitit 1992, i cili është akt i përgjithshëm normativ juridik.⁵⁹

Veçmas këtij ligji, instituticoni i shkurorëzimit është i rregulluar edhe i garantuar me Kushtetutën e RM-së dhe aktet juridike ndërkombëtare. Një ndër burimet formale e materiale të së drejtës është padyshim Kushtetuta e një vendi. Ajo paraqet jo vetëm bazën juridike për konstituimin dhe funksionimin e organeve shtetërore, por edhe burim i autorizimeve të tyre, para bazë për funksionimin e sistemit politik të një vendi. Në këtë drejtim, si ligj më i lartë, si ligj themelor i shtetit, Kushtetuta është bazë për realizimin dhe sigurimin e drejtësisë dhe bazë për harmonizimin e akteve të ndryshme juridike në atë shtet.⁶⁰

Kushtetuta e fundit e Republikës së Maqedonisë është miratuar në 17 nëntor të vitit 1991, nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, me të cilën ndërpritet kontinuiteti kushtetues i deri atëhershëm, që paraqiti kthesë në zhvillimin kushtetues të shtetit. Me atë u braktis sistemin komunist dhe parimet mbi të cilat mbështetej ai sistem, parime këto që sollën në krizë të rëndë

⁵⁸ Florian Pohl, *Modern Muslims Societies*, Malaysia, 2011, f.57-58

⁵⁹ Ndryshime dhe plotësime të këtij ligji janë bërë me: Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.09/1996; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.38/2004; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.33/2006, dhe më 22.12.2008 nxjerret teksti i spastruar i Ligjit për familjen Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.67/2010; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.156/2010

⁶⁰ Kurtesh Salju, *E drejta kushtetuese*, Tetovë, 2002, f.45

tërë sistemin shoqëror në të gjitha lëmenjtë (në ekonomi, politikë, marrëdhënie ndërnacionale etj), monizmi politik, monizmi pronësor mungesa e tregjeve të lira dhe iniciativës private,⁶¹ e që në mënyrë dhe shkallë të caktuar ka ndikuar edhe në marrëdhëniet familjare dhe rregullimin e tyre.

Sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion:⁶² deri vonë ka ekzistuar edhe sistemi anglo-frances i zgjidhjes së martesës. Ky sistem tani pothuajse nuk ekziston në asnjë vend. Sipas tij, zgjidhja e martesës konsiderohej dënim për bashkëshortin i cili ishte përgjegjës për shkeljen e detyrimeve martesore. Shkeljet e detyrimeve martesore kanë qenë të përcaktuara me dispozita ligjore, si kyerja e atentatit ndaj jetës së bashkëshortëve.⁶³

Sistemi i shkurorëzimit të martesës si ilaç: disa shtete të Europës Lindore, e kanë njohur sistemin e zgjidhjes së martesës si mjet shërimi. Këto shtete kanë njohur zgjidhjen e martesës atëherë kur janë vështirësuar të gjitha marrëdhëniet e bashkëshortëve. Sipas këtij kriteri zgjidhja e martesës është objektive.

2.2 SHKAQET E PËRGJITHSHME TË SHKURORËZIMIT

Shkurorëzimi mund të bëhet për shkaqe të parapara me ligj. Mirëpo mënyra e përcaktimit të shkaqeve të shkurorëzimit dallon nga legjislacionet e ndryshme dhe kjo varësisht se cilin sistem e kanë përvetësuar. Shkaqet e shkurorëzimit janë fakte dhe rrethana që lindin pas lidhjes së martesës për të cilat kërkohet zgjidhja e saj. Në teorinë juridike shkurorëzimi bëhet sipas kritereve të ndryshme:

- a) *Shkaqet e përgjithshme dhe të veçanta,*
- b) *Shkaqet absolute dhe relative,*
- c) *Shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit dhe*
- d) *Shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit.*

I referohemi shkaqeve të përgjithshme për zgjidhjen e martesës: shkaqet e përgjithshme të zgjidhjes së martesës mund të quhen çrregullime serioze ose të vazhdueshme të marrëdhënieve martesore, të cilat i takojnë shkallës së lartë të realizimit të qëllimeve të martesës ku vazhdimi i mëtutjeshëm i jetës së përbashkët mund të bëhet i pamundur.

⁶¹ Kurtesh Salii, Vepra e situar, f.359

⁶² Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq.119

⁶³ Florian Pohl, *Modern Muslims Societies, Second Edition*, Malaysia, 2011, f.85

Elementi i çrregullimit serioz nuk mund të ndahet nga elementi në vazhdimin e mëtutjeshëm të martesës të jetesës së përbashkët të bashkëshortëve që e bën të pamundur. Përveç faktit se çrregullimi duhet të jetë serioz dhe real ai duhet të jetë gjithësesi edhe i vazhdueshëm.⁶⁴

Për shkak të numrit të madh në jetën e përditshme të shkaqeve të përgjithshme, që mund të përfshijnë fakte dhe rrethana mjaft të ndryshme është e pamundur të numërohen taksativisht.⁶⁵

Ka raste të shumta që shkurorëzimi kërkohet nga ana e bashkëshortëve me anë të padisë. Me padi inicohet procedura për zgjidhje të martesës nga ana e një bashkëshorti. Dy bashkëshortët mund të parashtrojnë kërkesë të përbashkët për zgjidhje të martesës me propozim. Ka raste kur me padi për zgjidhje martese gjatë zhvillimi të procedurës mund të pajtohen palët. Shkaqet absolute dhe relative janë fakte të një rëndësie dhe një peshe ngase kërkojnë arsye në vetvete dhe kanë fuqinë e shkakut shkurorëzues. Që gjykata të vendosë për zgjidhje të martesës për shkaqe objektive, ato duhen të jenë të parapara në ligj. Ato prezumohen se kanë në vetvete një lloj tronditje të thellë të marrëdhënieve bashkëshortore dhe nuk i lihet gjykatës të vlerësojë atë.⁶⁶ Nga ky shkak për të nxjerrë vendimin për zgjidhjen e martesës është e mjaftueshme të vërtetohet fakti i cili ka fuqinë provuese të shkakut absolut.⁶⁷

Shkaqet relative për shkurorëzimin janë të shumta sa që nuk kemi mundësi për ti përmendur të gjitha me rend. Së fundi vlen të themi se ekzistojnë edhe shkaqe të fshehta dhe jo të fshehta të zgjidhjes së martesës. Veprimet e fshehta me qëllim të shkakutimit të ndonjë të keqeje bashkëshortit tjetër quhen shkaqe të fshehta në zgjidhje të martesës.

Të tilla janë: atentati ndaj jetës së bashkëshortit, lënia qëllimkeqeje e bashkëshortit tjetër etj. Shkaqet jo të fshehta të zgjidhjes së martesës nuk janë veprime qëllim keqe dhe të fshehta të drejtura kundër bashkëshortit tjetër veçse janë të natyrës subjektive: mospërpjethësi e karaktereve, sëmundja psikike. Ashtu siç u theksua më lartë se kemi edhe shkakun e zgjidhjes së martesës për të cilën e drejta me padi humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta në padi nuk humbet pas afatit. Për këtë pjesë mund të themi se shkaqet për zgjidhjen e martesës që pas kalimit të afatit të caktuar në ligj humbet e drejta e padisë dhe këta kanë natyrë relative. Në themelin e tyre qëndron fajësia si element subjektiv.

⁶⁴ Nerimana Tranlic, Suzana Bubiç, vep. e cituar, fq.78

⁶⁵ Podvorica Hamdi, vepra e cituar, fq.124

⁶⁶ Po aty, fq.78

⁶⁷ Nerimana Tranlic, Suzana Bubiç, vep. E cituar, fq.79

Shumë cilësi të njeriut sot kanë humbur si vesa e mëngjesit nga dielli. Edhe ata pak njerëz që kanë mbetur me kalimin e kohës i quan si démodé që duken në sirtarin e muzeut dhe të mos dalin më.⁶⁸

⁶⁸Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005, fq.128

KAPITULLI I TRETË

3. SHKURORËZIMI SIPAS LEGJISLACIONIT PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

3.1 LIGJI PËR FAMILJE SI LIGJ THEMELOR PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKO-FAMILJARE

Shkurorëzimi është një fenomen aq i natyrshëm sa është edhe vetë martesë. Dashuria është e përjetshme për aq kohë sa zgjat ajo. Shkurorëzimi përfaqëson një të drejtë të njeriut. Ajo është shprehje e lirisë së një individi për të dashuruar dhe për të zgjedhur. Ligji për Familje në Republikën e Maqedonisë është një ndër kornizat primare të institucionit të shkurorëzimit, ky ligj është një akt i përgjithshëm normativ dhe njëkohësisht juridik.⁶⁹ Me anë të këtij ligji janë rregulluar çështje për martesën dhe familjen, marrëdhëniet e martesës me familjen, kujdestaria, adoptimi etj. Përveç këtij ligji që rregullon marrëdhëniet familjare dhe pikërisht çështjen e shkurorëzimit, Republika e Maqedonisë ka hartuar edhe disa ligje tjera:

- a) *Ligjin për Mbrojtje Sociale (Gazeta Zyrtare e RM nr.21/2006),*
- b) *Ligjin për trashigiminë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 47/1996),*
- c) *Ligji për ndihmë juridike pa pagesë (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.161/2009),*
- d) *Ligji për të huajt (Gazeta zyrtare e RM, nr.35/2006),*
- e) *Ligji për procedurën kontestimore (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.79/2005).⁷⁰*

3.2 RREGULLIMI I SHKURORËZIMIT SIPAS LIGJIT PËR FAMILJE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Mbi të gjitha parakushtet tjera, martesë duhet të bazohet në dashurinë, respektin, barazinë dhe ndihmën reciproke, mirëpo në rast të disekuilibrit dhe mosrespektimit të këtyre parimeve jeta bashkëshortore mund të bëhet e padurueshme për vazhdimin e suksesshëm të saj.

Pra, shkurorëzimi është pasojë e mosmarrëveshjeve dhe grindjeve permanente midis partnerëve. Shkurorëzimi është institucion i lashtë, dukuri përbërëse dhe e pandashme e martesës. Volteri thoshte se shkurorëzimi lind disa javë pas martesës. Do të thotë që, atëherë kur lind martesë, lind edhe shkurorëzimi.⁷¹

⁶⁹ Neni 3, Paragrafi 2, Ligjit për familjen Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008

⁷⁰ Ligji për trashigimi në Republikës së Maqedonisë, Nr. 47/1996

⁷¹ Gani Oruçi, E drejta familjare, Prishtinë, 1994, fq. 89

Në rastet kur jeta e përbashkët tani më nuk është alternativa e vetme për të vazhduar më tej, shumica e bashkëshortëve përgatiten t'i përballen sfidës së jetesës në mënyrë të pavarur dhe të ndarë. E gjitha kjo është pasojë e problemeve të cilat i përkasin martesës së tyre, duke pasur të drejtën e vendimmarrjes së përbashkët se a do t'i japin asaj fund me anë të institucionit të shkurorëzimit. Në rastet e marrëveshjes së përbashkët të bashkëshortëve gjykata e cila zhvillon procedurën e shkurorëzimit e ka shumë më lehtë të sjell vendimin për ndarjen e tyre. Mjet juridik për iniciimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) së përbashkët të bashkëshortëve⁷² është edhe kërkesa e njërit bashkëshort, pra me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort. Në pajtueshmëri me nenin 237 të LF- pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, para dorëzimit të padisë të të paditurit mbahet seancë për pajtim të bashkëshortëve. Po të marrim parasysh Ligjin për Familje në Republikën e Maqedonisë mund të shikojmë se ky ligj rregullon të gjitha situatat që kanë të bëjnë me çështjen e shkurorëzimit. Sipas nenit 39⁷³ të Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë martesa mund të shkurorëzohet me marrëveshje të ndërsjelltë midis bashkëshortëve.

Sipas këtij neni kuptojmë se bashkëshortët mund të kërkojnë zgjidhje të martesës edhe me marrëveshje nëse ata janë marrë vesh me njëri tjetrin për zgjidhjen e saj. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzimin e martesës në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë të bashkëshortëve nëse vërtetohet se atë në pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pathyeshme. Propozimin e përbashkët për zgjidhje të martesës ata mund të parashtrojnë pranë gjykatës kompetente. Nga kjo rrezulton se zgjidhja e martesës me marrëveshje ekziston kur dy bashkëshortët këtë e dëshmojnë dhe e kërkojnë atë. Fakti se propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje të ndërsjelltë sipas këtij neni, që është paraqitur para gjykatës kompetente tregon më së miri për ekzistimin e kërkesës së përbashkët për zgjidhjen me marrëveshje të martesës, gjë që do të ketë pastaj rol vendimtar gjatë zbatimit të procedurës

⁷² Martesa mund të shkurorëzohet me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, apo fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të dorëzojnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim pas pëlqimit reciprok të bashkëshortëve nëse vërtetohet se pëlqimi i tyre është i lirë, serioz dhe i vendosur (neni 39 i LF).

⁷³ Ndryshime dhe plotësime të këtij ligji janë bërë me: Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.09/1996; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.38/2004; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.33/2006, dhe më 22.12.2008 nxjerret teksti i spastruar i Ligjit për familjen Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.67/2010; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.156/2010

gjygjësore. Është e vërtetë se ky propozim ndonjëherë nuk e pasqyron edhe dëshirën e vërtetë të dy bashkëshortëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje për shkak të fakteve e rrethanave të reja të cilat mund të krijohen rreth saj. Ashtu sikur martesë është një moment shumë i rëndësishëm në jetën e bashkëshortëve edhe zgjidhja e saj është e po të njëjtës kategori. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, tentimi për pajtim të bashkëshortëve realizohet nga qendra për punë sociale. Në rastë nga al.3 të këtij neni gjykata në afat prej 8 (tetë) ditësh njofton me shkrim qendrën për punë sociale lidhur me të dhënat se kur është iniciuar procedura e shkurorëzimit, arsye kryesore pse kërkohet shkurorëzimi dhe të dhënat për fëmijët. Qendra për punë sociale është e obliguar që në afat prej 3 (tre) muajve nga pranimi i njoftimit me shkrim ta përfundojë Seancën për pajtim të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, procedurën për pajtimin e bashkëshortëve e zhvillon gjykata, por vetëm nëse nuk vlerësohet se është më mirë që procedura për pajtim të zhvillohet nga qendra për punë sociale.⁷⁴

Sipas nenit 39⁷⁵, nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, osë fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore është e nevojshme që të parashtrinë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të së drejtave prindërore dhe për mbajtjen dhe edukimin e fëmijës. Në theks të veçantë sipas këtij paragrafi mund të konkludojmë se zgjidhje e martesës me marrëveshje me fëmijë të mitur të përbashkët, është ajo zgjidhje martesë ku gjykata vendos për vazhdueshmërinë e kësaj procedure. Në propozimin e përbashkët një çift i përbashkët duhet të theksojë të gjitha faktet për të cilat kërkohet zgjidhja e martesës kurse gjykata ka detyrë të vërtetojë çrregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore dhe jetesën e padurueshme martesore.⁷⁶

Kësodore, e rëndësishme është të realizohet dallimi midis zgjidhjes së martesës me marrëveshje dhe propozimi për zgjidhje të martesës. Duhet përmendur se zgjidhja e martesës kur

⁷⁴ Arta Selmani, Ndihma Juridike pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Takimi IV, Instituti Alb-Shkenca, 2009, fq.4

⁷⁵ Ndryshime dhe plotësime të këtij ligji janë bërë me: Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.09/1996; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.38/2004; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.33/2006, dhe më 22.12.2008 nxjerret teksti i spastruar i Ligjit për familjen Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.67/2010; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.156/2010

⁷⁶ Nerimana Tranlic, Suzana Bubiç, vep. E cituar, fq.78

bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashktë është një çështje krejtësisht tjetër. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim e martesës në bazë të marrëveshjes së ndërsjelltë të bashkëshortëve nëse vërtetohet se atë në pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pathyeshme.

Sipas nenit 40⁷⁷ të Ligjit për Familje në Republikën e Maqedonisë, martesa mund të shkurorëzohet me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve në qoftë se marrëdhëniet bashkëshortore janë të çrregulluara deri në atë masë sa jeta e përbashktë është bërë e padurueshme. Sa i përket mosfunksionimit të martesës faktikisht, merren parasysh ato veprime të cilët vështirësojnë komunikimin dhe përmbushjen e detyrimeve familjare në mënyrë të përbashktë. Ndarja në aspektin hapësinor të bashkëshortëve me qëllim të nevojës për shkollim të mëtutjeshëm, specializim në profesionin e ndonjërit nga ta, por për të cilën ata me marrëveshje janë përcaktuar, nuk mund të llogaritet si pushim faktik i marrëdhënieve bashkëshortore. Në këto situata bashkësia martesore nuk pushon së funksionuari, ndërkaq bashkëshortët vazhdojnë të plotësojnë të drejtat dhe obligimet e tyre të cilat dalin nga martesa.⁷⁸ Përkundër kësaj, në rastet kur bashkëshortët nuk e ndryshojnë lokacionin e banimit të tyre, pra jetojnë në të njëjtën banesë, nën të njëjtin “pullaz”, ndërkaq nuk komunikojnë dhe nuk i përmbushin të drejtat dhe detyrimet të cilat janë pjesë e institucionit të martesës - në këtë rast bëhet fjalë për të ashtuquajtura “martesa të vdekura” tek të cilat situata ka ardhur deri te ndërprerja faktike e bashkësisë martesore.⁷⁹

3.3 SHKURORËZIMI ME PADI

Shkurorëzimi me padi gjithëherë ekziston kur njëri prej bashkëshortëve ka paraqitur padinë kundër dëshirës së bashkëshortit tjetër. Padia paraqitet në rastet kur nuk ekziston pajtimi i bashkëshortëve për shkurorëzim.⁸⁰

Shkaqet e paraqitjes së padisë mund të jenë shkaqet e përgjithshme të cilat kanë sjellë çrregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore ose shkaqet e veçanta të numëruara në mënyrë taksative nga ligji. Padia për shkurorëzim i paraqitet gjykatës kompetente. Kështu me padi, njëri prej bashkëshortëve mund të kërkojë shkurorëzimin ngaqë ai konsideron se

⁷⁷ ⁷⁷ Ndryshime dhe plotësime të këtij ligji janë bërë me: Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.09/1996; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.38/2004; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.33/2006, dhe më 22.12.2008 nxjerret teksti i spastruar i Ligjit për familjen Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.67/2010; Ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për familjen, Gazeta Zyrtare e RM-së nr.156/2010

⁷⁸ Liljana Spiroviq, Semejno Pravo, Shkup, 2004, fq. 133-134.

⁷⁹ Po aty, fq. 133-134.

⁸⁰ Ruzhdi Berisha, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004, fq.503

shkurorëzimi i martesës është mënyra më e mire për tu liruar nga stresi, për shkak të tronditjes së marrëdhënieve bashkëshortore. Sikur të shkurorëzimi me marrëveshje ashtu edhe të shkurorëzimi me padi, shkurorëzimi bëhet vetëm me vendim të gjykatës. Gjykata do të marrë vendimin në lidhje me shkurorëzimin në bazë të procedurës së përcaktuar me ligj.

3.4 SHKURORËZIMI ME MARRËVESHJE

Procedura e shkurorëzimit inicohet me padi ose me marrëveshje të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje.⁸¹ Ligjvënësi e ka paraparë mundësinë që shkurorëzimi me marrëveshje çdo herë bëhet para gjykatës kompetente. Kështu shkurorëzimi bëhet me vendim të gjykatës në bazë të marrëveshjes së bashkëshortëve. Bashkëshortët mund t'i paraqesin gjykatës propozimin e tyre të përbashkët për shkurorëzim. Shkurorëzimi edhe se me marrëveshje të bashkëshortëve secilën herë bëhet me procedure gjyqësore të paraparë me ligj.

Megjithatë marrëveshja për shkurorëzim ka disa efekte në procedurën e shkurorëzimit të cilat dallojnë nga shkurorëzimi me padi sepse gjykata në këtë rast të marrëveshjes nuk ndalon në shqyrtimin e shkaqeve të shkurorëzimit nga se si shkak është marrëveshja. Bashkëshortët të cilët vendosin që bashkërisht të kërkojnë shkurorëzimin e martesës së tyre, atë e bëjnë me propozimin (kërkesën)⁸² për shkurorëzim me marrëveshje reciproke, që është paraparë në Ligjin për familje të RM (neni 39 dhe 229, alineja 2 i LF).

Kur martesa shkurorëzohet në këtë mënyrë, gjykata nuk hyn në shqyrtimin e shkaqeve të shkurorëzimit, sepse bazë e mjaftueshme për këtë formë të shkurorëzimit është vullneti i përbashkët i bashkëshortëve, dhe vetë propozimi për shkurorëzim është dëshmi e mjaftueshme i cili tregon se marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar dhe se jeta e përbashkët është bërë e padurueshme, prandaj bashkëshortët nuk dëshirojnë që të qëndrojnë edhe më tej në një martesë të tillë. Kërkesa për shkurorëzim me marrëveshje, parashtrohet në formë të propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, edhe pse Ligji në një vend (neni 229 alineja 2) e përdor termin padi. Mirëpo pasi që në tekstin e mëtutjeshëm të Ligjit shfrytëzohet termi – propozim, ndoshta bëhet fjalë për gabim teknik në vetë Ligjin⁸³, dhe në këtë rast më e përshtatshme është që kërkesa për shkurorëzim sipas këtij shkakut të parashtrohet në formë të propozimit për shkurorëzim.

⁸¹ Po aty, fq.503

⁸² Kërkesa për zgjidhjen e martesës është parashtrimi që të dy bashkëshortët i bëjnë gjykatës, ku shprehin vullnetin e tyre për të nisur procesin gjyqësor të zgjidhjes së martesës me pëlqimin e ndërsjell të tyre – Arta Mandro Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta familjare*. Tiranë, 2006, f.388.

⁸³ Kiril Çavdar, *Vepra e cituar*, 1998, f.380.

Kjo më së tepërmi për shkak se tek të dy bashkëshortët është e nevojshme të ekzistojë vullneti i ndërsjellë për shkurorëzim i cili mund të formulohet si propozim i tyre i përbashkët. Padia si mjet i rregullt juridik i mundëson subjektit të së drejtës, që të drejtën e garantuar me ligj, ta mbroj përmes rrugës gjyqësore dhe atë duke iniciuar procedurën për mbrojtjen gjyqësore të së drejtës së tij të cënuar. Pra, padia, respektivisht dorëzimi i padisë në gjykatë, paraqet hapin e parë për fillimin e procedurës civile dhe njëherit shpreh interesin juridik të subjektit për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të së drejtës së cënuar nga gjykata.

Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim (padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi).⁸⁴ Zgjidhja e martesës, në dallim nga shpallja e pavlefshmërisë së saj mund të kërkohej vetëm nga bashkëshortët. Në varësi të formës së zgjidhjes së martesës si kërkuar mund të paraqiten:

- a) *Të dy bashkëshortët (zgjidhja e martesës me pëlqimin e ndërsjellë të bashkëshortëve) ose*
- b) *Vetëm të njërit prej tyre.*

E drejta e padisë për zgjidhjen e martesës nuk u kalon trashëgimtarëve. Në rast se gjykimi ka filluar më parë, gjykata ndërpret procesin dhe pushon gjykimin. Njëri nga bashkëshortët mund të kërkojë divorcin, në rast se bashkëshortët, para fuqizimit të padisë ose kalimi në ndarje me padi, së paku dy vite kanë jetuar ndarazi. Pas skadimit të afatit dy vjeçar bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzimin, nëse bashkëjetesa bashkëshortore për arsye serioze, nuk mund të vazhdojë më.

3.4.1 PADIA ME PROPOZIM PËR SHKURORËZIMIN ME MARRËVESHJE

Procedura e veçantë kontestimore për shkurorëzimin e martesës inicohet me padi, e cila ka karakter konstitutiv. Nëse bashkëshortët kërkojnë që martesa të shkurorëzohet me pajtim reciprok, procedura kontestimore inicohet me padi, me propozim me marrëveshje për shkurorëzimin e martesës (neni 229, LF). LF, në realitet nuk është konsistent gjatë shfytëzimit të termeve në shënimin e akteve me të cilat inicohet procedura për shkurorëzimin e martesës, e më pas e shfytëzon termin propozim për shkurorëzimin me marrëveshje të martesës.⁸⁵

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë madhor mbi të cilët u është vazhduar e drejta prindërore, përveç marrëveshjes për shkurorëzim është e nevojshme që të parashtrijë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për mbajtjen dhe

⁸⁴ Brestovci, Faik, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, Botimi 2006, fq. 161

⁸⁵ Dr. Arsen Janevski, Dr. Tatjana Zorovska – Komilovska, E drejta e Procedurës Civile, Libri i parë E drejta Kontestimore, Shkup, 2009, fq. 447

edukimin e fëmijëve. Marrëveshja për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore dhe për mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve parashtrohet me shkrim ose me gojë në procesverbal para Gjykatës kompetente të shkallës së parë. Nëse së bashku me padinë me propozim me marrëveshje për shkurorëzimin e martesës nuk është dorëzuar marrëveshja e këtillë, gjykata do të veprojë në pajtim me dispozitat e LPK që kanë të bëjnë me parashtrësat e parregullta (neni 253, LF). Padi për shkurorëzimin e martesës mund të parashtrojë vetëm bashkëshortët. E drejta për padi për shkurorëzimin e martesës nuk parashkruhet dhe as që është kufizuar në kushte dhe afate.

Me paraqitjen e kërkesës për vërtetimin se padia për shkurorëzimin ka qenë e bazuar, procedura kontestimore nga procedura konstitutive transformohet në procedurë deklarore.⁸⁶

⁸⁶Po aty, fq.447

KAPITULLI I KATËRT

4. PROCEDURA E SHKURORËZIMIT

Shkurorëzimi është përfundimi ligjor i martesës.⁸⁷ Shkurorëzimi mund të bëhet vetëm me procedure gjyqësore, pa marrë parasysh se a ekziston marrëveshja për shkurorëzim apo është paraqitur padia. Në radhë të parë është karakteristike se vetëm me vendim nga ana e gjykatës mund të zgjidhet martesa me shkurorëzim. Kusht i domosdoshëm për fillimin e procedurës, përkatësisht gjykimi të një çështje të tillë është që gjykatës kompetente t'i paraqitet padia. Duhet që patjetër të përmendim se procedura për shkurorëzim ka disa specifika, të cilat janë një rrjedhojë e natyrës dhe kompleksitetit të marrëdhënieve familjare. Çështjet familjare janë mjaft të ndjeshme, posaçërisht në procedurën e shkurorëzimit, sepse preken të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Prandaj ligjvënësi i ka paraparë disa specifika sidomos në parimet e procedurës, kompetencën e gjykatës, mbrojtjen e veçantë për personat për përkujdesje etj. Në mungesë të dispozitave të veçanta për procedurën e shkurorëzimit, zbatohen dispozita të Ligjit për Familje.

Objekti i procedurës për shkurorëzimin e martesës – Sipas LF, martesa pushon me vdekjen e njërit nga bashkëshortit të zhdukur, për të vdekur, me anulimin dhe me shkurorëzimin e martesës. Shkurorëzimi i martesës paraqet mënyrën juridike të pushimit të martesës së plotëfuqishme ndërmjet bashkëshortëve. Martesa pushon me shkurorëzim atëherë kur aktgjykimi për shkurorëzim bëhet i plotëfuqishëm. Martesa mund të shkurorëzohet me pajtimin reciprok të bashkëshortëve ose me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve, nëse marrëdhëniet martesore janë prishur deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme. Përveç kësaj secili prej bashkëshortëve mund të kërkojë shkurorëzimin e martesës nëse bashkësia martesore faktikisht ka pushuar më tepër se një vit. Nga të gjitha rastet zhvillohet procedurë e veçantë kontestimore e rregulluar me LF.⁸⁸

Kërkesa për shkurorëzim, duhet t'i përmbaje në vete këto elemente:

- *Çertifikatën nga libri amzë i të martuarve,*
- *Çertifikatën nga libri amzë i të lindurve (nëse ka fëmijë në martesë) dhe*
- *Marrëveshjen për mënyrën e kryerjes së të drejtave dhe detyrave prindërore si dhe për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve.*

⁸⁷ Ruzhdi Berisha, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004, fq.503

⁸⁸ Dr.Arsen Janevski, Dr Tatjana Zorovska – Komilovska, E drejta e Procedurës Civile, Libri i pare E drejta Kontestimore, Shkup, 2009, fq.447

Shkurorëzimi në bazë të propozimit për shkurorëzim me marrëveshje sipas rregullës, kundërshtohet nga fakti se më shumë i përkrah interesat e individëve të caktuar se sa që mban llogari për rëndësinë shoqërore të martesës si institucion. Pakufizimi (ose kufizimi tejet i vogël) i të drejtës së shkurorëzimit me marrëveshje kontribuon në lidhjen dhe në anën tjetër shkurorëzimin e lehtë dhe të pamenduar mirë të martesës⁸⁹ ndërsa papërgjegjshmëria ndaj martesës ndikon ndaj stabilitetit të bashkësisë familjare⁹⁰ dhe me këtë ndaj stabilitetit të shoqërisë në përgjithësi, pasi që familja është qeliza kryesore e shoqërisë.

a) Parimi i barabartësisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Marrëdhëniet martesore janë rregulluar mbi parimin e barabartësisë së bashkëshortëve si me rastin e lidhjes së martesës ashtu edhe gjatë ekzistimit dhe zgjidhjes së martesës. Sipas nenit 14, parag 2 të LFK, bashkëshortët janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimisht të martesës dhe zgjidhjes së saj. Andaj, ligjvënësi e ka garantuar barabartësinë e bashkëshortëve edhe në procedurën e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim.⁹¹ Kjo nënkupton faktin se gjatë procedurës së shkurorëzimit asnjëri nga bashkëshortët mund të mos jetë i privilegjuar por që të dy të trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykata gjatë gjithë procedurës së shkurorëzimit.

b) Parimi i mbrojtjes së veçantë

Parimi i mbrojtjes së veçantë në procedurën e shkurorëzimit është parim mbi të cilin gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit si dhe në kontekstet tjera martesore duhet të kujdeset për personat të cilët nuk janë në gjendje ti mbrojnë të drejtat e tyre. Në mënyrë të posaçme gjykata duhet të mbrojë interesat e fëmijëve për persona me të meta psikike dhe bashkëshortin e pasiguruar. Sipas këtij parimi mund të kuptojmë se gjatë fazave të zhvillimi të procedurës së shkurorëzimit, gjykata duhet të ketë parasysh mbrojtjen e interesave të fëmijës së mitur, personave të sëmurë me zhvillim të metë psikik.

⁸⁹ Kundërshtimi sa i përket shkurorëzimit të lehtë dhe të pamenduar mirë e humbë rëndësinë fillestare nëse meret parasyshë ramja e shkallës së martesave të lidhura dhe ritja e bashkësive jashtmartesore në të gjitha shtetet evropiane, posaçarisht në 20 vitet e fundit të shekullit 20.

⁹⁰ Mira Alinčić, Ana Bakarić Abramović, Dubravka Hrabar, Dijana Jakovac Lozić, Alexandra Korać, *Obiteljsko pravo*, Zagreb, 2001, str.111-112.

⁹¹ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq.166

c) Parimi i përjashtimit të publikut

Ky parim sanksionohet me dispozitat e nenit të 75 të LFK-së. Qëllimi i këtij është deklarimi i lirë i bashkëshortëve përpara gjykatës për të gjitha faktet nga sfera intime e martesës. Duke qenë e pamundshme që publiku të informohet për marrëdhëniet e tyre intime, palët do të tregojnë shkaqet e vërteta të jetës, ku gjykata do të ketë më lehtë për të vërtetuar gjendjen materiale dhe për të nxjerrë një aktgjykim të drejtë.

d) Parimi i dispozicitetit

Parimi i dispozicitetit u garanton palëve iniciativën e lidhur me grumbullimin e materialit procedural, në bazë të të cilit gjykata nxjerr vendimin meritator lidhur me kërkesëpadinë. Në kontekstin martesor, megjithëatë gjykata ka rol aktiv dhe mund të hetojë faktet mbi të cilat palët mbështesin kërkesat e tyre edhe kur palët nuk i kontestojnë ato.⁹²

e) Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit

Për dallim nga rregullat e procedurës civile, palët në kontestet martesore nuk mund të kenë në dispozicion objektin e kontestit.

4.1 FILLIMI I PROCEDURËS PËR SHKURORËZIM

Vlen që të përmendim se shkurorëzimi pikë së pari fillon me padi, ose me propozim të përbashkët të bashkëshortëve. Parimisht padinë mund ta paraqesin vetëm bashkëshortët. Kjo do të thotë se padia është e lidhur shumë ngushtë me personalitetin e bashkëshortit. Padinë mund ta paraqesë secili bashkëshort pavarësisht se cili prej tyre është fajtor për tronditjen e marrëdhënieve bashkëshortore.⁹³

Fenomeni i divorcit është bërë një ndër temat më të studiuar kohërave të fundit e në veçanti në sferën juridike. Fillimi i procedurës së divorcit do të thotë zgjedhja e lidhjeve të martesës mes dy personave. Nga aspekti juridik është një e drejtë e burrit dhe gruas mirëpo në vetvete shkurorëzimi paraqet një problem social i cili ka edhe shumë pasoja. Edhe në Ligjin për Familje të Republikës së Maqedonisë, edhe në Ligjin për Familje në Republikën e Kosovës është parashtruar paragrafi i njëjtë i cili tregon se njëri apo tjetri bashkëshort mund të paraqesë padi për shkurorëzimin.

⁹² Marina Janjic- Komar, Radoje Korac, Zoran Ponjavic, Vepra e cituar, fa.163

⁹³ Valentina Zace, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqipëtar, Tiranë, 1999, fq.141

E drejta e paraqitjes së padisë mund të kalohet në trashigimtarë mirëpo trashigimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë. Legjislacioni ynë nuk ka paraparë ndonjë afat të pritjes për të paraqitur padinë e shkurorëzimit. Në procedurën e shkurorëzimit mund të paraqitet padi kundër bashkëshortit dhe kjo vlen deri në seancën kryesore. Në rastin kur bashkëshortët kanë paraqitur në gjykatë padinë e përbashkët për shkurorëzim, atëherë ata njëkohësisht duhet që të paraqesin edhe marrëveshjen për kujdestarinë e fëmijëve. Në rastet kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën, edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre respektive, me kushtin e vetëm që në marrëveshje të jetë cituar, fakti i zgjidhjes së martesës, e drejta e mbiemrit pas martese, lënia e fëmijëve të mitur për rritje dhe edukim njërit nga bashkëshortet përkatës, e drejta e takimit dhe pensioni ushqimor. Përmes kësaj marrëveshje bashkëshortët bien dakord mes tyre për të gjitha pasojat që mund të vijnë nga zgjidhja e martesës. Akti procedural që paraqitet në Gjykatë është kërkesë dhe jo kërkesë padi, ku në rastin konkret mund të procedohet kur mungon vullneti i bashkëshortëve dhe pëlqimi reciprok i tyre për të zgjidhur martesën. Sipas Kodit të Familjes në aspektin juridik parashikohen mënyrat e mbarimit të martesës të cilat janë: me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës së tyre me marrëveshje ose me pëlqimin vetëm të njërit prej tyre duke paraqitur padi në Gjykatën përkatëse ku ka vendbanimin paditësi (ku pastaj mirret statusi i divorcuar).⁹⁴

Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Marrëveshja përmban lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të tyre të mitur, të ardhurat e nevojshme për rritjen dhe edukimin e tyre, kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar, nëse është rasti dhe nëse është e mundur edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore. Në rast se gjykata konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve, pezullon gjykimin për 3 muaj dhe u kërkon bashkëshortëve të bëjnë rregullimet e duhura në marrëveshje. Në rastet në të cilat bashkëshortët nuk bien dakord për zgjidhjen e martesës atëherë secili prej tyre mund të paraqesë, kërkesë-padi, me anë të së cilës kërkon, zgjidhjen e martesës mes palëve ndërgjyqëse (që janë bashkëshortët), kthimin e mbiemrit të vajzërisë, ose të mbiemrit që kanë pasur para

⁹⁴ Po aty, fq.145

martese (nëse kjo gjë kërkohet pasi ka raste kur njëri nga bashkëshortët vërteton faktin se përmes këtij mbiemri e njohin të gjithë, atëherë mund ti kërkojë gjykatës të mos ndryshojë mbiemrin dhe të mbajë mbiemrin e martesës), lënien e kujdestarisë për rritje dhe edukim, të drejtën e takimeve dhe caktimi i pensionit ushqimor. Të gjitha këto elemente duhen cituar në kërkesë padi, pasi është thelbi i gjykimit dhe i zgjidhjes së pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës. Procedura e gjykimit pastaj, kalon në 2 faza, faza e pajtimit, ku bashkëshortët dëgjohen veçmas ose bashkërisht pa praninë e përfaqësuesve të tyre dhe secili jep versionin e tij të tronditjes së marrëdhënieve familjare gjer në atë pikë sa është i pamundur vazhdimi i bashkjetesës së bashku. Si shkaqe që citohen në Gjykatë, mund të jenë të ndryshme, si: dhuna psikologjike, fizike, veset e njërit bashkëshort, kumari, droga, abuzimet, pija, amoraliteti, tradhëtia bashkëshortore, mungesa e përkujdesjes, braktisja de facto dhe de jure nga njëri bashkëshort, mungesa e dashurisë dhe mirëkuptimit, mungesë komunikimi, keqtrajtimi emocional, mungesa e përkrahjes, izolimi i njërit bashkëshort etj. Këto janë disa nga rastet më të shpeshta që njeh praktika dhe që janë të diskutueshme në praktikën gjyqësore, megjithatë nuk përjashtohet e drejta e çdo shkakut të mundshëm që ka tronditur marrëdhënien bashkëshortore gjer në atë pikë sa është bërë e pamundur vazhdimi i bashkjetesës mes tyre, duke kërkuar apo duke mos kërkuar fajësinë. Pra mjafton çdo shkak dhe jo domosdoshmërisht shkaqet e cituara më lart, për t'iu drejtuar Gjykatës për zgjidhje martese.⁹⁵

Përfundimisht në nenin 132 të Kodit të Familjes, citohet se: “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimit, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rënde të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët”.

Gjykata vendos për fajësinë, në zgjidhjen e martesës, vetëm kur kjo kërkohet prej njërit ose të dy bashkëshortëve. Njëkohësisht Kodi i Familjes parashikon dhe rastet ku secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.

⁹⁵ Revistë Shkencore Juridike e kandidatëve të programit fillestar për arsim ligjor, Justicia, Viti II/2012, Numri 1/2010, Prishtinë, fq.192

Nëse është rasti, ku bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës sipas së cilës duhet të përcaktojë në kërkesë padinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër.

4.2 FAZAT E ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS SË SHKURORËZIMIT

A) PROCEDURA E PAJTIMIT TË BASHKËSHORTËVE

Procedura e pajtimit të bashkëshortëve është një procedurë në të cilën bashkëshortët të cilët kanë paraqitur padi, të anulojnë padinë për shkakun e pajtimit të tyre. Nga momenti i pranimit të padisë gjykata ka për detyrë të fillojë procedurën e pajtimit të bashkëshortëve. Për pajtimin e bashkëshortëve, gjykata do të realizojë seancë të posaçme. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë çështja e pajtimit të bashkëshortëve do të realizohet nga qendra e kujdestarisë, mirëpo nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë atëherë realizohet para gjykatës. Periudha e pajtimit të bashkëshortëve nga të dy subjektet do tu mundësojë që çiftet të mendojnë dhe tu sqarojnë anën e mirë të martesës dhe pasojat e zgjidhjes së saj. Këta dy subjekte luajnë rolin mbrojtës të institutit martesë. Gjykata krijon seance të ndryshme për pajtimin e bashkëshortëve edhe e dërgon atë deri në fund kur e sheh se është e arsyeshme për të vazhduar. Më lartë u përmend organi i Kujdestarisë, ky lloj organi realizon pajtimin e bashkëshortëve brenda afatit të përcaktuar me ligj. Ligjvënësi ka përcaktuar një afat të caktuar dhe nuk lejon që procesi të zvaritet për arsye të kota. Organi i Kujdestarisë dhe trajnimi me të mund të realizohet në periudhë prej tre muajsh. Në rast se arrihet pajtimi i bashkëshortëve atëherë sillet vendim dhe nënshkruhet nga ana e dy bashkëshortëve, dhe nga gjyqtari si pjesë e këtij procesi. Veçanti e procedurës së shkurorëzimit është ajo se në të, para se të fillohet me përcaktimin e shkaqeve të cilat e bëjnë të bazuar kërkesën për shkurorëzim, pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje reciproke, para dorëzimit të padisë të të paditurit, zbatohet procedurë e veçantë, seanca për pajtimin e bashkëshortëve.⁹⁶

B) CAKTIMI I MASAVE TË PËRKOSSHME

Gjykata, në kontestetet martesore mund të caktojë me vendim masën e përkoshme për detyrimin e ushqimit, edukimit me vendim masën e përkoshme për detyrimin e ushqimit, edukimin dhe arsimimin të fëmijëve të mitur.⁹⁷ Për caktimin e masës së përkoshme, gjykata mund të marrë edhe për detyrimin e ushqimit të bashkëshortit, për sigurimin e banimit si dhe për

⁹⁶ Revistë Shkencorë Juridike e kandidatëve të programit fillestar për arsimim ligjor, Justicia, Viti III/2010, Numri 1/2010, Prishtinë, fq.75

⁹⁷ Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqipëtarë, Tiranë, 1999, fq.145

administrimin dhe përdorimin e pasurisë së përbashkët gjatë martesës. Duhet theksuar se vendimin për marrjen e aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme e mer gjykata sipas detyrës zyrtare, kur çmon se janë plotësuar kushtet ligjore. Edhe pse kjo pjesë nuk është shumë e qartë se kur gjykata e mer këtë masë, lë për të kuptuar se kjo masë mund të meret edhe në fazën e pajtimit të bashkëshortëve, por edhe atëherë kur nuk është arritur pajtim. Nëse nuk arrihet pajtimi i shkurorëzimit, atëherë gjykata mund të vendos masë të përkohshme për moslejimin e shkurorëzimit për një kohë të caktuar. Me dispozitat ligjore të Ligjit për Familje nuk është e përcaktuar hollësisht procedura për marrjen e këtij aktvendimi.

C) SEANCA KRYESORE

Seanca kryesore ose procedura e provave është faza qendrore e procedurës së shkurorëzimit. Bashkëshortët gjatë seancës së shkurorëzimit paraqesin llojet e provave të cilat mund të kontenstohen nga bashkëshorti tjetër. Specifika e kësaj procedure është edhe përjashtimi publikut në ato raste kur diskutohet për çështjet intime të bashkëshortëve dhe personat e tjerë. Mirëpo gjykata mund të marrë vendim për përjashtim e publikut secilën herë kur këtë e konsideron të arsyeshme. Në procedurë gjykata zhvillon hetime *ex officio* me qëllim të shqyrtimit të të gjithave provave. Kryerja e zgjidhjeve martesore përmes procesit gjyqësor kalon në disa faza dhe sigurisht që kërkon një afat më të gjatë kohor. Kur procedura e shkurorëzimit është iniciuar me propozim për shkurorëzim me marrëveshje, dhe në seancën kryesore mungon njëri ose të dy bashkëshortët, dhe nuk e arsyetojnë mungesën e tyre, edhe për kundër faktit se janë ftuar në mënyrë të rregullt, do të llogaritet se propozimi është tërhequr apo revokuar (neni 255 i LF).

Çështjet civile që paraqiten në gjykatë, shqyrtohen dhe kalojnë përmes disa seancave. Pjesë e proceseve të zgjidhjeve martesore fillimisht janë seancat e ndërmjetësimit, ku punonjës social bëjnë këshillimin dhe ndërmjetësimin mes bashkëshortëve për të rregulluar marrëdhëniet e tyre. Nëse këto seanca dështojnë, vazhdon procesi gjyqësor që nuk përfshin vetëm zgjidhjen martesore mes bashkëshortëve, por edhe përgjegjësitë prindërore nëse çifti ka fëmijë dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët që kanë realizuar gjatë martesës. Nëse nuk ka tërheqje të padisë gjykata do të caktojë seancë për paraqitjen e provave derisa e konsideron se nuk ka nevojë për seanca të tjera e konsideron të mbyllur seancën kryesore dhe tërhiqet për të marrë vendim.⁹⁸

⁹⁸ Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqipëtarë, Tiranë, 1999, fq.145

D) MARRJA E VENDIMIT

Marrja e vendimit është faza e fundit në procedurën e shkurorëzimit. Gjykata vendos me aktgjykim, pavarësisht se procedura është filluar me padi apo me një propozim të përbashkët. Gjykata me aktgjykim mund të refuzojë padinë dhe propozimin për shkurorëzim ose të lejojë shkurorëzimin në procedurën e shkurorëzimit ku nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesës ose në bazë të pranimit. Aktgjykimi përmban hyrjen, dispozitetin, arsyetimin dhe udhëzimin për mjete juridike. Në hyrje të aktgjykimit, shënohet përbërja e gjykatës, emri i palëve, objekti i kontekstit dhe data e nxjerrjes së aktgjykimit.

Kur gjykata e lejon shkurorëzimin në dispozitivë vendoset edhe për mënyrën e mbajtjes, ushqimit dhe edukimit të fëmijëve. Kështu që procedura e mëtejme lidhur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë mund të vazhdojë vetëm sipas mjeteve juridike. Ndryshe nëse palët nuk e goditin vendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda afatit të paraparë me ligj, vendimi bëhet i plotëfuqishëm.⁹⁹

4.3 PROCEDURA SIPAS MJETEVE JURIDIKE

Sikur në secilën procedurë civile, edhe në procedurën e shkurorëzimit mjetet juridike ndahen në mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme. Ankesa si mjet i rregullt juridik paraqitet kundër aktgjykimit i cili ka marrë formën e prerë. Ankesa mund të paraqitet në periudhë prej 15 ditësh.

Ankesa mund të paraqitet për shkak të zbatimit të shkeljes së dispozitave procedurale, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Në rastet kur ka filluar procedura e përbashkët e bashkëshortëve, ankesa është një mjet i kufizuar. Aktgjykimi¹⁰⁰ me të cilin zgjidhet martesë sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkak të shkurorëzimit me marrëveshje, mund të goditet vetëm për shkak: të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore ose për arsye se propozimi është dhënë nën lajthim ose nën ndikimin e dhunës, kanosjes, mashtrimit ose lajthimit. Pasi të ketë vendosur gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesën, aktgjykimi e mer formën e prerë. Duhet thënë se aktgjykimi e mer formën e prerë edhe atëherë kur vendimi i gjykatës është i shkallës së parë. Mjetet e jashtëzakonshme juridike mund të paraqiten vetëm nëse janë shfytëzuar mjetet e rregullta.

⁹⁹ Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Faculty of Laë, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.196

¹⁰⁰ Abdulla Aliu, Haxhi Gashi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007, fq.177

Në këtë rast vendimi me të cilin gjykata e ka lejuar ose refuzuar shkurorëzimin nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme vetëm në pjesën që i përket lejimit ose refuzimit.¹⁰¹

Përfundoj me atë se divorci është rritur shumë kohëve të fundit dhe shkaqet që çojnë çiftet në këtë vendim janë të shumta.

¹⁰¹ Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Faculty of Laë, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.196

KAPITULLI I PESTË

5. ASPEKTE KRAHASUESE

5.1 SHKURORËZIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Në bazë të nenit 68¹⁰² parag.1 sipas Ligjit për Familje të Kosovës, martesë mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. Shkurorëzimi apo divorci si një ndër problemet me të mëdha sociale në mbarë botën ka nisur të rritet me hapa të shpejtë edhe në Kosovë. Studimet në lidhje me shkurorëzimin janë të pakta në Kosovë. Ky problem në Kosovë më shumë trajtohet si problem privat, që i përket vetëm familjeve e jo të gjithë shoqërisë. Proces i kundërt me procesin e kurorëzimit (lidhjes së martesës) është procesi i shkurorëzimit i cili shënon shuarjen e martesës.

Martesa mund të shuhet përmes këtyre mënyrave:

- *Me vdekjen e bashkëshortit*
- *Shpalljen e bashkëshortit të zhdukur*
- *Anulimin e martesës (martesë e pavlefshme)*
- *Shkurorëzimin (divorcimin)*

Të drejtë për anulim të martesës dhe divorci ka çdo person i kurorëzuar paraprakisht që dëshiron të ndërpresë kurorën me personin me të cilin është i kurorëzuar. Çështja në fjalë zgjidhet vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Pikë së pari duhet parashtruar padi në gjykatën kompetente ku bashkëshortët kanë vendos që të ndahen. Për anulimin e martesës personat të cilët kanë të drejtë të parashtrojnë padi janë bashkëshortët, prokurori publik dhe të gjithë personat që kanë interes juridik. Me rastin e shkurorëzimit të tyre personi i cili ka ndryshuar mbiemrin gjatë kurorëzimit, do të mund të kthejë mbiemrin që ka pasur më herët duke parashtruar kërkesë jo më të gjatë se 6 muaj nga zgjidhja e martesës.¹⁰³ Të gjitha kontestet tjera që paraqiten pas procesit të shkurorëzimit zgjidhen sipas ligjit. Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesë padisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.¹⁰⁴

¹⁰² Ligji Nr.2004/32, Kuvendi i Kosovës, Ligji për Familje i Kosovës

¹⁰³ Raport për shkurorëzimin në Web-faqen zyrtare të Republikës së Kosovës.

¹⁰⁴ Neni 75, Ligji Nr.2004/32, Ligji për Familje i Kosovës

5.2 KOMPARACION MIDIS LIGJIT PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE LIGJI PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Burim juridik primar në Republikën e Kosovës është Ligji për Familje, e njëjta doktrinë është edhe në vendin tonë. Edhe Ligji për Familje në Republikën e Maqedonisë edhe ai në Kosovë rregullojnë martesën, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin, kujdestarinë, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e posaçme të gjykatës. Në radhë të parë të përmendim se Ligji për familjen është një akt i përgjithshëm normativ dhe juridik i cili rregullon marrëdhëniet familjare dhe është një etapë shumë e rëndësishme në zhvillimin dhe përsosjen e rregullativës juridike. Ligji për familje krahas asaj që rregullon në vete martesën, kujdestarinë, adoptimin ai mban edhe institutin shkurorëzim. Ligji për Familje në Republikën e Kosovës nuk përmban ndonjë paragraf për ndonjë rast të shkurorëzimit të martesës, ku secili prej bashkëshortëve mban mbiemrin që ka, kurse mund të kërkojë edhe ndryshimin e atij mbiemri. Shkurorëzimi është dukuri monografike apo sociofamiljare, që është aq i vjetër sa edhe vetë njeriu, duke qenë bashkëudhëtar me martesën.

Po ashtu, një gjë tjetër që vërejtëm gjatë leximit të Ligjit për Familje të Republikës së Maqedonisë, neni 43 flet për aktgjykimin e plotëfuqishëm për shkurorëzimin ose anulimin e martesës, gjykata e parashtrohet deri tek organi i administratës kompetent për mbajtjen e librit amzë të të kurorëzuarve më së voni në afat prej 30 ditësh, me qëllim të regjistrimit të ndryshimeve si dhe deri te Qendra për Punës Sociale, në qoftë se gjatë martesës kanë fëmijë të mitur ose fëmijë mbi të cilën është vazhduar e drejta prindërore, për këtë pjesë të këtij paragrafi nuk kemi ndonjë paragraf në Ligjin për Familjen në Republikën e Kosovës. Divorci ose ndryshe shkurorëzimi është përfundimi i një bashkësie martesore. Anulimi i detyrave dhe përgjegjësi të martesës të një çifti të martuar në mënyrë ligjore. Në bazë të nevojës për plotësimin e këtij instituti është paraqitur nevoja për plotësime të caktuara në këto ligje. Shkurorëzimi sipas LFK mund të realizohet me prishjen e martesës në bazë të vendimit të gjykatës, apo të marrëveshjes së dyanshme duke kërkuar në gjykatën kompetente. (Neni 68 LFK).

Martesa mund shkurorëzohet nëpërmjet marrëveshjes së ndërsjelltë midis bashkëshortëve, dhe se gjykata do të nxjerr vendim në bazë të kësaj marrëveshje vetëm nëse vërteton se bashkëshortët e kanë arritur atë pajtim në mënyrë të lirë, serioze dhe të pakthyeshme (neni 39, LFM-së).

Ligji për Familje në Republikën e Kosovës sqaron se martesë mund të shkurorëzohet me kërkesën e njërit bashkëshort nëqoftëse marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar deri në atë masë sa jeta është bërë e padurueshme (neni,40 LFM-së), në komperacion me Ligjin për Familje të Republikës së Kosovës ku në nenin 69 përmendet se bashkshorti mund të kërkojë shkurorëzimin kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme ose për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të kthyeshme. Beneficioni i Ligjit për Familje të Kosovës është se ka paraqitur edhe shkaqet për shkurorëzim, në nenin 69, parag.2 të LFK hartohen këto shkaqe të shkurorëzimit. Shkaqet e shkurorëzimit janë mes tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllim keqe dhe paarsyeshme, sëmundja psiqike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.

5.3 SHKURORËZIMI NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Institucioni martesor është kulti më i lartë për individin dhe pjesëtarët që jetojnë në të. Por, jo çdo martesë e ka një fund të lumtur. Rastet, kur çiftet i drejtohen Gjykatës për të zgjidhur ligjërisht kurorën e tyre, janë të shpeshta dhe konsiderohen si një dukuri e shoqërisë apo edhe si normalitet i saj. Divorci si një fenomen i shoqërisë, mbart në vetvete konflikt, pasiguri, thyerje ndjenjash, komunikimi dhe si përfundim marrëdhënia nuk funksionon më. Divorci është një situatë që kalon nëpërmjet institucionit martesor, duke e përjetuar jo vetëm pjesëtarët, por edhe komuniteti social, si ndryshim madhor në jetën e individit, pasi duhet një kohë e konsiderueshme për t'u rikuperuar dhe adaptuar me të. Mbarimi i martesës sipas Kodit të Familjes është parashikuar në nenet 123-163.

Çdo dukuri njerëzore, veçanërisht ato që reflektohen në botën fizike kanë një fillim dhe një mbarim. Madje, shpeshherë thuhet se ngjarjet më të mëdha në jetën e një njeriu janë: lindja, martesë dhe vdekja. Lindja dhe vdekja janë fenomene që nuk i nënshtrohen vullnetit të njeriut. Martesë është fenomen i cili i nënshtrohet vullnetit njerëzor, por që edhe kjo si çdo fenomen tjetër njerëzor ka një fillim dhe një fund. Sipas Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë, shkaqet për mbarimin e martesës janë vdekja e njërit bashkëshort dhe zgjidhja e martesës. Në nenin 123 të Kodit të Familjes janë parashikuar tri raste, verifikimi i të cilave mbaron me një martesë të caktuar.

Këto tre raste janë:

- a) *Vdekja e njërit bashkëshort*
- b) *Shpallja e vdekjes së njërit bashkëshort*
- c) *Zgjidhja e martesës.*

Ekzistojnë dy shkaqe kryesore të mbarimit të martesës midis bashkëshortëve, shkakun që lidhet me një fakt natyror ose ngjarje natyrore dhe shkakun që lidhet me një fakt njerëzor që i nënshtrohet vullnetit njerëzor. Në këtë mënyrë martesë mbaron ose me vullnetin e bashkëshortëve ose për shkakun që nuk kanë të bëjnë me vullnetin e bashkëshortëve. Këto raste të mbarimit të martesës janë rastet tipike të njohura nga legjislacionet të mbarë botës.¹⁰⁵

a) Vdekja e bashkëshortit – Vdekja përbën një fakt juridik dhe si i tillë hyn në kategorinë e ngjarjeve natyrore. Me mbarimin e zotësisë juridike të personit të vdekur. Si rrjedhojë e mbarimit për pasojë nuk mund të ketë më të drejta dhe detyrime civile. Për këtë shkak në nenin 123 të Kodit të Familjes është përcaktuar qartë që vdekja përbën një ndër rastet e mbarimit të martesës. Një gjë e tillë është e kuptueshme po të kemi parasysh se personi i vdekur nuk është më subjekt i së drejtës. Pra me një fjalë mund të themi se vdekja është shkakun i parë i mbarimit të martesës ku pas tij vjen shpallja e personit si i zhdukur dhe në fund zgjidhja e martesës. Si rrjedhojë e mbarimit të martesës për shkak të vdekjes së njërit nga bashkëshortët vijnë disa pasoja për bashkëshortin pasjetues:

- ✓ *Pasoja me karakter vetjak.*
- ✓ *Pasoja me karakter pasuror.*

Pasojat me karakter vetjak: si rrjedhojë e mbarimit të martesës me vdekjen e njërit bashkëshort ndryshon gjendja civile e bashkëshortit pasjetues i/e martuar në i/e ve.¹⁰⁶ Në kodin e familjes nuk gjejmë të shprehur se çka ka ndodhur me mbiemrin e bashkëshortit që ka ndryshuar mbiemrin e tij/saj si rrjedhojë e martesës. Në të kundërtën nëse martesë mbaron për shkak të zgjidhjes së saj, bashkëshorti/ja do të rimarrë mbiemrin që kishte pasur para martesës. Përgjithësisht pranohet se bashkëshorti pasjetues që ka ndëruar mbiemrin e tij/saj gjatë martesës. Një gjë e tillë pranohet se është në diskrecion të bashkëshortit pasjetues. Ndonëse me vdekjen e njërit bashkëshort shuhen të drejtat dhe detyrimet bashkëshortore, sepse mbaron vetë martesë prapëseprap ligji ka parashikuar se disa detyrime vazhdojnë të qëndrojnë për bashkëshortin

¹⁰⁵ Shih, legjislacionin shqipëtarë (në këndvështrimin historik).

¹⁰⁶ Shih neni 13 të ligjit nr.8950, datë 10.12.2002, për gjendjen civile, i ndryshuar

pasjetues. Si rrjedhojë e mbarimit të martesës, bashkëshorti pasjetues gëzon të drejtën që të rimartohet sipas dëshirës së tij/saj duke respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në Kodin e Familjes. Në nenin 180 të Kodit të familjes parashikohen se “Kur fëmija ka lindur gjatë vazhdimit të dytë të martesës së nënës, prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës me martesën e dytë, sikur fëmija të ketë lindur brenda 300 ditëve nga zgjidhja e martesës së parë ose nga shpallja e pavlefshmërisë së saj.”¹⁰⁷

Neni 180, i Kodit të Familjes përmend vetëm rastet e zgjidhjes ose të pavlefshmërisë së martesës. Me një interpretim të zgjeruar të dispozitës arijmë në përfundim se edhe mbarimi i martesës për shkak të vdekjes së bashkëshortit duhet përfshirë brenda kuptimit të kësaj dispozite. Si përfundim, mund të themi se e drejta bashkëshortore pasjetues për tu rimartuar shfaqet si një e drejtë themelore e personalitetit, po aq e rëndësishme sa e drejta e çdo personi për tu martuar për herë të parë.

Pasojat me karakter pasuror: për bashkëshortët pasjetues, përveç pasojave vetjake me karakter vetjak jopasuror, ekzistojnë edhe pasoja me karakter pasuror. Në nenin 96 të Kodit të Familjes parashikohet se bashkësia mbaron me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, kur shpallet i zhdukur, ose i vdekur të njërit prej tyre shpalljen e pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës. Me vdekjen e njërit bashkëshort çelet trashigimia ligjore ose testamentare për të përcaktuar pasurinë e trashigimlënësit.

Për këtë arsye bashkëshorti pasjetues ka të drejtë të marrë gjysmën e pasurisë së fituar nga dy bashkëshortët së bashku ose tek a tek, gjatë martesës. Me mbarimin e martesës për shkak të vdekjes së njërit bashkëshort, pjestimi i pasurisë ndërmjet bashkëshortëve me regjime pasurish të ndara, për sa i përket formës, ruajtjes së pandarë të sendit të papjestueshëm, radhës së parapëlqimeve, shitjes në ankand të sendeve të papjestueshme, efekteve të ndarjes, garancisë të sendeve të papjestueshme u nënshtrohen rregullave të trashigimisë për ndarjen e trashigimtarëve (neni 120 i Kodit të Familjes).

b) Ka raste kur një person fizik, mungon për një kohë të gjatë nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij i fundit dhe për të nuk ka lajme se ku mund të ndodhet. Ligji parashikon se me kërkesën e çdo të interesuari (ku përfshihet edhe bashkëshorti), mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës, personi që mungon nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij i fundit dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet (neni 15, i Kodit Civil).

¹⁰⁷ Ky nen duhet që të përmissohet, në mënyrë që të mënjanohet problemi i vërejtur.

Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar (neni 16, i Kodi Civil). Deri në këtë pikë, marrëdhënia martesore vazhdon të ekzistojë, pasi personi i shpallur si i zhdukur nuk konsiderohet ende ligjërisht si i vdekur.¹⁰⁸

c) Në kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë janë parashikuar raste të ndryshme të zgjidhjes së martesës. Në dispozitat e këtij Kodi gjejmë të gërshetuar, qëndrime të ndryshme që u përmendën më sipër. Kështu, sipas Kodit të Familjes martesa mund të zgjidhet në këto raste:

1. *Më pëlqimin e ndërsjelltë të dy bashkëshortëve (nenet 125-128 të Kodit të Familjes)*
2. *Për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët (nenet 129-131 të Kodit të Familjes)*
3. *Me kërkesën e njërit bashkëshort (nenet 132-133 të Kodit të Familjes).*

5.4 KOMPERACION MIDIS KODIT TË FAMILJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE LIGJIT PËR FAMILJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në shkencën juridike martesa civile mbrohet nga shteti, në përputhje me Kodin e Familjes, që është pjesë e rëndësishme e legjislacionit të një vendi të caktuar. Akti i martesës që njihet nga shteti ose nga feja, i atyre personave që lidhin martesë, ndryshon tërë statusin personal dhe shoqëror të tyre. Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni i saj për mbrojtjen e institucionit martesor dhe Republika e Maqedonisë kanë disa pika të përbashkëta. Atë që kam vërejtur se Ligji për Familje i RM-së dhe Kodi Familjar i RSh-së, zgjidhjen e martesës e realizojnë me pëlqimin e ndërsjelltë të bashkëshortëve dhe po e njëjta bazohet në marrëveshjen e përbashkët e cila ka për qëllim dhënien e fundit të martesës. Edhe legjislacioni i Maqedonisë paraprin me shkurorëzim më anë të pëlqimit të dy bashkëshortëve. Kodi Familjar parasheh se zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve siç vihen në praktikë, zbatohet më shumë në rradhët e çifteve të reja që nuk kanë pasur dhe fëmijë. Kjo është lehësisht e kuptueshme pasi kur nuk ka pasuri për të ndarë dhe fëmijë për të menduar atëherë kontraditat ndërmjet bashkëshortëve për organizimin e pasojave të zgjidhjes së martesës janë më të pakta dhe më të lehta për tu kapërcyer. Për këtë arsye arrihet më lehtë një organizim kushtesh që të përfshijnë mirëkuptimin e tyre. Nga ana tjetër nëse ka fëmijë dhe pasuri rastet e konfliktet mund të kërkojnë kohë dhe për pasojë procedurat ngadalësohen.

¹⁰⁸ Në këtë pikë Kodi i Familjes i vitit 2003 ndryshon ndjeshëm nga Kodi i Familjes i vitit 1982 pasi në nenin 92, 1 të këtij të fundit parashikohet se martesa pushon me shpalljen nga gjykata të njërit bashkëshort si të pagjetur. Pra dallimi midis Kodit të Familjes të vitit 2003, për mbarimin e martesës nuk mjafton vetëm shpallja e zhdukjes së njërit bashkëshort, por nevojitet shpallja e vdekjes së tij.

Në këto kushte shpesh herë shohim se bashkëshortët kërkojnë një formë tjetër të zgjidhjes së martesës. Nga se cekëm edhe më lartë, në Kodin e Familjes vëmë re se zgjidhja e martesës për pëlqimin e ndërsjelltë të të dy bashkëshortëve paraqet karakterin e zgjidhjes së martesës. Edhe Kodi Familjar edhe Ligji për Familje mbështesin rolin e gjykatës dhe se ajo ka të drejtë tu kërkojë bashkëshortëve përcaktimin e shkakut pse ata duan të zgjidhin martesën e tyre më pëlqim reciprok. Zgjidhja e martesës me pëlqimin e ndërsjelltë të bashkëshortëve rregullohet nga nenet (125-128 të Kodit të Familjes). Neni 125 i Kodit të Familjes parashikon se kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës së bashku me kërkesën i paraqesin gjykatës edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Edhe Ligji për Familje i Republikës së Maqedonisë e parasheh këtë paragraf duke folur për shkurorëzimin me marrëveshje të ndërsjelltë midis bashkëshortëve. Sipas nenit 96 të Kodit të Familjes parashikohen se bashkësia mbaron me zgjidhjen e martesës. Për rrjedhojë bashkëshortët duhet të kenë në konsideratë këtë element të rëndësishëm.

Kur mund të kërkon zgjidhjen e martesës (divorcin)

1. Nëse të dy bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, ata mund të paraqesin para gjykatës bashkë me kërkesë padinë dhe një projekt marrëveshje. Projekt marrëveshja duhet përpiluar para një noteri dhe në të ju duhet të parashikoni se si do të zgjidhni pasojat e zgjidhjes së martesës (cili nga partnerët do të mbajë fëmijët, sa do të kontribojë partneri tjetër ekonomikisht për rritjen e tyre, etj).¹⁰⁹

2. Në rast se ju dhe bashkëshorti nuk jetoni më bashkë prej 3 vjetësh. Pra në këtë rast kërkohet të provohet se ju jeni ndarë faktikisht prej një periudhe 3 vjeçare.

3. Neni 132 i Kodit të Familjes parashikon se secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur: “Për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesë” jetesa e përbashkët është bërë e pamundur dhe martesë ka humbur qëllimin për të cilin është lidhur për njërin ose të dy bashkëshortët.

¹⁰⁹ Albanian Law Diary, Utilitarian blog on different legal issues for those who live in Albania, Dorina Zhupa, Mbarimi i Martesës në Shqipëri, fq.1

Provat që duhet të paraqiten në gjykatë në rastin kur kërkoni zgjidhjen e martesës:

Çertifikatë lindje për secilin nga bashkëshortët

Çertifikatë martesë

Çertifikatë lindje për secilin nga fëmijët (në rast se keni fëmijë)

Çertifikatë familjare

Duhet të keni parasysh se procesi i gjykimit për zgjidhjen e martesës ka si objekt:

Zgjidhjen e martesës

Të përcaktojë se me kë do të rrinë fëmijët

Të përcaktojë se sa do jetë pensioni ushqimor (sasinë e parave) që do të paguajë prindi me të cilin nuk do të jetojnë fëmijët

Procedura e gjykimit për zgjidhjen e martesës

Seanca e parë e këtij gjykimi quhet seanca e pajtimit dhe të dy bashkëshortët janë të detyruar të marrin pjesë. Pas kësaj seance mund të zgjidhni ju nëse doni të shkoni në gjykim ose të përfaqësoheni me avokat. Ndarja e pasurisë së bashkëshortëve do të zgjidhet në një proces tjetër gjyqësor me objekt “Pjestim pasurie”.¹¹⁰

¹¹⁰ Po aty.

5.5 NËNKAPITULL I VEÇANTË

5.5.1 Çështja e kujdestarisë së fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë dhe legjislacioneve Europiane

Qëndrimi i fëmijëve pas një shkurorëzimi është një çështje shumë e rëndësishme. Në shumë raste zgjasin me muaj proceset deri sa gjykata të marrë vendimin përfundimtar për të mirën e fëmijëve. Një avokat i mirë mund t'ju ndihmojë që kujdestarinë ta merrni ju nëse normalisht keni të drejtë për ta marrë. Kujdestaria ka disa mënyra për t'u realizuar. Një mënyrë për të patur prindërit kujdestarinë është ajo që e ndan këtë kujdes në 50%. Njëri prind kujdeset për fëmijën duke jetuar me të, dhe tjetri kujdeset për mbështetjen ekonomike dhe për ta përfaqësuar fëmijën në jetën e tij për çdo problem që mund të ketë. Jemi njohur, gjithashtu edhe me ekzistencën e shumë institucioneve publike e private, të cilat kryejnë po të njëjtin funksion. Ato ofrojnë përkujdesje ndaj të miturve ose personave të cilët nuk kanë zotësi të plotë për të vepruar.

Kur flasim për institucionin ligjor të kujdestarisë kemi të bëjmë me disa marrëdhënie shumë më të gjëra sesa një përkujdesje të thjeshtë. Kujdestaria është krijuar me ligj si një institut i të drejtës familjare, për të garantuar mbrojtjen e personave, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre duke u ofruar atyre si plotësimin e nevojave për jetesë, ashtu dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave që ata kanë. Punët dhe detyrat e organit të kujdestarisë janë të shumta e të ndërlikuara. Qëllimi i kujdestarisë është mbrojtja e personalitetit, e pasurisë e të drejtave dhe interesave të personave të mitur dhe të personave të tjerë të cilët nuk janë në gjendje të përkujdesen për vetveten. Organi i kujdestarisë, punët nga veprimtaria e vet i kryen në dy mënyra: të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë. Quhen të drejtëpërdrejta ato punë të cilat organi i kujdestarisë i kryen vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë pra për pjesmarrjen e personave të tjerë. Për këtë mënyrë të kryerjes së kujdestarisë, organi i kujdestarisë përcaktohet atëherë kur nuk mund të gjejë dhe të caktojë persona të përshtatshëm për ti emërtuar si kujdestarë.

Në këtë marrëdhënie kujdestari ushtron funksione të ngjajshme me ato të prindërve. Ai i ushtron këto funksione me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të personit që është vënë në kujdestarinë e tyre. Më anë të kujdestarisë Republika e Maqedonisë u jep një përkrahje të madhe të gjithë atyre fëmijëve minoren të cilët janë pa përkujdesin e prindërve.

Punët e kujdestarisë i bën Qendra për punë sociale e cila i realizon me anë të kujdestarëve ose njërëzve të tjerë që punojnë punë të ngjajshme me kujdestarinë – Neni 125. Kujdestaria është ndryshe nga adoptimi. Këtu, gjithashtu, një fëmijë rritet në një familje të ndryshme nga familja biologjike e tij/saj. Megjithatë, në këtë rast, prindërit biologjik të fëmijës nën kujdestari vazhdojnë të jenë të përfshirë dhe kanë zë në vendime të rëndësishme. Normalisht kujdestaria është e përkohshme. Ajo mund të jetë afatshkurtër ose (shumë) afatgjatë. Kujdestaria është një zgjidhje kur bëhet shumë e vështirë për prindërit të kujdesen vetë për fëmijën e tyre. Kjo mund të jetë për arsye sociale ose financiare apo për arsye të veçanta që kanë të bëjnë me fëmijën, (për shembull: një fëmijë me aftësi të kufizuara apo një çrregullim psikiatrik).

Personi nën kujdestari, Qendra për punë dhe Politikë Sociale emërton kujdestarë përderisa nuk vendos që obligimin e kujdestarit ta kryejë drejtëpërdrejtë. Për kujdestar vendoset personi i cili ka cilësi të veta dhe aftësi për kryerjen e obligimit kujdestar dhe i cili paraprakisht do të jep pajtimin që të jetë kujdestar. Gjatë përcaktimit të kujdestarit, Qendra për punë dhe politikë sociale i merr parasysh edhe dëshirat e personit nën kujdestari nëse është në gjendje që ati ti shfaqë, si dhe dëshirat e të afërmeve të tij (*neni 135 i Ligjit për Familje në Republikën e Maqedonisë*). Kurse personi i njëjtë mund të përcaktohet për kujdestar edhe për më tepër persona nëse për atë pajtohet nëse ajo nuk është në kundërshtim me interesat e ndonjërit nga personat të cilët vendosen nën kujdestari dhe nëse me atë ato pajtohen (*neni 136 i Ligjit për Familje në Republikën e Maqedonisë*). Në legjislacionet evropiane çështja e kujdestarisë së fëmijëve ju ndahet të dy prindërve kurse në vendin tonë është ende koncepti tradicional pas shkurorëzimit vetëm njërit prind. Përmes Kujdestarisë Republika e Maqedonisë u jep mbrojtje fëmijëve të mitur të cilët janë pa përkujdes prindëror dhe personave madhor të cilëve u është marrë apo kufizuar aftësia e të vepruarit. Sipas këtij Ligji mbrotja u jepet edhe personave tjerë të cilët nuk kanë mundësi të kujdesen për mbrotjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Në vitin 2010 Republika e Maqedonisë filloi reformën më të rëndësishme të ligjit civil që nga pavarësia e saj në vitin 1991. Kjo reformë pritet të përfshijë ndryshime të rëndësishme në ligjin e familjes. Duke marrë parasysh rëndësinë e fëmijës, ky artikull është efekti pozitiv i kujdestarisë së përbashkët për fëmijët. Në ligjin bashkohor të familjes, prindërit janë të detyruar të organizojnë marrëveshjen e bashkimit të të drejtave të prindërve me pajtimin e të dy anëve ose me ndërmejtësimin e avokatëve ose ndërmjetësuesve.

Ky institut i marrëveshjes së ndërsjelltë njihet si kujdestari e bashkuar ose zbatim i bashkuar i së drejtës prindërore që u mundëson prindërve edhe pse janë të ndarë të rregullojnë të drejtat e tyre të kujdestarisë në mënyrë të përshtatshme për të rritur fëmijën e tyre.¹¹¹ Me një marrëveshje të përbashkët të kujdestarisë, prindërit pranojnë detyrimin për të zbatuar të gjitha të drejtat e tyre nga detyrimet me qëllim që të jenë më afër nevojave të fëmijëve, ky lloj institut të përbashkët të kujdestarisë ndihmon në shmangien e ndjenjave të armiqësisë dhe mosmarrëveshjeve në lidhje me vendimin gjyqësor i cili i jepet kujdestarit të përhershëm në një nga prindërit. Prindërit të cilët jetojnë së bashku (në martesë ose partneritet familjar), implementojnë zbatimin e detyrave të tyre prindërore me anë të marrëveshjes së përbashkët dhe e realizojnë atë në interes sa më të lartë për fëmijën. Prindërit vendosin për të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve të tyre. Ata janë përgjegjës reciprokisht për arsimimin e tyre dhe për sigurimin një jetë të shëndetshme dhe të denjë në përputhje me të ardhurat dhe mundësitë e tyre. Prindërit kryejnë të drejtat e tyre prindërore duke kontribuar në edukimin e fëmijëve, duke i mbështetur ato, duke i përfaqësuar ato dhe duke krijuar kështu një ambient të përshtatshëm për zhvillimin psiko-fizik. Kujdestaria e ndarë i referohet rrethanave në të cilat secili prind ka kujdestari të tijën fizike, me të paktën një prej fëmijëve, në rastet kur fëmijët janë ndarë ndërmjet prindërve. Kujdestaria e vetme, i referohet rasteve kur vetëm njëri prej prindërve ka kujdestarinë e fëmijëve dhe ndërmer vendimet kryesore për zhvillimin e tyre. Zakonisht, kjo lloj kujdestarie aplikohet kur prindi tjetër është abuziv apo nuk është i pranishëm në jetën familjare. Kujdestaria e përbashkët i referohet rasteve kur të dy prindërit kanë të drejta të njëjta mbi fëmijët dhe të dy vendosin lidhur me zhvillimin e tyre. Zakonisht, kjo lloj kujdestarie lidhet me rastet e prindërve të cilët nuk kanë qenë të martuar (bashkëjetues) dhe ndahen. Në këtë lloj kujdestarie, fëmijët kalojnë kohë të njëjta me të dy prindërit. Në disa raste, njihet edhe kujdestaria e gjyshërve, të cilët mund të kenë kujdestarinë kryesore të fëmijës, në çështjet që gjykata e vendos këtë dhe ky vendim përbën interesin më të lartë të fëmijës. Studiues të tjerë theksojnë rëndësinë e kujdestarisë së përbashkët, lidhur me të cilën është krijuar një tension në zhvillimet në fushën e kujdestarisë për fëmijët, pasi nga njëra anë njihet rroli i babait në rritjen e fëmijës si prindi bashkëpunues me nënën pas divorcit, por nga ana tjetër disa prej tyre nuk kualifikohen për shkak

¹¹¹ Selmani, Arta, Joined and responsible parenting, Doi:10.1515/seeur-2017-0011, fq.1

se janë ushtrues të dhunës ndaj partnerit tjetër, apo për shumë arsye të tjera që lidhen me prindërimin. (Bancroft & Silverman, 2002)

Përgjegjësia prindërore dhe ushtrimi i prindërve janë një nga çështjet më të hulumtuara në ligjin bashkëkohor të familjes, veçanërisht ushtrimi i prindërve pas shkurorëzimit. Dinamika e shkurorëzimit është një nga arsyet për ridefinimin e konceptit të familjes në nivel global. Ky trend i rritjes së numrit të shkurorëzimeve është gjithashtu i pranishëm në shoqërinë tonë. Pjesa më e ndjeshme e gjithë historisë është kujdesi i së ardhmes për fëmijët. Në ligjin bashkëkohor të familjes, kujdesi prindëror dhe ushtrimi i përgjegjësisë prindërore është një nga pyetjet më të hulumtuara, të cilat në vitet e fundit kanë qenë pjesë e debateve edhe në Republikën e Maqedonisë. Të miturit kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre, por ata këtë arsye mund të jetojnë ndaras nga prindërit e tyre vetëm kur kjo është në interes të tyre të menjëhershëm ose kur ajo është me interes të përbashkët për fëmijët dhe prindërit (Ligji mbi Familjen, LF, neni 47, paragrafi 1). Fëmija realizon të drejtën për të jetuar me prindërit e tyre. Kur prindërit jetojnë së bashku, ata ushtrojnë të drejtën e tyre të prindërimit. Kur prindërit nuk jetojnë së bashku, ata mund të vazhdojnë ushtrimin e përbashkët të të drejtave të tyre të përbashkëta (kujdestari i përbashkët).

Theks i veçantë do t'i kushtohet kujdestarisë së përbashkët të institutit pas shkurorëzimit duke marrë parasysh konceptet moderne të paraqitura në ligjin modern familjar rreth kësaj çështjeje. Shkurorëzimi është një pjesë integrale e çdo shoqërie (në të gjitha fazat e zhvillimit të saj). Familja si një institucion në Maqedoni kryesisht funksiononte duke u bazuar në rregullat zakonore sipas të cilave përfaqësonte diçka të shenjtë dhe ndërprerja e saj erdhi për shkak të arsyeve morale. Siç është përmendur më lart, pjesa më e ndjeshme e episodit të shkurorëzimit është kujdesi i vazhdueshëm i fëmijëve të përbashkët. Duke u nisur nga parimi i interesave më të mira të fëmijës, e cila është imperativi themelor dhe më i rëndësishëm i mbrojtur nga të gjitha dokumentet ndërkombëtare si dhe surgjerimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. E drejta e fëmijëve për t'u kujdesur dhe rritur nga prindërit e tyre, që jetojnë së bashku ose veç e veç, garantohet nga dokumenti më i spikatur mbi të drejtat e fëmijëve, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Sipas Konventës - Ndarja e fëmijëve dhe prindërve duhet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës. Vendime të tilla mund të bëhen nëse fëmija është lënë pas dore ose keqtrajtuar nga prindërit; kështu që ndarja mund të ndodhë si rezultat i shkurorëzimit të

prindërve, prandaj një vendim duhet ta bëjë të qartë se ku dhe me cilin prind fëmija do të vazhdojë të jetojë (CRC, neni 9 paragrafi 1). Nga ana tjetër, prindërit që jetojnë së bashku (të martuar ose jashtë martese), në vetvete kryejnë detyrat e tyre së bashku dhe në mënyrë miqësore dhe në interes të fëmijëve. Prindërit së bashku vendosin për të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve të tyre të mitur. Një nga faktorët kryesorë është dinamika e çifteve të shkurorëzuara që çon në ridefinimin e konceptit të familjes në vendet evropiane. Ky trend i rritjes së numrit të shkurorëzimeve ka vënë në pikëpyetje interesin e fëmijës nëpërmjet vendimit për jetën e tij të ardhshme.

Në tërësi, ekziston një problem me prindërimin .Marrëveshja ndërmjet prindërve merr një bazë ligjore nëse miratohet nga gjykata, duke vlerësuar nëse është në interesin më të mirë të fëmijës. Legjislacioni familjar, si një element kyç, drejton të drejtat dhe interesat e fëmijëve në të gjitha llojet e marrëdhënieve, veçanërisht në marrëdhëniet prind-fëmijë dhe i jep përparësi gjykatës. Ky institut, i njohur si kujdestari i përbashkët juridik, gjithashtu u lejon prindërve, të cilët megjithëse nuk jetojnë së bashku, janë po aq të aftë për të kryer prindërimin. Me këtë marrëveshje të përbashkët, prindërit gjithashtu pajtohen me njëri-tjetrin. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i kujdestarisë së përbashkët pas shkurorëzimit është shpërndarja e barabartë e kohës midis prindërve dhe fëmijëve. Ky koncept njihet si kujdestari e përbashkët. Mbikëqyrja e përbashkët nënkupton kohën e barabartë dhe cilësore të kaluar me të dy prindërit. Fëmija dëshiron të ketë dy shtëpi dhe një vendbanim primar.

Me miratimin e Ligjit për Familjen në vitin 1992 u bë kodifikimi i marrëdhënieve martesore dhe familjare. Ligji për Marrëdhëniet e Prindërve dhe Fëmijëve, Ligji mbi Martesat dhe Ligji mbi Birësimin dhe Ligjin Ligjin për kujdestarinë. Duhet gjithashtu të theksohet se në Republikën e Maqedonisë është në proces Ligji Civil, që do të rregullohen marrëdhëniet familjare-juridike (Libri 5 i Kodit Civil). Sipas nenit 6 të Ligjit për Familjen, marrëdhënia midis bashkëshortëve bazohet në vendimin e lirë të familjes burri dhe gruaja të martohen dhe e gjithë kjo duhet të mbështetet nga respekti i ndërsjellë, barazia dhe ndihma e ndërsjellë. Pjesa hyrëse e këtij kapitulli thekson se në ligjin e familjes evropiane problemi i kujdestarisë së përbashkët pas shkurorëzimit ngadalësohet. Prindërit janë të angazhuar për të rënë dakord mbi ushtrimin e përbashkët e të drejtës prindërore, dhe ata e bëjnë këtë vullnetarisht, ose me ndihmën e avokatëve apo ndërmjetësuesve (Direktiva e Parlamentit European dhe e Këshillit mbi disa

aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare, 2008). Institucioni i Përbashkët i Kujdestarisë Juridike, siç u tha më lart, nënkupton Ushtrimin e Përbashkët të së Drejtës prindërore pas shkurorëzimit ose ndarjes së prindërve. Nëpërmjet këtij kapitulli mund të konkludojmë se shkurorëzimi kuptohet si një akt formal dhe një proces ligjor. Megjithatë LF promovon parimin e barazisë prindërore, megjithatë, pas shkurorëzimit, një përjashtim i bëhet këtij parimi. Ligji për Familjen i Republikës së Maqedonisë, ndryshe nga legjislacionet e tjera në Evropë, nuk parashikon në dispozitë eksplicite për ushtrimin e përbashkët të të qenit prind pas shkurorëzimit, por ruajnë konceptin e vjetër sipas të cilit fëmijët janë besuar me një prind dhe ai ka të drejtë të mbajë kontakte personale me ta. Ky koncept i vjetëruar i kryerjes së përgjegjësisë prindërore pas shkurorëzimit nuk korrespondon me interesat më të mira të fëmijës, rregullimi i përgjegjësisë prindërore pas shkurorëzimit është i domosdoshëm. Me fjalë të tjera, futja ligjore e këtij instituti me siguri do të garantonte: *prindër me aftësi të plotë pas shkurorëzimit; kujdes të barabartë për të dy prindërit; të dy prindërit janë drejtpërdrejt në interes të fëmijëve të tyre. Të dy prindërit kanë të njëjtin qëndrim dhe qasje ndaj fëmijëve të tyre*. Interesat dhe të drejtat e fëmijës do të jetë e domosdoshme kryesore, si në aspektin e praktikës, ashtu edhe në aspektin e rregullimit ndërkombëtar dhe treguesve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Nëse pas zgjidhjes së martesës, cilësia e bashkëshortëve kthehet në ish bashkëshort, cilësia e prindit në raport me fëmijët e tyre nuk ndryshon. Zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Prindërit vazhdojnë të kenë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për rritjen, zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve të tyre.¹¹²

Bashkëshortët mundet që me marrëveshje të përbashkët të zgjidhin çështjen e ndarjes së fëmijëve. Nëse nuk ekziston marrëveshja midis tyre lidhur me përkujdesjen e fëmijëve atëherë, gjykata *ex officio* sjell vendimin për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve, mirëpo, gjithmonë duke e marrë mendimin paraprakë të Qendrës për punë sociale, e cila i shqyrton të gjitha rrethanat të cilat mund të ndikojnë në rritjen dhe edukimin e mirë të fëmijëve, dhe duke e pasur parasysh interesin më të mirë të tyre, vendos se cilit prind do ti lehen fëmijët për rritje, ushqim dhe edukim, ndërkaq nëse ruajtja dhe edukimi i fëmijëve nga prindërit e tyre është në kundërshtim me interesin e tyre, atëherë fëmijët ngelin nën përkujdesjen e organit të kujdestarisë.

¹¹² Arta Manderi Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, Vepra e cituar, f.445.

Shkurorëzimi është alternativë më e dhimbshme për fëmijët. Ato janë ata të cilët më vështirë i përballojnë pasojat e kësaj dukurie e cila gjithnjë e më shumë mer përmasa mahnitëse dhe shkel gjithçka para vetes, pa pasur konsideratë ndaj askujt.

KAPITULLI I GJASHTË

6. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

6.1 PRAKTIKA GJYGJËSORE NË GJYKATËN THEMELORE TË DIBRËS NË LIDHJE ME RASTET E SHKURORËZIMIT ME MARRËVESHJE

Lëndët e plotëfuqishme të shkurorëzimeve në Gjykatën Themelore Dibrë, për territorin e komunave Dibrë dhe Qendër Zhupë.

Tab 1. Numri i lëndëve për shkurorëzim

Viti	Numri i lëndëve për shkurorëzim
2007	41
2008	32
2009	31
2010	30
2011	39
2012	38
2013	48
2014	29
2015	53
2016	56
2017	30

Sipas kësaj table mund të vërehet se më shumë lëndë për shkurorëzim në këta dy pjesë kemi në vitin 2016, me 56 lëndë për shkurorëzime që janë paraqitur në Komunën e Dibrës, kurse më parë lëndë për shkurorëzime janë paraqitur në vitin 2014 me 29 lëndë për shkurorëzim.

Lënda: Ushtrimi i së drejtës në marrëdhënie personale dhe kontakti i menjëhershëm me fëmijë dhe mbykqyrje në ushtrimin e së drejtës prindërore.

1. Kohëzgjatja e procedurës së shkurorëzimit dhe shpallja e vendimit të saj të kjo Gjykatë kap periudhën prej më së shumti se 3/3/muajsh, por në rastet më të komplikuar kur shkurorëzime – palët në procedurë janë me fëmijë procedura e shkurorëzimit mund të kalojë edhe periudhën 6/gjashtë/ mujorsh.

Arsyet më të shpeshta për shkurorëzimet – paditë dërguar në Gjykatën kompetente për shkurorëzimin bazohen sipas nenit 40 të Ligjit për Familje, me kërkesë – padi nga njëra palë (burri ose gruaja), për shkak të mosmarëveshjeve dhe konflikteve në marrëdhëniet martesore, deri në atë masë që jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme. Si dhe bazuar në nenin 41 nga i njëjti Ligj, me kërkesë – padi të njëres palë (palës bashkëshortore), kur jeta bashkëshortore – bashkimi martesor është shkëputur më shumë se 1 vit.

Sipas punimit 3 mujorsh pranë Gjykatës së Dibrës e cila është Gjykatë kompetente për shkurorëzimet në rajonin Dibër si dhe komunë Qendër Zhupë, konstatuam dhe verifikuam statistikën e shkurorëzimeve në këtë Gjykatë dhe atë duke filluar prej periudhës së vitit 2007 dhe deri në vitin 2017.

Tab.2 Numri i padive për shkurorëzim

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2007
Inicuar nga bashk.burri	20 lëndë	41 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	21 lëndë	41 lëndë

Në bazë të kësaj tabelë mund të vërejmë se padi të inicuar më shumë kanë qenë nga ana e gruas në vitin 2007, pra 21 lëndë paditës kurse përafërsisht me këtë kanë qenë edhe padit nga ana e burrit me 20 lëndë.¹¹³

Tab.3 Numri i padive për shkurorëzim, inicuar nga bashkëshortët

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2008
Inicuar nga bashk.burri	14 lëndë	32 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	17 lëndë	32 lëndë

Në bazë të kësaj tabele mund të shikojmë se në vitin 2008 janë realizuar 17 lëndë për shkurorëzim të inicuar nga gruaja, kurse 14 lëndë janë inicuar nga ana e burrit.¹¹⁴

¹¹³ Të dhënat janë marrë nga Gjykata Themelore në Dibër, për shkak të temës time të masterit.

Tab.4 Paditë për shkurorëzim (viti, 2009).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2009
Inicuar nga bashk.burri	19 lëndë	31 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	12 lëndë	31 lëndë

Në bazë të kësaj tabele, mund të shikojmë se në vitin 2009, 12 lëndë janë inicuar nga gruaja kurse 19 lëndë.

Tab.5 Paditë për shkurorëzim (viti, 2010).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2010
Inicuar nga bashk.burri	13 lëndë	30 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	17 lëndë	30 lëndë

Në bazë të kësaj tabele konkludojmë se paditë sërish janë nga ana e gruas, 17 lëndë nga gjinia femërore dhe 13 lëndë nga gjinia mashkullore.

Tab.6 Paditë për shkurorëzim (viti, 2011).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2011
Inicuar nga bashk. burri	20 lëndë	39 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	19 lëndë	39 lëndë

39 lëndë gjithësej padi për shkurorëzim janë realizuar në vitin 2011, 19 lëndët ishin nga gruaja kurse 20 lëndë nga burri.

¹¹⁴ Të dhënat janë marrë nga Gjykata Themelore në Dibër, për shkak të temës time të masterit.

Tab.7 Paditë për shkurorëzim (viti, 2012).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2012
Inicuar nga bashk. burri	14 lëndë	28 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	14 lëndë	28 lëndë

Në bazë të kësaj table numri i padive të shkurorëzimit është e njëjtë, 14 lëndë nga të dy palët në vitin 2012.

Tab.8 Paditë për shkurorëzim (viti, 2013).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2013
Inicuar nga bashk. burri	18 lëndë	38 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	20 lëndë	38 lëndë

Tab.9 Paditë për shkurorëzim (viti, 2014).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2014
Inicuar nga bashk. burri	19 lëndë	29 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	10 lëndë	29 lëndë

Tab.10 Paditë për shkurorëzim (viti, 2015).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2015
Inicuar nga bashk. burri	32 lëndë	48 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	16 lëndë	48 lëndë

Tab.11 Paditë për shkurorëzim (viti, 2016).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2016
Inicuar nga bashk. burri	20 lëndë	52 lëndë
Inicuar nga bashk.gruaja	32 lëndë	52 lëndë

Tab.12 Paditë për shkurorëzim (viti, 2017).

Padi për shkurorëzim	Numri	Gjithësej në 2017
Inicuar nga bashk. burri	14 lëndë	30 lëndë deri në Shtator
Inicuar nga bashk.gruaja	16 lëndë	30 lëndë deri në Shtator

Numri i rasteve në të cilët ka vendosur gjykata ku pjesë e procedurës së shkurorëzimit është edhe kujdesi dhe mbajtja e fëmijës të njërit prind, pranë kësaj gjykate ka pasur shumë raste edhe atë:

Tab.13 Numri i rasteve të shkurorëzimit gjatë peridhës kohore (2007-2017)

Vitet e rasteve	Numri i rasteve	Gjithësej
2007	10	10
2008	8	8
2009	12	12
2010	6	6
2011	14	14
2012	18	18
2013	11	11
2014	10	10
2015	10	10
2016	10	10
2017	Deri në muajit Shtator	Deri në muajit Shtator

Numri i lëndëve të shpallura nga kjo gjykatë në bazë të marrëveshjeve ndërmjet palëve të çiftit bashkëshortor për kujdesin e fëmijëve, janë disa raste edhe atë.¹¹⁵

Vitet e rasteve	Numri i rasteve	Gjithësej
2007	3	3
2008	2	2
2009	6	6
2010	5	5
2011	3	3
2012	2	2
2013	7	7
2014	2	2
2015	2	2

Në këtë kapitull lexuesi do të njohet me mënyrën se si është realizuar studimi më të gjithë përbërësit e saj dhe me mënyrën e kombinimi të tyre për të pëfituar, rezultate e duhur. Në këtë studim është përdorur ndërturja e metodave kryesore, metodat sasiore dhe cilësore të kërkimit. Po ashtu në këtë studim njëkohësisht edhe impaktin e shkurorëzimit në Komunën e Dibrës. Instrumentet e përdorura në këtë punim njëkohësisht është përdorur një pyetësor si vetëraportim i përbërë nga 10 pyetje të organizuara. Pjesa e parë ofron një informacion mbi të dhënat sociodemografike të shkurorëzimeve, pjesa e dytë ka përmbajtjen e pyetjeve. Të anketuarit në këtë punim janë 150 të anketuar.

Kështu flasin statistikën. Numri i divorceve gati dyfishohet kohën e fundit tek çiftet bashkëshortore në vendin tonë, ndërsa të rinjtë shumë më rëndë vendosin që të kurrorëzohen.

¹¹⁵ Të dhënat janë marrë nga Gjykata Themelore në Dibrë, për shkak të temës time të masterit.

Kështu flasin të dhënat më të reja të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave në Maqedoni. Për dallim nga viti 2009 kur ka pasur 14.929 kurorëzime të reja, ndërsa janë evidentuar 1287 raste të shkurorëzimit. Mirëpo në vitin 2013 ka pasur 13.982 kurorëzime, ndërsa shkurorëzimet kanë arritur rekordin, që të regjistrohen gjithsej 2045 raste divorci në Maqedoni. Nga këto statistika del se numri i divorceve gati dyfishohet kohën e fundit tek çiftet bashkëshortore në vendin tonë, ndërsa të rinjtë shumë më rëndë vendosin që të kurorëzohen. Divorcet e regjistruara nëpër gjykatat tona tronditin shumë familje. Në gjykatat tona, sipas këtyre statistikave shpesh paraqiten shifra të betejave të çifteve për t'i dhënë fund martesave të tyre nëpër sallat e gjykatave.

6.1.1 STATISTIKA RRETH SHKURORËZIMIT PËR DISA VITE NË RM

Numri i shkukurëzimeve në R.M sipas muajve

Viti	Gjiths.	Muaj												Viti
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
2015	2200	166	212	208	190	160	174	213	74	136	209	226	232	2015
2016	1985	181	207	245	187	158	39	62	79	173	219	221	214	2016

Burimi : <http://www.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.13.pdf>

Numri i shkukurëzimeve sipas moshës së bashkëshortëve

Mosha	Gjiths.	Mosha e bashkëshortëve										
e bashk.		Ndër moshën 20 vj	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55 e tepër	e	Mosha e gruas
Totali	1985	2	83	253	345	357	350	271	156	168		Total
Ndër 20 vj	23	1	12	6	3	-	-	1	-	-		Ndër 20 vj
20-24	193	1	62	88	25	11	6	-	-	-		20-24
25-29	369	-	9	138	147	52	17	5	-	1		25-29
30-34	359	-	-	20	141	126	51	17	1	3		30-34
40-44	344	-	-	1	19	144	139	33	6	2		40-44
45-49	304	-	-	-	2	4	15	79	71	23		45-49
50-54	194	-	-	-	1	1	9	15	40	37		50-54
55 e tepër	103	-	-	-	1	1	9	15	40	37		55 e tepër

Burimi: <http://www.stat.gov.mk/pdf/2017/2.1.17.13.pdf>

6.2 METODA E ANALIZËS SË TË DHËNAVE SASIORE


Për mbledhjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave të pyetësorit është përdorur metoda e mledhjes dhe zbritjes, mesit aritmetik dhe grafikonëve në Exell.

6.3 ANKETA DHE PËRMBAJTJA E SAJ

1. Cilat janë rethanat që ndikuan në paraqitjen e shkurorëzimit me marrëveshje si mënyre e re e shkurorëzimit?
2. Si zhvillohet procedura e shkurorëzimit me marrëveshje dhe cili është roli i palëve dhe i gjykatës në atë procedurë?
3. Cili lloj shkurorëzimi preferohet më shumë dhe është më i shpeshtë në praktikën gjyqësore?
4. Cilët nga bashkëshortët më së shumti paraqesin padi për shkurorëzim?
5. Cilët janë shkaqet më të shumta për shkurorëzim?
6. A ka ndikim dhuna në shkurorëzim?
7. Problemi i parave a është një ndër zgjidhjet për divorc?
8. Fëmijët i keni marrë ju apo ua keni dhënë bashkëshortit/bashkëshortes?
9. A keni kontakt me fëmijën tuja edhe pas divorcit?
10. Sa ka ndikuar shkurorëzimi në gjendjen ekonomike të të shkurorëzuarve?


6.4 INTERPRETIMI DHE PARAQITJA E REZULTATEVE NGA PYETËSORI I REALIZUAR.

Mostra e të anketuarëve është në Komunën e Dibrës, në këtë punim për shkaqe të punimit të masterit. Kemi anketuar rreth 150 persona. 57% e mostrës së anketuar kanë qenë femra, kurse 43% tjetër kanë qenë të gjinisë mashkullore.



Grafiku 1.Numri i të anketuarëve


Kategoria e pjesëmarrësve sipas moshës ka qenë e ndryshme. Mosha në mostrën tonë është 20 deri 45 vite. Mosha eminente me përqindje më të madhe që ka marrë pjesë në plotësimin e këtij pyetësoi është mosha 31 deri 35 me përqindje më të madhe (50%).



Grafiku 2.Mosha e të anketuarëve

Statusi i punësimit

■ I/E punësuar ■ I/E papunësuar



Grafiku 3. Statusi i punësimit

Për shkak se statusi i punësimit ka një ndikim dhe konsiderohet si një ndër faktorët relevant për shkurorëzim janë marrë infortmata se 64% e respondentëve janë të punësuar, ndërsa 36% e tyre jo.


- Shpërndarja e anketës, është realizuar në rajonin e Dibrës.
- Përgjigjet e anketës janë gjithësej 11 dhe në pjesën në vazhdim do të paraqet edhe përgjigjet e tyre me grafikone dhe me përqindje, që do të më ndihmoj të testoj hipotezat e këtij punimi.

Në pyetjen e parë: Cilat janë rrethanat që ndikuan në paraqitjen e shkurorëzimit me marrëveshje si mënyrë të re të shkurorëzimit?

Shkaqet dhe pasojat e shkurorëzimeve në Komunën e Dibrës janë të ndryshme dhe njëkohësisht janë objektive të këtij studimi.

Shkurorëzimi me marrëveshje

■ Marrveshje rreth fëmijëve ■ Zgjidhje rreth mbajtjes ekonomike



Grafiku 4. Shkuroëzimi me marrëveshje

Shkuroëzimi me marrëveshje është realizuar si një mënyre e re e shkurorëzimit. Rrethanat që ndikuan në paraqitjen e kësaj marrëveshje janë pasojat martesore. Nëse një çift bashkëshortorë ka pasur fëmijë dhe vjen puna deri tek shkurorëzimi ata në paraqitjen në gjykatë paraqesin edhe një marrëveshje e cila përmban pasojat e zgjidhjes së martesës së tyre. 41% e të anketuarëve mendojnë që për paraqitjen e kësaj mënyrë të shkurorëzimit kanë qënë zgjidhja e mbajtjes ekonomike, cili prej prindërve do të kontribojë më shumë ekonomikisht pas zgjidhjes së martesës, kurse 59 % mendojnë e është paraqitur si rrethanë për fëmijët se kush do të mbajë përgjigjësi për ta. Dy bashkëshortët mund të akordohen për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, nëse janë marrë vesh njëri me tjetrin për zgjidhjen e saj.

Zgjidhja e martesës me marrëveshje bëhet me propozim të dy bashkëshorteve para gjykatës kompetente. Zgjidhja me marrëveshje e martesës me fëmijë të mitur të përbashkët, të birësuar ose fëmijë ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore bëhet kur dy bashkëshortët parashtrajnë marrëveshje me shkrim për përkujdesje edukim dhe mbajtje të fëmijëve të përbashkët. Bashkëshortët duhet të paraqesin para gjykatës edhe marrëveshjen e përbashkët lidhur me kontaktet personale të bashkëshortit të cilit nuk i besohet fëmija në përkujdesje, edukim dhe mbajtje me fëmijën e tij. Zgjidhja e martesës pa fëmijë të përbashkët me marrëveshje është e thjeshtë. Me këtë rast bashkëshortët nuk janë të detyruar që ti paraqesin shkaqet për zgjidhjen e martesës.


Në pyetjen e dytë: *Si zhvillohet procedura e shkurorëzimit me marrëveshje dhe cili është roli i palëve dhe i gjykatës në atë procedurë?*

Zgjidhja e martesës përfaqëson mbarimin e martesës duke qënë bashkëshortët të gjallë. Zgjidhja e martesës me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve, bazohet në një marrëveshje reciproke, të përbashkët, të tyre, e cila ka për qëllim dhënien fund të martesës që ekziston midis dy bashkëshortëve. Së pari, e gjithë procedura gjyqësore fillon me paraqitjen e një kërkesë të përbashkët të të dy bashkëshortëve, të cilët përcaktojnë se duan që të zgjidhin martesën e tyre. Kjo kërkesë mund të paraqitet në gjykatë ose nga bashkëshortët personalisht ose nga përfaqësuesit e tyre respektivë. Së dyti, me kërkesën për zgjidhjen e martesës, bashkëshortët duhet t'i paraqesin gjykatës edhe një projekt marrëveshje në të cilën të jetë parashikuar mënyra e rregullimit të pasojave që vijnë si rrjedhojë e zgjidhjes së martesës, të cilat janë:

- *Lënien për rritje dhe edukim të fëmijëve të mitur dhe përcaktimin e të ardhurave për rritjen dhe edukimin e tyre.*
- *Kontributin e secilit bashkëshort në favor të bashkëshortit nevojtar.*
- *Rregullimin e marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve.*

Së treti, gjykata ka për detyrë të shqyrtojë kërkesën e dy bashkëshortëve. Nëse gjykata bindet për sa më sipër, vendos zgjidhjen e martesës dhe në të njëjtin vendim, miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Vendimi i gjykatës, si çdo vendim gjyqësor, mund t'i nënshtrohet mjeteve të ankimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.


Në pyetje e tretë: Cili lloj shkurorëzimi preferohet më shumë dhe është më i shpeshtë në praktikën gjyqësore?



Grafiku 5. Llojet e shkurorëzimit

Përgjigjet e të anketuarëve, kanë paraqitur përgjigje se 84% e tyre deklaruan se në praktikën gjyqësore më së shpeshti paraqiten shkurorëzime me marrëveshje se sa me padi (16%). Anulimi i martesës bëhet kur që në fillim martesë është e pavlefshme p.sh. nëse martesat lidhen në mes personave të gjakut, nëse martesë është lidhur nën ndikimin e dhunës, kërcënimit, kanosjes ose edhe të mashtrimit. Ndërsa shkurorëzimi bëhet kryesisht me anë të padisë dhe me propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës.


Në pyetjen e katërt: *Cilët nga bashkëshortët më së shumti paraqesin padi për shkurorëzim?*



Grafiku 6. *Kush paraqet padi për shkurorëzim burri apo gruaja.*

Respondentët kanë dhënë këtë sqarim: 67% e padive për shkurorëzimin kanë qenë të incuara nga ana e burrave, kurse 33% tjetër janë inicuar nga ana grave.

Në pyetjen e pestë: *Cilët janë shkaqet më të shumta për shkurorëzim?*




Grafiku 7. *Shkaqet për zgjidhjen e martesës.*

Të gjitha shkaqet e sipërpërmendura kanë të përbashkët faktin se përbëjnë shkelje të përsëritura të detyrimeve që rrjedhin nga martesë dhe për pasojë jetesë e përbashkët e bashkëshortëve, bëhet e pamundur dhe martesë humbet qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët. Respondentët paraqitën se 50 % shkaqeve për shkurorëzim janë shkelja e besnikërisë nga ana e bashkëshortit ose bashkëshortes. Viteve të fundit tradhëti konsiderohet si një ndër arsyt kryesore të shkurorëzimit. Mëgjithëse në shumë vende zë edhe vendin e parë. Në Maqedoni rënditet e dyta pas divorcit për arsye të ndryshimeve në karakter dhe temperament të partnerit.

Në të shumtën e rasteve, arsye më e shpeshtë e tradhtisë në jetën bashkëshortore është motivacioni i frikës për të pranuar jetën bashkëshortore me stilin e njëjtë të jetës. Bashkëshortët, që janë preokupuar me problemet seksuale, nuk mund të kenë suksese në komunikimin e përbashkët për evitimin e problemeve. Prandaj një gjendje e tillë na bien deri te ajo që shumica e çifteve bashkëshortore të bëjnë pyetje vetvetes, "A është krejt kjo që do të kem në jetë? A do të kaloj edhe 30 apo 40 vite me këtë person pa kënaqësi, pa lumturi dhe pa fat? Përgjigja në këtë pyetje na shpie deri te tradhtia. Tradhtia që lajmërohet te femrat dhe meshkujt. Meshkujt bëjnë tradhëti sepse dëshirojnë partnerin që dallohet prej bashkëshortes së tij. Femra nuk kërkon të ketë dashuri me mashkullin që dallohet prej bashkëshortit të saj, ajo në tradhëti kërkon "diç" që nuk mundet të gjej në martesën e saj. Po ashtu edhe si përgjigje nga ana e të anketuarëve ka qenë se edhe grindjet e vazhdueshme janë rezultat i shkurorëzimit, keqtrajtimi të dërgon drej fundit të martesës. Askush nuk është bërë që të mbajë dhunën e dikujt, kështu mendojnë 10% e të anketuarëve.


Në pyetje e gjashtë: A ka ndikim dhuna në shkurorëzim?



Grafiku 8. Dhuna dhe shkurorëzimi

93% e të anketuarëve kanë deklaruar se dhuna shikohet opsjon për ndarje, 7% të anketuarëve kanë deklaruar se nuk e shohin si opsjon. Dhuna në familje është akt që shkel të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore në të cilat ka të drejtë çdo qenie njerëzore. Dhunë në familje konsiderohet çdo shkelje e të drejtës së Gruas, Burrit dhe Fëmijëve nga persona që janë pjesëtarë të familjes.


Në pyetje e shtatë: Problemi i parave a është një ndër zgjidhjet për divorc?



Grafiku 9. Paraja apo shkurorëzimi

57% e respondentëve kanë deklaruar që e shikojnë si përparësi paranë për shkurorëzim kurse 43 % tjetër nuk janë të këtij mendimi.

Në pyetjen e tetë: Fëmijët i keni marrë ju apo ua keni dhënë bashkëshortit/bashkëshortes?



Grafiku 10. Statusi i bashkëshortëve dhe çështja e fëmijëve.

49% e të anketuarëve kanë deklaruar se janë të martuar dmth fëmijët i kanë së bashku, 28% e respondentëve thanë se fëmijët i ka gruaja pas ndarjes, kurse 23% thanë se fëmijët i ka burri.

Në pyetjen e nëntë: *A keni kontakt me fëmijën tuaj edhe pas divorcit?*

Divorci është i vështirë si për vetë prindërit dhe për fëmijët. Dy njerëz martohen me idenë se nuk do të ndahen, se martesë e tyre do të ketë vazhdimësi dhe mirëkuptim. Por ja që për arsye të ndryshme, ndodh ndarja në çift. Ata që lëndohen, e që vuajnë pasojat më shumë nga divorci i prindërve janë fëmijët. Reagimet emocionale të fëmijëve zakonisht varen nga mosha e tyre në periudhën kur ndodh divorci. Shumë fëmijë përjetojnë trishtim, zemërim dhe ankth, dhe kjo nuk është e pazakontë, të manifestohet me sjelljen e tyre. Gjatë divorcit, fëmijët mund të paraqesin reagime emocionale të shumta. Mërzitja e tyre ka këto simptoma sjellje; me mospranim dhe heshtje, me kthim mbrapa, me lodhje fizike, me ndjenjën e fajit dhe me veprime armiqësore, me gjendje paniku, alarmi dhe konfuzioni. Ngjarja është shumë stresante për ta, vetë prindërit u duhet të minimizojnë stresin, e përshkallëzimin e situatës ku fëmija ndodhet. Këtu një rol të rëndësishëm e luan dhe gjinia e fëmijës, kultura, ligji, morali, kujdestaria e njërit nga prindërit, formimi psikologjik i fëmijës. Të gjithë prindërit e tjerë theksojnë se shkurorëzimi të fëmijët e tyre ka shkaktuar jo-stabilitet emocional, konfuzitet, kërkesë për t'u bashkuar prapë prindërit, dhe afërsi më të madhe me prindin i cili ka të drejtën për mbajtjen e tyre në raport me prindin tjetër.

Në pyetjen e dhjetë: *Sa ka ndikuar shkurorëzimi në gjendjen ekonomike të të shkurorëzuarve?*

Të intervistuarit që kanë qenë të papunësuar, pra 36 % e tyre janë deklaruar që e kanë të dobët qëndrueshmërinë ekonomike, pasi nuk kanë punë të qëndrueshme dhe kërkojnë në vazhdimësi pavarësi ekonomike nga familjarët, apo edhe ish-bashkëshorti/ja në rastet kur kanë fëmijë të përbashkët. Ndikim jo të theksuar kanë deklaruar të intervistuarit që nuk kanë fëmijë, ata janë përgjigjur se shkurorëzimi nuk ka ndikuar aspak në qëndrueshmërinë e tyre ekonomike. 64% e të intervistuarve janë të punësuar, mirëpo prapë paraqesin vështirësi në mbulimin e shpenzimeve, pasi tani më nuk punojnë dy anëtarë të familjes, por vetëm njëri, dhe shpenzimet janë më të larta se sa kur kanë qenë në bashkësi martesore.

RAST STUDIMI 1

Zgjidhjet e martesës në dyert e gjykatave janë bërë prej kohësh për bashkëshortët një barrë e madhe kohore, veç barrës emocionale që mbartin. Një çift që vendos të bëjë divorc në Gjykatën e Dibrës, i duhet të marrë parasysh më parë koston financiare dhe kohore që duhet të paguajë për ndjekjen e të gjithë seancave gjyqësore, që në rastin më të mire zgjasin 6 muaj. E.H dhe A.H janë një prej çifteve që zgjidhjen e martesës kanë vendosur që ta bëjnë në marrëveshje me njëri-tjetrin. Duke ditur shpenzimet dhe kohën që kërkon një ndarje në gjykatë, dy bashkëshortët në bashkëpunim dhe dakortësi mes tyre, kanë rënë dakort për detyrimet që gjithësecili do të mbajë nga martesa mes tyre. Sipas E.H martesa me bashkëshorten e tij A.H, ishte një gjë e gabuar dhe e nxituar, prandaj edhe të dy të bindur për dështimin e kësaj martese, kanë vendosur që t'i japin fund, duke hartuar edhe një marrëveshje që kanë vendosur ta firmosin në praninë e përfaqësuesit ligjor në një zyrë noteriale. Çifti kishte vetëm dy vite martesë, nuk kishin një fëmijë dhe të mirat materiale që kishin krijuar gjatë kësaj kohe nuk kishin qenë të shumta. Sipas tyre, divorci reciprok që bëhet në zyrat noteriale dhe më pas paraqitja e atij vendimi në gjykatë, është një zgjidhje shumë e mirë dhe me më pak kosto. Kryerja e zgjidhjeve martesore përmes procesit gjyqësor kalon në disa faza dhe sigurisht që kërkon një afat më të gjatë kohor. Çështjet civile që paraqiten në gjykatë, shqyrtohen dhe kalojnë përmes disa seancave. Pjesë e proceseve të zgjidhjeve martesore fillimisht janë seancat e ndërmjetësimit, ku punonjës social bëjnë këshillimin dhe ndërmjetësimin mes bashkëshorteve për të rregulluar marrëdhëniet e tyre. Nëse këto seanca dështojnë, vazhdon procesi gjyqësor që nuk përfshin vetëm zgjidhjen martesore mes bashkëshortëve, por edhe përgjegjësitë prindërore nëse çifti ka fëmijë dhe ndarjen e pasurisë së përbashkët që kanë realizuar gjatë martesës. Paraprakisht ishte hartuar një marrëveshje te noteri ku palët kanë firmosur me vullnetin e tyre të lirë mbi kujdestarinë e fëmijëve dhe mënyrën e ndarjes së pasurisë. Në seancën e parë – seancën e pajtimit, çifti edhe pse në dijeni, nuk u paraqit në këtë seancë, prandaj gjykata konsideroi se propozuesit e kanë tërhequr padinë dhe çifti kanë hequr dorë nga shkurorëzimi.

Pyetjet janë këto:

1. Çka ndodh në qoftë se palët - propozuesit nuk paraqiten në seancën e pajtimit, edhe pse shkurorëzimi është me marrëveshje?

2. Bashkëshorti, nisur nga marrëveshja që ka bërë te noteri, i ka lënë bashkëshortes shtëpinë dhe një depozitë bankare. Ai kërkon që ta rishikojë dhe të mos ia lërë depozitën bankare. Duke marrë parasysh këtë kërkesë të dytë të tij, cila është mënyra më e mirë për

Sipas nenit¹¹⁶ 240 paragrafi 3, në qoftë se palët që kanë parashtruar padi-propozim për shkurorëzim me marrëveshje nuk paraqiten në seancën e pajtimit, gjykata do të konsiderohet se të njëjtit i kanë tërhequr padinë - propozimin.

Kjo dispozitë ligjore bazohet edhe në atë që tek propozimi me marrëveshje duke qenë se të dy palët paraqiten si propozues dhe se nuk ekziston contest, që të dy palët e kanë rolin e paditësit, për dallim nga 2 llojet e tjera të shkurorëzimit, ku njera palë patjetër paraqitet si paditës, kurse pala tjetër si i paditur. Duke qenë se tek shkurorëzimi me marrëveshje të dy palët kanë rolin e paditësit, të dy mbartin pasojën juridike të mosprezences në séance - tërheqjen e padisë. Prandaj, në këte rast mosprezenca e njërës apo të dy palëve si në seancën e pajtimit ashtu edhe në seancën kryesore ka pasojë tërheqjen e padisë.

Përsa i përket shqetësimit tuaj lidhur me depozitën bankare, nëse ju nuk bini dakord që pjesëtimin e pasurisë ta bëni me marrëveshje, atëherë duhet ta kërkonit në gjykatë atë çfarë ju pretendoni. Marrëveshja që ju keni bërë te noteri për pjesëtimin e pasurisë, nuk ka asnjë fuqi juridike përderisa të dyja palët nuk i japin fuqi ligjore në gjykatë. Në këto kushte, ju duhet t'i drejtoheni me kërkesë-padi gjykatës për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët nëse zgjidhjen e martesës e realizoni me marrëveshje.

¹¹⁶Ligji për familjen i RM-së, GZ e RM-së nr.80/92, tekst i konsoliduar – 2008.

RAST STUDIMI 2

Një numer i konsiderueshëm i kërkesë-padive i adresohen në muaj Gjykatës së Dibrës për të bërë shkurorëzim. Shumica e divorceve bëhet për shkaqe ekonomike e sociale, por ka edhe divorce të “koordinuara” për rregullimin e “letrave” në shtetet perëndimore.

Vendi i ngjarjes: Dibër

L.F dhe B.O janë qytetarë të Dibrës. L.F jeton në Zvicër kurse B.O në Dibër.

Një marrëveshje interne midis L.F dhe B.O filloi në Dhjetor të vitit 2013 dhe mbaroi me sukses më 21 Janar 2017. L.F dhe B.O janë quajtur burrë dhe grua përpara ligjit dhe shoqërisë, jo për dashuri por për të marrë leje qëndrimi (letrat) në Zvicër. L.F dhe B.O për 5 vite rresht kanë mbajtur lidhjen e tyre martesore në distancë, mirëpo përpara strukturave ligjore janë afruar. Jeta e tyre ka qenë e ndarë, L.F dhe B.O kanë jetuar në banesa të ndryshme. B.O (burri) për 5 vite rresht L.F i ka paguar një shumë të konsiderueshme mujore prej (1700 CHF). L.F ka pranuar shumën e parave në ditën e 26 të secilit muaj. Midis këtij “çifti” gjatë gjithë kësaj periudhe 5 vjeçare nuk ka ekzistuar ndonjë mosmarrëveshje apo keqkuptim. L.F pas kalimit të periudhës së caktuar B.O-së ja dorëzon dokumentacioni (letrat).

Pasi që në një farë mënyre u arrit “qëllimi” i martesës, të dy palët inicuan procedure shkurorëzimi me propozim padi për shkurorëzim, duke qenë se të dy ishin të pëlqimit që martesa të zgjidhet. Palët përpara gjykatës u përballen me përpjekjet që të dëshmojnë që martesa e tyre ka qenë reale (duke pasur parasysh që ligji nuk lejon shkurorëzimin fiktiv) dhe se real është edhe shkurorëzimi. Më datë 20 Janar 2017 ora 09.30 min është marrë vendimi për shkurorëzimin e kësaj martese joreale. Nga vlerësimi që morrën nga ana e Gjykatës B.O dhe L.F dolën të shkurorëzuar, ‘martesa’ e tyre përfundoi dhe ata u shprehën të kënaqur për këtë parteritet.

❖ PËRFUNDIME

Shkurorëzimi paraqet një të drejtë të njeriut. Ai është shprehje e lirisë së individit për të dashuruar dhe për të zgjedhur. E drejta e barabartë juridike – civile midis burrit dhe gruas për prishjen e martesës trimfoi mbi të drejtën e njëanshme. Vendosja e së drejtës së divorcit është shprehur në qytetërimin e sotëm dhe njëherësh mund të konsiderohet si një fitore e madhe botërore. Me martesë burri dhe gruaja përfitojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime. Nga martesa lind detyrimi reciprok për besnikëri, për ndihmë morale dhe materiale, për bashkëpunim në interes të familjes dhe të bashkëjetesës. Martesa vendos mbi të dy bashkëshortët detyrimin për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e fëmijëve. Por vitet e fundit ky institucion ka pësuar tronditje të shumta si rrjedhojë e periudhave të tranzicionit që ka kaluar vendi ynë në përgjithësi por dhe familja veçanërisht, kushteve të vështira ekonomike - sociale, të cilat kanë ndikuar në tronditjen e këtij institucioni gjer në atë masë sa kanë ndikuar në shpërbërjen e tij, duke sjellur si pasojë dhe zgjidhjen e martesës mes bashkëshortëve.

Përmes statistikave të cilat janë të afishuara pranë Gjykatave përkatëse rezulton se numri i kërkesave apo i kërkesë padive ku bashkëshortët i janë drejtuar Gjykatës për zgjidhje martese është një numër realtivisht në rritje, fakt të cilën konfirmon më shumë tronditjen e këtij institucioni në veçanti dhe të familjes në përgjithësi. Por si përfundon ligjërisht një Martesë, cila është rruga që duhet ndjekur, cilat janë pasojat që vijnë nga zgjidhja e saj, të gjitha këto janë sqaruar si më herët për të pasur një kuadër ligjor më të qartë përse i përket zgjidhjes së martesës ligjërisht. Ligji i Familjes në Republikën e Maqedonisë, Ligji i Familjes në Republikën e Kosovës dhe Kodi i Familjes në Republikën e Shqipërisë parashikojnë mënyrat e mbarimit të martesës. Kodi i Familjes parashikon mënyrat e mbarimit të martesës të cilat janë, me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes se njërit bashkëshort (ku bashkëshorti tjetër pasjetues quhet i ve) ose me zgjidhjen e martesës se tyre, me marrëveshje pëlqim reciprok mes bashkëshortëve ose me pëlqimin vetëm të njërit prej tyre duke paraqitur padi në Gjykatën përkatëse ku ka vendbanimin paditësi (ku pastaj miret statusi i divorcuar). Në rastet kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën, edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës.

Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre respektive, me kushtin e vetëm që në marrëveshje të jetë cituar, fakti i zgjidhjes së martesës, e drejta e mbiemrit pas martese, lënia e fëmijëve të mitur për rritje dhe edukim njërit nga bashkëshortet përkatës, e drejta e takimit dhe pensioni ushqimor. Përmes kësaj marrëveshje bashkëshortët bien dakord mes tyre për të gjitha pasojat që mund të vijnë nga zgjidhja e martesës. Gjykata më tej vendos për zgjidhjen e martesës në rast se krijon bindjen se vullneti i secilës palë është real dhe secili prej tyre ka dhënë lirisht pëlqimin e tij për zgjidhjen e martesës. Në të njëjtin vendim, gjykata miraton dhe marrëveshjen që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Në rast se gjykata konstaton se marrëveshja nuk siguron në mënyrë të mjaftueshme interesat e fëmijëve ose të njërit prej bashkëshortëve, pezullon gjykimin për 3 muaj dhe u kërkon bashkëshortëve të bëjnë rregullimet e duhura në marrëveshje. Në qoftë se edhe pas afatit të parashikuar në paragrafin e parë nuk janë bërë rregullimet e duhura, gjykata refuzon miratimin dhe rrëzon kërkesën për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok të bashkëshortëve. Në rastet në të cilat bashkëshortët nuk bien dakord për zgjidhjen e martesës atëherë secili prej tyre mund të paraqesë, kërkesë-padi, me anë të së cilës kërkon, zgjidhjen e martesës mes palëve ndërgjyqëse (që janë bashkëshortët), kthimin e mbiemrit të vajzërisë, ose të mbiemrit që kanë pasur para martese (nëse kjo gjë kërkohet pasi ka raste kur njëri nga bashkëshortët vërteton faktin se përmes këtij mbiemri e njohin të gjithë, atëherë mund t'i kërkojë gjykatës të mos ndryshojë mbiemrin dhe të mbajë mbiemrin e martesës), lënien e kujdestarisë për rritje dhe edukim, të drejtën e takimeve dhe caktimi i pensionit ushqimor.

Të gjitha këto elemente duhen cituar në kërkesë padi, pasi është thelbi i gjykimit dhe i zgjidhjes së pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës. Procedura e gjykimit pastaj, kalon në 2 faza, faza e pajtimit, ku bashkëshortët dëgjohen veçmas ose bashkarisht pa praninë e përfaqësuesve të tyre dhe secili jep versionin e tij të tronditjes së marrëdhënieve familjare gjer në atë pikë sa është e pamundur vazhdimi i bashkjetesës së bashku. Si shkaqe që citohen në Gjykatë, mund të jenë të ndryshme, siç mund të jenë, dhuna psikologjike, fizike, veset e njerit bashkëshort, kumari, droga, abuzimet, pija, amoraliteti, tradhëtia bashkëshortore, mungesa e perkujdesjes, braktisja de facto dhe de jure nga njeri bashkëshort, mungesa e dashurisë e mirkuptimit, mungesë komunikimi, keqtrajtimi emocional, mungesa e përkrahjes, izolimi i njerit bashkëshort etj, këto janë disa nga rastet më të shpeshta që njeh praktika dhe që janë të diskutueshme në praktikën gjyqësore, megjithatë nuk përjashtohet e drejta e çdo shkakut të mundshëm

që ka tronditur marrëdhënien bashkëshortore gjer në atë pikë sa është bërë i pamundur vazhdimi i bashkejtesës mes tyre, duke kërkuar apo duke mos kërkuar fajësinë. Fajësia kërkohet atëherë kur përpara Gjykatës çifti ka paraqitur ankesat dhe gjendjen aktuale të martesës së tyre.

Pra mjafton çdo shkak dhe jo domosdoshmërisht shkaqet e cituara më lart, për t'iu drejtuar Gjykatës për zgjidhje martese. Përfundimisht në nenin 132 të Kodit të Familjes, citohet se: Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimit, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër që përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve që rrjedhin nga martesa, jetesa e përbashkët bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët. Gjykata vendos për fajësinë, në zgjidhjen e martesës, vetëm kur kjo kërkohet prej njërit ose të dy bashkëshortëve.

Njëkohësisht Kodi i Familjes parashikon dhe rastet ku secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh. Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, duhet të përcaktojë në kërkesëpadinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër. Ndërprerja e jetesës së përbashkët mund të paraqitet si shkak për zgjidhjen e martesës vetëm nga bashkëshorti që ka paraqitur kërkesëpadinë. Bashkëshorti i paditur ka të drejtë të paraqesë kundërpadi. Në këtë rast, gjykata mund të rrëzojë padinë dhe të pranojë kundërpadinë, duke zgjidhur martesën. Procedura gjatë gjykimit, konsiston në paraqitjen e provave shkresore dhe me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tyre (nëse ato dëshirojnë) dhe thirrja e ekspertit (psikologut) nëse ka fëmijë të mitur i cili jep mendimin e tij lidhur me kujdestarinë. Pasi Gjykata ka dëgjuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse, shqyrtuar provat shkresore, me dëshmitarë (nëse ka) raport vlerësimin, dëgjuar fëmijët (nëse e kërkojnë palët), bindjen e brendshme, dhe mbi të gjitha duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të fëmijës, mer vendim përkatës i cili është i ankimueshem brenda 15 ditëve duke filluar nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit. Me ndryshimin e kushteve në të cilat është dhënë vendimi për zgjidhjen e martesës, secila nga palët e interesuara mund të drejtohet Gjykatës për ndryshim vendimi të dhënë nga Gjykata përkatëse për zgjidhje martese, ku fillon një procedurë e re gjykimi.

Në momentin në të cilin vendimi merr formë të prerë, përbën titull ekzekutiv dhe pala e interesuar proçedon me proçedurat përmbarimore. Shkurorëzimi siç e kam përmendur edhe më lartë është një e drejtë e njëriut. Shkurorëzimi në vendin tonë është një tregues i cili tregon zhvillimin e shoqërisë, por edhe problemeve që ndodhin në shoqëri. Edhe në vendin tonë shkurorëzimi njihet për një dinamizëm të madh. Në Maqedoni po zvogëlohet numri i kurorëzimeve, ndërsa rritet numri i divorceve.

Në fund erdha në përfundim se shkurorëzimi është një procedurë shumë e rëndë e sidomos nëse në mes ka një fëmijë dhe kjo ndikon shumë në jetën e fëmijës. Shkaqet e divorceve janë të shumta dhe mund të them se ka raste që ndahen shkaku i dhunës në familje, varfërisë, moralit, grindjeve e shumë e shumë gjërave tjera. Tani besoj që është rritur numri i divorceve shkaku që askush nuk e duron më askënd. Deri dje femra nuk ka guxuar të ngrit zërin apo të ankohet për maltretime e bashkëshortit ose të familjes së tij, sepse ka qenë e pa shkolluar, pa punë dhe familja e saj nuk e ka pranuar mbrapsht, kurse tani është ndryshe. Madje mund të them se në disa divorce, femra është ajo që është më e fortë financiarisht. Nuk është dukuri e mirë divorci, dhe rritja e numrit të tij ndikon shumë në jetën sociale të një shoqërie, andaj duhet të ketë më shumë mirëkuptim, respekt dhe dialog ndërmjet çifteve bashkëshortore.

Dibra gjatë tre muajve të fundit ka thyer rekordin për shkurorëzimet. Numri i divorceve gjatë muajit qershor, korrik dhe gusht ka arritur në 290, shifër kjo mjaft e lartë në krahasim me numrin e banorëve të kësaj komune. Nga zyra e gjendjes civile kanë raportuar se shumica e shkurorëzimeve janë bërë me marrëveshje mes palësh, gjë e cila ka përshpejtuar procesin e divorcit. Po ashtu kam konkuluduar se më së shumti çiftet preferojnë që të ndahen me anë të marrëveshjes pra preferojnë shkurorëzim me marrëveshje, dhe para gjykatës paraqiten me një plan të përbashkët se si do të shkojë procedura pas jetës së ndarjes së tyre, çka do të ndodhë me fëmijët, si do të jetë alimentacioni etj etj. Zgjidhja e martesës me pëlqimin e ndërsjelltë të bashkëshortëve bazohet në një marrëveshje të ndërsjelltë, të përbashkët të tyre e cila ka për qëllim dhënien fund të martesës që ekziston midis tyre. Ideja e përgjithshme e këtyre rasteve qëndron se nëpërmjet zgjidhjes së martesës me marrëveshje bashkëshortët rishikojnë pasojat nga zgjidhja e kësaj marrëveshje.

Si formë e zgjidhjes së martesës e paraparë me ligj është edhe zgjidhja e martesës si pasojë e mbarimit faktik të bashkësisë martesore më gjatë se 1 vit (neni 41 i LF). Sa i përket kësaj merren parasysh ato veprime dhe rrethana të cilat e vështirësojnë komunikimin dhe përmbushjen e detyrave familjare në mënyrë të përbashkët nga ana e bashkëshortëve. Në bazë të përfundimit faktik të bashkësisë martesore më gjatë se 1 vit, shkurorëzim mund të kërkojë çdonjëri nga bashkëshortët, që do të thotë se kërkesë për shkurorëzim mund të paraqesë edhe ai bashkëshort që është larguar nga bashkësia martesore. Gjykata, duke proceduar në bazë të këtij lloji të kërkesës, mund ti hetojë vetëm faktet dhe rrethanat lidhur me atë se bashkësia martesore a është ndërprerë me të vërtetë dhe se ajo ndërprerje a ka zgjatur më tepër se një vit, por nuk mundet që ti hetojë shkaqet që kanë sjellë deri tek ajo gjendje dhe se cili nga bashkëshortët është fajtor për ndërprerjen e marrëdhënieve të ndërsjella etj. Rastet e këtilla i hasim shpesh në shoqërinë tonë, posaçërisht në familjet e gurbetqarëve. Në kësi rastesh, martesë ka përfunduar faktikisht më gjatë se 1 vit, bashkëshortët nuk jetojnë bashkë, njëri nga bashkëshortët (në rastet më të shpeshta burri), jeton në bashkësi jashtë martesore, mirëpo, edhe përkundër kësaj asnjëri nga bashkëshortët nuk kërkon zgjidhje të martesës. Ndarja në aspektin hapësinor të bashkëshortëve me qëllim të nevojës për shkollim të mëtutjeshëm, specializim në profesionin e ndonjërit nga ta, por për të cilën ata me marrëveshje janë përcaktuar, nuk mund të llogaritet si pushim faktik i marrëdhënieve bashkëshortore.

Në këto situata bashkësia martesore nuk pushon së funksionuari, ndërkaq bashkëshortët vazhdojnë të plotësojnë të drejtat dhe obligimet e tyre të cilat dalin nga martesë.¹¹⁷

Përkundër kësaj, në rastet kur bashkëshortët nuk e ndryshojnë lokacionin e banimit të tyre, pra jetojnë në të njëjtën banesë, nën të njëjtin “pullaz”, ndërkaq nuk komunikojnë dhe nuk i përmbushin të drejtat dhe detyrimet të cilat janë pjesë e institucionit të martesës - në këtë rast bëhet fjalë për të ashtuquajtura “martesë të vdekura” tek të cilat situata ka ardhur deri te ndërprerja faktike e bashkësisë martesore. Mund të konkludojmë se rasti i zgjidhjes së martesës më këtë formë është shprehja e vullnetit të lirë të tyre. Bashkësia e kushteve sipas së cilave ata parashikojnë këtë zgjidhje të martesës përbën tërësinë e kësaj formë të zgjidhjes së martesës. Siç cekëm edhe më lartë se, zgjidhja e martesës me pëlqimin e ndërsjellë të dy bashkëshortëve paraqet karakter të ngushtë kontraktual. Në të vërtetë mund të themi se kjo formë e zgjidhjes së martesës ka një karakter të përbërë kontraktual dhe gjygjësor.

¹¹⁷ Ljiljana Spirović Trpenovska, Vepra e cituar, f.133-134.

Po ashtu vlen të përmendim se pasojat e shkurorëzimit dhe anulimit të martesës janë si në vijim:

Mbiemri-Nëse njëri nga bashkëshortët ka ndërruar mbiemrin me rastin e martesës pas zgjidhjes ose anulimit të sajë ai mundet të marr mbiemrin që e kishte para martesës.

Ndarja e pronës së përbashkët-Mundet me marrëveshje duke e pjesëtuar në pjesë të barabarta ose duke vendosur gjykata me propozimin të njërit bashkëshort duke pasur parasysh kontributet e tyre.

Detyrimi i ushqimit - Mund të vazhdohet edhe pas zgjidhjes së martesës nëse njëri bashkëshort është në nevojë dhe pa mjete për ushqim.

E drejta e banesës-Këtë duhet ta vendosin bashkëshortët nëse jo atëherë vendos gjykata.

E drejta e trashëgimit-Pas zgjidhjes apo anulimit të martesës ish-bashkëshortët e humbin të drejtën e trashëgimit ligjor. Nëse testamenti është përpiluar para zgjidhjes së martesës nuk mund të krijoj efekte juridike. Nëse testamenti është përpiluar pas zgjidhjes së martesës krijon efekte juridike.

Pasojat për fëmijët- Gjkata mund të merr tri vendime.

- 1. Të gjithë fëmijët ti besohen njërit prind.*
- 2. Që fëmijët tu ndahen prindërve dhe*
- 3. Që fëmijët ti besohen një personi të tretë apo ndonjë institucioni tjetër.*

❖ REKOMANDIME

Duke e parë tejzgjatjen e këtyre proceve gjyqësore, kohën e fundit duke shfytëzuar edhe përfshirjen e Ligjit për Familje, çiftet kanë filluar të praktikojnë shkurorëzimin me pëlqim reciprok. Sipas të dhënave të cilat i morëm nga Gjykata e Dibrës dhe zyrat noteriale në këtë vend pamë se çiftet më së shumti i drejtohen gjykatës me një projekt marrëveshje me dakortësinë e palëve në të cilën zgjidhet marrëveshja e firmosur në zyrat noteriale. Në marrëveshjen e nënshkruar nga bashkëshortët në zyrat noteriale, bihet dakort për çështjet e kujdesit prindëror, ndarjes së pasurisë dhe përgjegjësitë në prindërim, nëse nga martesë çifti ka pasur fëmijë. Pas aktit të marrëveshjes reciproke për divorc, akti paraqitet në institucionin e gjykatës, e cila bën edhe aprovimin e marrëveshjes së nënshkruar mes bashkëshortëve. Kjo praktikë sipas punonjësve të zyrave noteriale, është shumë efikase dhe ndiqet nga shumë prej çifteve, që procesin e divorcit duan ta kryejnë në një kohë më të shkurtër dhe nuk kanë konflikte me njëri-tjetrin. Rekomandim tjetër është që çiftet bashkëshortore të cilët kanë të lidhur marrëveshje për shkurorëzim mos të paraqiten në gjykatë. Nëse martesë juaj ka dështuar edhe shkurorëzimi është i pashmangshëm ju duhet të kontaktoni gjykatën e vendit tuaj dhe të paraqitni kërkesën e përbashkët për shkurorëzim. Nëse njëra nga palët nuk bien dakord për divorc, ai ose ajo duhet ti kërkojë gjykatës të nxisë masë për mbrojtjen e martesës. Kjo procedurë është një hap i parë drejt ndarjes dhe shkurorëzimit.

❖ LITERATURA E SHFYTËZUAR

❖ TEKSTE, MONOGRAFI, ARTIKUJ

1. Abdulla Aliu, E drejta familjare, Prishtinë, 2007,
2. Albanian Law Diary, Utilitarian blog on different legal issues for those who live in Albania, Dorina Zhupa, Mbarimi i Martesës në Shqipëri.
3. Alinčić Mira i Hrabar Dubravka, Obiteljsko pravo, Zagreb, 2006
4. Brestovci, Faik, E drejta procedurale civile I, Prishtinë, Botimi 2006
5. Dr.Mira Aliniç, Ana Bakariç, Porodicno Pravo, Zagreb
6. Elchanini v A., Diary of a Russian Priest, bot. Con. Press
7. Florian Pohl, *Modern Muslims Societies*, Malaysia, 2011
8. Gani Uruçi, E drejta familjare – ligjerata të autorizuar, Prishtinë, 2009
9. Hammudah Abd Al-Ati, *Islam in Focus*, Fourth edition, Cairo, 2003.
10. Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Faculty of Laë, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.196
11. Justicia, International Journal of Legal Sciences, Editor – In- Chief Vullnet Ahmeti, Editors, Ferat Polisi, Agim Nuhiu, Publisher, Drita, M. Fazliu, Shkurorëzimi i martesës ndër vite, Faculty of Law, Tetova, RM,5/2016, ISSN 1857-8454, fq.79
12. Kurtesh Saliu, *E drejta kushtetuese*, Tetovë, 2002
13. Liljana Spiroviq, *Semejno Pravo*, Shkup, 2004
14. Mandro-Bilalli Arta, E drejta romake, Tiranë, 2006
15. Mandro-Bilalli Arta, Zaka Tefta, Meçaj Vjollca, Fullani Arjana, E drejta familjare, Tiranë, 2006
16. Marina Janiç – Komar, Radoje Koraç, Zoran Ponjaviç, Porodično Pravo, Beograd, 2009
17. Meyendorff J., Marriage. An Orthodox Perspective, bot. SVS Press
18. Mladenović Marko, Porodično pravo, Beograd, 1981
19. Nerimana Tranlic, Suzana Bubiç, Bračno pravo, Pravni fakultet, 2007
20. Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë , 2005
21. Puhani Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1968
22. Ruxhdi Berisha, Doracak për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004

23. Selmani, Arta, Joined and responsible parenting, Doi:10.1515/seeur-2017-0011
24. Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqipëtarë”, Tiranë, 1999
25. Јаневски Арсен и Зороска- Камиловска Татјана, Граѓанско процесно право (Книга прва – Парнично право) Правен факултет „Јустинијан Први“ – УКИМ, Скопје, 2009
26. Љиљана Спировиќ –Трпеновска Семејно право НИП „Студентски збор“ –Скопје 2004 година
27. Миле Хадивасилев Миле, Семејно право, Скопје, 1980
28. Спировиќ-Трпеновска Љиљана, Семејно право, Скопје, 1997

❖ AKTE LIGJORE, KODE

- ✓ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991.
- ✓ Ligji për familjen i RM-së, GZ e RM-së nr.80/92, tekst i konsoliduar – 2008.
- ✓ Ligji për familje i R.Kosovës, Ligji Nr.2004/32.
- ✓ Kodi i familjes i R.Shqipërisë, Ligji Nr.9062, dt.8.5.2003.
- ✓ Zakon za semejstvoto-Komentari, sudska praktika, predmeten registar, primeri za prakticna primena, pridruzni propisi i literatura, Kiril Cavdar i Cvetanka Silanoska-Kostadinovska, Skopje, 2013.
- ✓ Ligji për aplikimin e Kodit Civil (1929).